

**TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencor në  
“Informatike Ekonomike”, 120 ECTS**

Grupi i Vlerësimit të brendshëm:

- |                          |         |
|--------------------------|---------|
| 1. Enkeleda Shehi Dr.    | Kryetar |
| 2. Endri Plasari Dr. (C) | Anëtar  |
| 3. Samel Kruja Dr. (C)   | Anëtar  |
| 4. Eno Koliçi Student    | Anëtar  |



Maj 2025

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi Master i Shkencave 120 ECTS ofrohet në Ciklin e Dytë me njësi bazë përgjegjëse për programin Departamentin e Informatikes Ekonomike pranë Fakultetit të Teknologjise se Informacionit në Tirana Business University (TBU).

TBU ka nisur dhe ushtruar veprimtarine akademike me VKM Nr. 794, datë 06.10.2010, me Urdhrin e MAS Nr. 75, datë 16.02.2011 si edhe me vendimin e akreditimit institucional dhe të çdo program studimi<sup>1</sup>. Ndërsa Fakulteti i Teknologjise se Informacionit ka filluar aktivitetin bazuar ne Urdhrin e MAS Nr.195 date 20.4.2023 “Mbi hapjen e njesise kryesore “Fakulteti i Teknologjise se Informacionit” ne TBU” dhe programi Master i Shkencave ne Informatike Ekonomike me Urdhër te MAS Nr.458 datë 14.08.2023 “Mbi hapjen e programit te studimit te ciklit te dyte Master i Shkencave ne “Informatike Ekonomike” ne TBU”.

Referuar shpjegimeve të mësipërme, është përgatitur për akreditim Raporti përkatës i Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin Master i Shkencave ne Informatike Ekonomike 120 kredite (ECTS), si dhe anekset dhe tabelat përmbledhëse që e shoqërojnë atë.

Ky Raport Vetëvlerësimi, në vijim i referohet programit të studimit Master i Shkencave në Informatike Ekonomike 120 ECTS.

Programi i studimit Master i Shkencave në Informatike Ekonomike 120 ECTS, ka si objektiv kryesor të arrijë nivele të larta të cilësisë së produktit të vet - studentë me dije teorike dhe aftësi praktike, të tilla që rrisin ndjeshëm mundësitë e tij për punësim, si rregull, para mbarimit të studimeve për studentët e pa punësuar, ndërsa gjatë atij Master, kjo bën që studenti i punësuar, si rregull, të bëjë një hap më lart në karrierë.

Aftësimi praktik dhe me njohuri të aplikueshme është mënyra më e mirë e arritjes së objektivit kryesor, shoqëruar me plane mësimore të pasura me një larmishmeri të fushave te informatikes dhe ekonomise, me qëllim që studentët t’i përgjigjen kërkesave për punësim apo ngritje në karrierë në të gjitha degët e industrisë si dhe në pothuaj shumicën e profesioneve. Këtij qëllimi i shërbejnë gjithashtu edhe njohuritë që ofrohen në fusha të përgjithshme të tilla si: lidërsipit dhe etika e vendimmarrjes, menaxhimi strategjik, të drejtës së biznesit, etj. dhe ne fusha me specifike si marketingu digjital dhe inovacioni, auditimi i sistemeve te informacionit (SI), menaxhimi i ndryshimit dhe rritjes, menaxhimi i SI, menaxhimi i Bazave te te Dhenave, etj.

<sup>1</sup> 62. TBU Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 794, dt. 06.10. 2010 Licensimi i TBU; 63. Urdhër MAS Nr. 75, datë 16.02.2011; 70. Urdher Nr.195 date 20.4.2023 Mbi hapjen e FTI ne TBU; 71. Urdher MAS-Nr. 458, dt.14.08.2023 per hapjen e MSH Informatike Ekonomike.



Në Programin Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike 120 ECTS, procedurat e zhvillimit të të cilit janë të formalizuara në Rregulloren specifike të Programit të studimit. Rregulloret, Planet mësimore, si dhe Silabuset e lëndëve rishikohen në strukturë si dhe pasurohen me literaturën përkatëse para fillimit të çdo viti akademik. Afati i studimeve për këtë program, është normalisht 2 vite, ndërsa praktika profesionale si rregull zhvillohet gjatë 2 viteve akademike.

Programi mbështetet nga një staf akademik kompetent dhe me eksperiencë të spikatur jo vetëm akademike por edhe profesionale në fushat përkatëse. Programi mbështetet gjithashtu, me financimin e duhur, si dhe me llogjistikën e nevojshme për të mundësuar zhvillimin normal të tij.



E1

Pho

gsk

gsk

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Në përputhje me Manualin e ASCAL "Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit", me Urdhër të Rektorit Nr. 8 datë 20.03.2025<sup>2</sup> është caktuar Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (në vijim GVB) për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë për Programin: "Master i Shkencave" 120 ECTS, në "Informatike Ekonomike".

GVB përbëhet nga tre anëtarë (tre anëtarë të stafit akademik efektiv). GVB ka kryer procesin e vetë-vlerësimit të brendshëm të cilësisë bazuar në grumbullimin e informacionit të nevojshëm, si dhe analizën e tij krahasuar me standartet dhe objektivat e programit, duke hartuar në përfundim këtë Raport të Vetë-vlerësimit të Brendshëm (RVB), në përputhje me detyrimet ligjore. Departamenti Përgjegjës për këtë program studimi është caktuar Departamenti i Informatikes Ekonomike<sup>3</sup>.


Të gjitha më sipër, si dhe ky raport hartohen bazuar në dispozitat ligjore mbi arsimin e lartë, aktet nënligjore të MASR dhe ASCAL, si dhe në Statutin dhe Rregulloren institucionale të TBU-së.

GVB ka vlerësuar përmbajtjen e programit dhe zhvillimin e tij gjatë vitit akademik, personelin akademik të angazhuar, njesinë bazë përgjegjëse të programit, burimet njerëzore, financiare dhe infrastrukturën, si dhe parametra të tjerë që dëshmojnë cilësinë e programit në të gjitha dimensionet. GVB i është përmbajtur kritereve të vlerësimit të programit sikurse paraqiten më poshtë, duke dhënë shpjegimin dhe argumentimin mbi realizimin e secilit kriter vlerësimi të programit.

GVB është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë udhëzimet e ASCAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të TBU-së. GVB-së i janë vënë në dispozicion dhe ka shfrytëzuar dhe analizuar në mënyrë racionale të dhënat statistikore që nevojiten, të cilat janë përfshirë në Raport, të strukturuar në formën e tabelave sipas kritereve për çdo standard. Në hartimin e RVB-së dhe anekseve, grupi ka integruar informacionin që disponohet për programin Master i Shkencave në Informatike Ekonomike me 120 ECTS. Në mbështetje të Raportit është përgatitur Dosja e Vlerësimit të Brendshëm (DVB), në përbërje të së cilës vend qëndror zë RVB-ja. Në përmbajtjen e Dosjes përfshihet edhe dokumentacioni në mbështetje të vlerësimit në formën e Anekseve të këtij raporti.

<sup>2</sup> 68. Urdhër Rektori – ngritja e GVB për akreditimin për programet e studimit.

<sup>3</sup> 2.1.1. Vendim Senati 9 dt. 28.09.2022 për hapjen e Fakultetit të Teknologjise së Informacionit; 2.1.2. Vendim Senati 9-1 dt. 16.11.22 për hapjen e programeve Informatike Ekonomike, Inxh. Kompjuterike dhe Inxh. Injeneri Softuerike; 2.1.3. Vendim SA Nr. 51 dt. 11.09.23 mbi ristrukturimin në zbatim të urdherave 195, 196 MAS, 38. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të studimit të Msh\_IE.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike 120 ECTS**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>TBU ka nisur dhe ushtruar veprimtarine akademike me VKM Nr. 794, datë 06.10.2010, me Urdhrin e MAS Nr. 75, datë 16.02.2011 si edhe me vendimin e akreditimit institucional dhe të çdo program studimi<sup>4</sup>. Fakulteti i Teknologjise se Informacionit ka filluar aktivitetin bazuar ne Urdhrin e MAS me Nr.195 date 20.4.2023 “Mbi hapjen e njesise kryesore “Fakulteti i Teknologjise se Informacionit” ne TBU” dhe programi Master i Shkencave ne Informatike Ekonomike me Urdhrin e MAS me Nr.458 datë 14.08.2023 “Mbi hapjen e programit te studimit te ciklit te dyte Master i Shkencave ne “Informatike Ekonomike” ne TBU”.</p> <p>Të gjitha programet e studimit të ofruara nga TBU janë në linjë me politikat kombëtare, në veçanti punësimin e të rinjve dhe nxitjen e sipërmarrjes, kreativitetit dhe inovacionit. Të gjitha objektivat strategjikë të TBU-së - programet, metodat dhe rezultatet e arritura me studentët tanë, provojnë harmoninë e programeve të TBU-së me objektivat kombëtare. Këto janë të pasqyruara në Statutin e TBU-së<sup>5</sup> dhe në Strategjinë e Zhvillimit Institucional të TBU-së 2024-2029<sup>6</sup>.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>TBU synon përgatitjen profesionale cilësore të studentëve përmes harmonizimit të formimit teorik me aftësimin praktik, me përparësi në fushat e administrimit të biznesit, të së drejtës së biznesit, administrimit publik, ne fusha te peraferta dhe te nderthurura te teknologjise se informacionit<sup>7</sup>. Ky program studimi është në përputhje me misionin dhe qëllimin e TBU-së<sup>8</sup> dhe përbën një arritje cilësore për objektivat akademike të Departamentit të Informatikes Ekonomike dhe planit strategjik të programit Master Shkencor në “Informatike Ekonomike”, 120 ECTS<sup>9</sup>.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” 120 ECTS është një nga dy programet e ciklit te dyte te Fakultetit te Teknologjise se</p>

<sup>4</sup> 62. TBU\_Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 794, dt. 06.10. 2010 Licensimi i TBU; 63. Urdhër MAS Nr. 75, datë 16.02.2011; 70. Urdher Nr.195 date 20.4.2023 Mbi hapjen e FTI ne TBU; 71. Urdher MAS Nr. 458, dt.14.08.2023 per hapjen e MSH Informatike Ekonomike.

<sup>5</sup> 2. Statuti i TBU, Neni 8.

<sup>6</sup> 3.1. Strategjia e Zhvillimit të TBU 2024-2029, fq. 8-9.

<sup>7</sup> 2. Statuti TBU, Neni 8, 22.

<sup>8</sup> 3.1 Strategjia e Zhvillimit të TBU 2024-2029, fq. 8-9.

<sup>9</sup> 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programin e studimit MSh-IE 120 ECTS, fq. 1-2.



*[Signature]*

*[Signature]*

*[Signature]*

<p>dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Informacionit, krahas programit Master i Shkencave në “Inxhinieri Software”<sup>10</sup>. Objektivi kryesor i programit është të arrijë nivele të larta të cilësisë së produktit të vet - studentë me dije teorike dhe aftësi praktike, të tilla që rrisin ndjeshëm mundësitë e tij për punësim, si rregull, para mbarimit të studimeve për studentët e pa punësuar, ndërsa për studentet e punësuar gjatë studimit në programin Master ata të bëjë një hap më lart në karrierë. Me fjale të tjera objektivi kryesor i TBU është që studentët që ndjekin këtë program studimi të ngjiten një shkallë më lartë në karrierë përpara përfundimit të studimeve<sup>11</sup>.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” me kurrikulën dhe plani mësimor<sup>12</sup> të ofruar në kuadër të tij janë në harmoni të plotë me Statutin e TBU-së, rregulloren e institucionit si edhe me fushat e drejtimet akademik të TBU-së<sup>13</sup>.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Ky program studimi ka objektiva të shprehura qartë, të lidhura drejtpërdrejt me synimet e TBU-së, si dhe ofrohet në përputhje të plotë dhe nxit zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar. Për objektivat, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi informacioni i plotë jepet në rregulloren përkatëse të programit të studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike”<sup>14</sup>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi I.2</b></p>	
<p>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën</p>	<p>Fakulteti i Teknologjise se Informacionit, ku përfshihet edhe programi i studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike”, është një fakultet i ri në TBU-së<sup>15</sup>. Struktura institucionale e TBU-së është në funksion të misionit dhe e organizuar në përputhje me fushën akademike specifike<sup>16</sup> për ofrimin e programit</p>

<sup>10</sup> 2.1.2. Vendim Senati 9-1 dt.16.11.22 Per hapjen e programeve Informatike.Ekonomike; Inxh.Kompjuterike dhe Inxhienieri Softwerike.

<sup>11</sup> 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programin e studimit MSh-IE 120 ECTS, fq. 1-2.


<sup>12</sup> 16.1. Kurrikula e programit MSh “Informatike Ekonomike” 120 (shqip); 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 (shqip).

<sup>13</sup> 2. Statuti i TBU, Neni 8; 3.1. Strategjia e Zhvillimit të TBU 2024-2029, fq. 8-9.

<sup>14</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip), fq. 2-9.

<sup>15</sup> 2.1.1. Vendim Senati 9 dt. 28.09. 2022-per-hapjen e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit; 2.1.2. Vendim Senati 9-1 dt.16.11.22 Per hapjen e programeve Informatike.Ekonomike; Inxh.Kompjuterike dhe Inxhienieri Softwerike.

<sup>16</sup> 2.2. Struktura Organizative TBU.



6

<p>akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” dhe disponon përvojën dhe burimet e nevojshme njerëzore<sup>17</sup> të cilët janë të përfshirë në mësimdhënien e këtij programi. Personeli akademik efektiv që është i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” në TBU, përbëhet nga një Prof. Dr, dy Prof. Asoc. Dr, kater PhD/Dr, dhe dy MSC si asistente që janë në proces Dr.<sup>18</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” ofrohet në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore që është Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në TBU, dhe njësisë bazë që është përgjegjëse për këtë program (Departamenti i Informatikes Ekonomike, si pjesë e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit) në TBU. Kjo është e përcaktuar në planin strategjik<sup>19</sup> dhe rregulloren e programit të studimit<sup>20</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” ofrohet bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor<sup>21</sup> dhe aktet rregullatore të TBU-së. Programi ofrohet nga Departamenti i Informatikes Ekonomike. Bazuar në udhëzimet kombëtare dhe evropiane, ky program ka 120 ECTS, përgjatë dy viteve akademike dhe është i shtrirë në katër semestra<sup>22</sup>. Nga shqyrtimi që Grupi i Vlerësimit të Brendshëm u ka bërë syllabuseve të programit, rezulton përputhshmëri e tij me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë.<sup>23</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky kriter nuk është i aplikueshëm.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e</p>	<p>TBU gjatë çdo viti akademik organizon aktivitete të ndryshme profesionale, si: seminare speciale, workshop-e, diskutime të temave të ndryshme nga lektorë të ftuar nga universite brenda dhe jashtë vendit, nga përfaqësues të bizneseve, apo organizmave të tjere vendimarrëse brenda vendit, gjatë të cilave synon trajnimin</p>

<sup>17</sup> 23. CV e stafit akademik të angazhuar në programet e studimit.

<sup>18</sup> 28 Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit MSh IE 120 ECTS për vitet 2023-2025 (Aneks Tabela 4).



<sup>19</sup> 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programin e studimit MSh-IE 120 ECTS, fq. 1-2.

<sup>20</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip), fq. 2-9.

<sup>21</sup> 61. Ligi 80-2015 22.07.2015.

<sup>22</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip); dhe 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS.

<sup>23</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSh\_IE 120 (shqip & anglisht).

diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	e mëtejshëm-të studentëve të saj. TBU, duke mbajtur kontakte të përhershme me të diplomuarit e saj, i fton ata gjithmonë të bëhen pjesë e këtyre aktiviteteve. <sup>24</sup>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi I.3**

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Ashtu sikurse mund të evidentohet në Organigramën e TBU-së.<sup>25</sup> Fakulteti i Teknologjisë se Informacionit përbëhet nga tri njësi bazë: Departamenti i Informatikes Ekonomike, Departamenti i Inxhinierise Software si dhe Departamenti i Inxhinierise Komjuterike. Për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” 120 ECTS, njësia (bazë) përgjegjëse është Departamenti i Informatikes Ekonomike, ndërkohë që edhe Departamenti i Inxhinierise Software është njësia (bazë) përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Software” 120 ECTS.</p> <p>Njësitë bazë në TBU funksionojnë në përputhje të plotë me Statutin dhe të gjitha rregulloret e TBU-së,<sup>26</sup> duke përfshirë këtu edhe Rregulloren e Funksionimit të Njësive Bazë.<sup>27</sup> Çdo përmirësim kurrikular i këtij programi studimi e ka bazën fillestare pranë njësive bazë përgjegjëse për këtë program, dhe ndjek hierarkinë e vendimmarrjes deri në Senatin Akademik<sup>28</sup>. Njësia përgjegjëse e programit bën analizë periodike të zhvillimit të programit<sup>29</sup>, si edhe të punës së stafit të saj akademik, nëpërmjet matjes së performancës së mësimdhënies<sup>30</sup> dhe rezultateve</p>

<sup>24</sup> 36.1 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale (Aneks Tabela 5); 36.3 Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MSH\_IE); 37.1.1 Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët; 36.2. Memorandum TIP\_TBU\_Subjekt; 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

<sup>25</sup> 2.2. Organigrama e re me vulën e MAS.


<sup>26</sup> 2. Statuti i TBU; 3.1 Strategjia e Zhvillimit të TBU 2024-2029; 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH\_IE 120 ECTS; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë se Informacionit.

<sup>27</sup> 7. Rregullore e Departamentit të Informatikes Ekonomike (FTI).

<sup>28</sup> 15. Politika e zhvillimit të Kurrikulave në TBU.

<sup>29</sup> 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MSH\_IE 120 ECTS; 39. Format relacioni për monitorimin e syllabuseve.

<sup>30</sup> 35.9. Format i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët; 35.10. Raporti i Fokus Grupeve 23-24; 35.10.1. TBU - Raporti i Fokus-Grupeve - 2024-2025; 35.11. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu.






	semestrale dhe vjetore të studentëve, të cilat raportohen nga njësia-bazë në nivel periodik, që më pas bëhen pjesë e raporteve vjetore. <sup>31</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	<p>TBU ka vendosur marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi me universitete të tjera vendase dhe të huaja (që synohen të zgjerohen më tej në të ardhmen), subjekte të ndryshme private, institucione publike dhe organizata të rëndësishme jo publike për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit të tij. Fakulteti i Teknologjise se Informacionit (si njësia kryesore ku Departamenti i Informatikes Ekonomike është pjesë) për vitin akademik 2023-2024 ka ofruar për studentët, mundësi kontakti për internship-e dhe punësime me rreth 53 prej kompanive ndër më të njohura në fushën e biznesit<sup>32</sup>. Bashkëpunimi në këtë drejtim, ka sjellë njohjen e zhvillimeve në tregun e punës dhe identifikimin e nevojave dhe kërkesave të tregut për njohuri dhe aftësi të studentëve. Informacioni i siguruar ka ndihmuar në përshtatjen dhe harmonizimin e programit e studimit me kërkesat e tregut si një nga pikat më të forta që ka si objektiv TBU, si edhe fakti që është pjesë e një grupi të madh si BALFIN ka ndihmuar shumë në këtë drejtim. Po kështu, në kuadër të realizimit të objektivave të procesit mësimor dhe zhvillimit të studentëve dhe stafit akademik, TBU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa universitete të njohura brenda vendit, si dhe me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit<sup>33</sup>. Në nivel përgjithësues përfitimet nga këto marrëveshje janë në disa drejtime kryesore: Së pari, gjenerojnë mundësi bashkëpunimi institucional dhe shkëmbim eksperiencash, institucionet publike dhe private (qofshin këto biznese) përfitojnë dhe ekspertiza akademike dhe profesionalizmi i personelit akademik, ndërsa TBU përfiton ekspertizën që ofron tregu i punës; Së dyti, marrëveshjet e bashkëpunimit, krijojnë mundësi që studentët tanë të zhvillojnë praktikat profesionale pranë këtyre institucioneve, duke marrë prej tyre qasjen konkrete të kërkuar nga tregu i punës; Së treti, marrëveshjet shërbejnë për të përmisuar kurrikulat mësimore të programeve të studime nën konsultimin me aktorët e tregut të punës. Së katërti, japin mundësinë e shkëmbimit të stafëve akademike për shkëmbim eksperiencash me universitetet kombëtare dhe ndërkombëtare,<sup>34</sup> duke ritur cilësinë e programit dhe stafit akademik me përvojat europiane”.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute	<p>Siç është theksuar edhe më lart, bashkëpunimi me institucione të tjera akademike, institute kërkimore dhe bizneset (kompani të fushës) synon krijimin e marrëdhënieve afatgjata dhe të qëndrueshme për shkëmbim përvojë, kryerjen e praktikave profesionale për studentët, financimin e aktiviteteve të TBU-së apo</p>

<sup>31</sup> 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MSH\_IE 120 ECTS.

<sup>32</sup> 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.2. Memorandum TIP\_TBU\_Subjekt; 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSH-IE; 36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 14.4 Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI.

<sup>33</sup> 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.2. Memorandum TIP\_TBU\_Subjekt; 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSH-IE; 36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit fq. 2-5.

<sup>34</sup> 46.1. Rregullore për shkëmbimin e stafit; 46.2: Rregullore për shkëmbimet studentore; 46.3 Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve.



<p>kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>mbështetjen teknike të tyre, ofrimin e shërbimeve kërkimore dhe/ose të konsulencës nga TBU e deri te mbështetja dhe punësimi i studentëve.<sup>35</sup> TBU, duke qenë pjesë e një grupi të madh si BALFIN dhe duke pasur lidhje të forta dhe të shtrira në shumë sektorë të ndryshëm të ekonomisë (kombëtare, rajonale por edhe përtej këtyre), e konsideron si një ndër pikat më të forta të saj mundësinë që u garanton studentëve të programit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” në veçanti, si edhe të programeve të tjera që ofron në përgjithësi, për të pasur lidhje të qëndrueshme, të forta dhe afatgjata me tregun e punës, me punëdhënës potencialë, si edhe me institucione të tjera akademike brenda dhe jashtë vendit (në kuadër të lidhjes së marrëveshjeve me to) për mobilizimin e stafit dhe të studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Po. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” (120 ECTS) harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit,<sup>36</sup> si edhe bën analiza për arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.<sup>37</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<p><b>Standardi II.1</b></p>	
<p><b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” (120 ECTS) është i hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshi VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar), “Për Elementët e programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe është i organizuar sipas sistemit Evropian të Transferimit të Kreditit (ECTS) në total 120 ECTS. Struktura e këtij programi është</p>

<sup>35</sup> 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.2. Memorandum TIP TBU Subjekt; 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh-IE; 36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 14.4 Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI. 46.1. Rregullore për shkëmbimin e stafit; 46.2. Rregullore për shkëmbimet studentore; 46.3. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve.

<sup>36</sup> 36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

<sup>37</sup> 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MSH IE 120 ECTS.

<p>përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>dhënë në Rregulloren e tij,<sup>38</sup> ku lëndët janë të ndara qartë sipas elementëve mësimorë që përcaktohen në VKM-në e përmendur më lart, duke respektuar të gjitha kufizimet të shprehura në ECTS, për secilin profil studimi. Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në kategoritë A-E, dhe kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Neni 5 i kësaj rregulloreje shpreh se: “Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të përfitojë të paktën 120 kredite, nga të cilat 6 ECTS në kategorinë e disiplinave të formimit të përgjithshëm (A); 66 ECTS në kategorinë e disiplinave karakterizuese (B); 18 ECTS në kategorinë e disiplinave ndërdisiplinore/integruese /profilizuese të programit (C); 12 ECTS në kategorinë e disiplinave plotësuese (D); 18 ECTS detyrime përmbyllëse (E)”.<sup>39</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” (120 ECTS) synon formimin e shprehive të veçanta në fushën e Informatikes Ekonomike, si edhe aftësimin e studentëve me dije, njohuri dhe ekspertizë profesionale e aplikative në këtë fushë. Lëndët e programit japin njohuri të avancuara në fushën e studimit, si dhe njohuri të tjera plotësuese të dobishme për profesionistë në karrierë të harmonizuara me kërkesat e tregut të punës. Kjo shprehet qartë te struktura e këtij programi nëpërmjet kombinimit harmonik ndërmjet lëndëve karakterizuese të programit Administrim - Biznesi i Avancuar (Aftësi Menaxheriale, Menaxhimi i Ndryshimit dhe i Rritjes, E drejte Biznesi) dhe lëndë karakterizuese të profilit specifik (Marketingu Digjital dhe Inovacioni, Inteligjence Biznesi e Avancuar, Hartim dhe Menaxhim Projektesh ne SI, Menaxhimi i Sitemeve te Informacionit, Etika dhe Teknologjia, Menaxhimi i Big Data, Menaxhimi i Bazave te Dhenave, Auditimi i SI).<sup>40</sup> Programi i studimit synon, nëpërmjet secilës lëndë si dhe profilizimet e ofruara, t’u japë studentëve terminologjinë e duhur që i duhet në formimin e tyre profesional që kombinon teorinë dhe praktikën në fushën e Informatikes Ekonomike si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik.<sup>41</sup> Në syllabuset e lëndëve shprehen qartë dhe në mënyrë eksplicite objektivat dhe rezultatet e të nxënimit dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të çdo lënde<sup>42</sup>. Aftësitë shprehimore teknike i lejojnë studentët për t’u përballur me specializime profesionale në punë të kualifikuara ku nevojiten njohuritë që lidhen me këtë program studimi.<sup>43</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” (120 ECTS), ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të</p>

<sup>38</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip), fq. 2-9.

<sup>39</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip), fq. 2-9; 16.1. Kurrikula e programit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh “Informatike Ekonomike”; 65. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar.

<sup>40</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip), fq. 2-9; 16.1. Kurrikula e programit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh “Informatike Ekonomike”.

<sup>41</sup> 16.1. Kurrikula e programit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip); 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh “Informatike Ekonomike”.

<sup>42</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSh “Informatike Ekonomike” (shqip & anglisht); 22. Formatit i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018; 39. Formatit i relacionit për monitorimin e syllabuseve.

<sup>43</sup> 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MSH IE 120 ECTS.

<p>kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>detyrimeve përmbyllëse. Konkretisht, praktika mësimore zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve. Praktikës profesionale në këtë program i janë dedikuar 12 kredite, ndërsa punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm (si detyrim përmbyllës për programin e studimit) ka në total 18 kredite<sup>44</sup>. Praktikrat profesionale kanë vëmendje maksimale në funksion të vizionit të TBU-së për kombinimin e dijeve teorike me aftësimin praktik,<sup>45</sup> si edhe sloganin e tij: “Ku studimi sjell punësim”. Përvec përcaktimit të lëndës së praktikës profesionale në program me 12 kredite, studentët e këtij programi gjithashtu gëzojnë mundësi/larmi të gjëra oportunitetesh për trajnime profesionale nga ekspertët dhe CEO të kompanive të ndryshme të kompanive BALFIN, kanë mundësinë e stazheve/internship-eve të paguara pranë këtyre kompanive (përgjatë gjithë periudhës së studimeve të tyre), si edhe mundësi reale prespektive punësimi me kompanitë e këtij grupi.<sup>46</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për</p>	<p>Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.</p>

<sup>44</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip); 16.3. Plan i mësimor i programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip). 16.5. Plan i mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh “Informatike Ekonomike”.

<sup>45</sup> 2. Statuti i TBU, Neni 8; 36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse; 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit MSh-IE; 36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëve Udhëheqës për Praktikrat Mësimore për vitin 24-25 FTI.

<sup>46</sup> 37.1.1. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët; 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore


<p>qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>TBU është një institucion jo-publik i Arsimit të Lartë dhe nuk gëzon status të veçantë në kuptim të kuadrit ligjor në fuqi. Forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve kryhet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, ndërsa financimi bazohet kryesisht nga të ardhurat e tarifave të studimit dhe projekte ku TBU është e përfshirë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, se paku 70 per qind.</p>	<p>Ky kriter parashikohet në Pikën 6, Neni 86: “Kodifikimi i programeve të studimit”, të Ligjit 80/2015. Në zbatim të Nenit 86, Këshilli i Ministrave dhe Ministria përgjegjëse për arsimin kanë hartuar aktet nënligjore përkatëse dhe në bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH, ka finalizuar procesin e kodifikimit të programeve bazuar në ISCED-F 2013. Si rezultat i këtij procesi, vihet në zbatim kriteri ligjor që lidhet me përafrimin e programeve të fushave të ngjashme me të njëjtën emërtesë, duke patur si element dallues kodin përkatës (shiko kriterin 8 më poshtë). Por nga ana tjetër, edhe në ndërtimin e programit, apo përmirësimin e tij, Departamenti i Informatikes Ekonomike mbështetet vazhdimisht në programe të ngjashme, të institucioneve të ngjashme, brenda dhe jashtë vendit.<sup>47</sup></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Po, në kuadër të procesit të kodifikimit të programeve të studimit dhe në përmbushje të kërkesave të VKM nr. 310, date 11.05.2022 "Per specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe Udhezimit nr. 31, date 15.11.2022 "Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", programi i studimit MSH në "Informatike Ekonomike" (120 ECTS) ka kodin përkatës të miratuar: 72MS0688S<sup>48</sup>. Po kështu, çdo lëndë e programit ka kodin përkatës, të pasqyruar në syllabuset.<sup>49</sup></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit</p>	<p>TBU është e hapur për të realizuar programe të përbashkëta studimi në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit.<sup>50</sup></p>

<sup>47</sup> 67.1. VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 Kodifikimi programeve qbz; 67.2. Ministria e Arsimit “Për afatet e kodifikimit të programeve të Studimit ofruar nga institucionet e Arsimit të Lartë” nr. prot. 10, dt.18.01.2023; 67.3. Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf; 67.4. Korrespondenca me MAS mbi kodifikimin e programeve të studimit; 67.5. Shkresa e MAS Nr. 7381/22, dt. 30.12.2024 për “Konfirmimin e kodeve të programeve të studimit në Kolegjin Universitar Tirana Business University”; 61. Ligj. 80-2015. 22.07.2015.

<sup>48</sup> 67.1. VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 Kodifikimi programeve qbz; 67.3. Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf; 67.4. Korrespondenca me MAS mbi kodifikimin e programeve të studimit; 67.5. Shkresa e MAS Nr. 7381/22, dt. 30.12.2024 për “Konfirmimin e kodeve të programeve të studimit në Kolegjin Universitar Tirana Business University”.

<sup>49</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSH “Informatike Ekonomike” (shqip & anglishte).

<sup>50</sup> 3.1. Strategjia e Zhvillimit të TBU 24-29, fq. 12.



Handwritten signatures and initials in blue ink at the bottom of the page.

të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi II.2**

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, si njësi kryesore që ofron këtë program studimi, është i organizuar në tri departamente: Departamenti i Informatikes Ekonomike, Departamenti i Inxhinierise Software dhe Departamenti i Inxhinierise Komjuterike.<sup>51</sup> Struktura e Fakultetit, përbërja dhe funksionimi i tij janë të përcaktuara në Statutin e TBU<sup>52</sup> miratuar me Urdhër të MASR Nr. 417, datë 20.09.2017 (i përditësuar)<sup>53</sup>, dhe në përputhje të plotë me Ligjin 80/2015. TBU ka nisur dhe ushtruar veprimtarine akademike me VKM Nr. 794, datë 06.10.2010, me Urdhrin e MAS Nr. 75, datë 16.02.2011 si edhe me vendimin e akreditimit institucional dhe të çdo program studimi<sup>54</sup>. Fakulteti i Teknologjise se Informacionit ka filluar aktivitetin bazuar ne Urdhrin e MAS me Nr.195 date 20.4.2023 “Mbi hapjen e njesise kryesore “Fakulteti i Teknologjise se Informacionit” ne TBU” dhe programi Master i Shkencave ne Informatike Ekonomike me Urdhrin e MAS me Nr.458 datë 14.08.2023 “Mbi hapjen e programit te studimit te ciklit te dyte Master i Shkencave ne “Informatike Ekonomike” ne TBU”.</p> <p>Dekani i Fakultetit të Teknologjisë se Informacionit është titullari, i cili i propozon Rektorit emërimin e Përgjegjësit të Departamenteve (Neni 18, pika 1 dhe neni 24 i Statutit të TBU<sup>55</sup>), dhe ky i fundit ashtu si përcaktohet edhe në nenin 24 të Statutit është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit.<sup>56</sup> Njësia bazë përgjegjëse për programin është Departamenti Informatikes Ekonomike, që përmbush të gjithë detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin, përfshirë këtu edhe Marrëveshjen që TBU ka lidhur me MAS,</p>

<sup>51</sup> 2.2. Struktura Organizative TBU (Organigrama e re me vulën e MAS); 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU.


<sup>52</sup> 2. Statuti i TBU, Nenet 18, 19, 20, 22.

<sup>53</sup> 73. Urdher MAS nr. 417, dt. 20.09.2017 Miratimi i Statutit Kolegji\_Universitar.

<sup>54</sup> 62. TBU Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 794, dt. 06.10. 2010 Licensimi i TBU; 63. Urdhër MAS Nr. 75, datë 16.02.2011; 70. Urdher Nr.195 date 20.4.2023 Mbi hapjen e FTI ne TBU; 71. Urdher MAS Nr. 458, dt.14.08.2023 per hapjen e MSH Informatike Ekonomike.

<sup>55</sup> 2. Statuti i TBU; 6. Rregulloren e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit; 7. Rregulloren e Departamentit te Informatikes Ekonomike.

<sup>56</sup> 2. Statuti i TBU; 38. Vendimi për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimit Master i Shkencave ne Informatike Ekonomike.



	<p>në përputhje me Nenin 17 pika 7-e Ligjit 80/2015.<sup>57</sup> Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit (Neni 24 i Statutit të TBU përcakton funksionin dhe detyrat e tij). Për organizimin e punës, krahas akteve në nivel institucional si: rregullore IAL-je, Fakulteti dhe Departamenti, departamenti ka miratuar dhe një rregullore të dedikuar për programin e studimit Master i Shkencave në Informatike Ekonomike.<sup>58</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Angazhimi i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ bëhet në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore. Përgjegjësi i çdo departamenti, me fillimin e vitit akademik, i propozon dekanit emrat që do të jenë drejtuesit e praktikave profesionale të studentëve, si edhe “procesin e zhvillimit të praktikave profesionale në shoqëri tregtare (SHPK, SHA) ose/dhe OJF”; në institucione të tjera.<sup>59</sup> Në kuadër të praktikës profesionale studenti/ja, krahas seancave në auditor kryen praktikë në një institucion/organizatë/ kompani i mbikëqyrur nga pedagogu përgjegjës i praktikave dhe ose i departamentit. Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore, në rregulloren e Departamentit të Informatike Ekonomike, është e përcaktuar se: “Departamenti bashkëpunon me organizata të tjera për të mbështetur praktikën, internship-et dhe punësimin e studentëve”.<sup>60</sup> Institucioni ka hartuar edhe një dokument i titulluar: “Rregullore e Praktikës Mësimore”<sup>61</sup>, ku trajtohen elementët e realizimit të praktikës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit është titullari që i propozon Rektorit emërimin e Përgjegjës të Departamentit<sup>62</sup> dhe ky i fundit ashtu siç përcaktohet edhe në nenin 24 të Statutit është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit. Për këtë program studimi, me Vendim të Dekanit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (FTI) dhe në përputhje me organigramën e TBU-së, njësia bazë përgjegjëse për programin është Departamenti i Informatikes Ekonomike, i cili përgjigjet si për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” (120 ECTS). Me të njëjtin vendim është emëruar përgjegjësi i këtij departamenti në rolin e koordinatorit të programit të studimit, si dhe janë përcaktuar detyrat e tij për koordinimin e punës me njësitë e tjera bazë në nivel fakulteti që kanë lidhje me këtë program.<sup>63</sup> Gjithashtu, Dekani i Fakultetit të të</p>

<sup>57</sup> 57. Marrëveshja e MAS\_TBU\_dt.9.07.2024\_Përcaktimi i Personeli Akademik.

<sup>58</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip).

<sup>59</sup> 6. Rregullore e Fakultetit të Informatikes Ekonomike, Neni 13, pika j, fq. 9, 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëve Udhëheqës për Praktikën Mësimore për vitin 24-25 FTI.

<sup>60</sup> 7. Rregullore e Departamentit të Informatikes Ekonomike, Neni 4, fq. 2; 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit MSh-IE.

<sup>61</sup> 36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse; 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.2. Memorandum TIP\_TBU\_Subjekt; 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MSh-IE).

<sup>62</sup> 2. Statuti i TBU, Neni 18, pika 1 dhe Neni 24.

<sup>63</sup> 38. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit MSh\_IE.

	Tecnologjisë së Informacionit përcakton edhe personat përgjegjës për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve. <sup>64</sup>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi II.3**

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Informatikës Ekonomike, si njësia përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” (120 ECTS), është edhe njësia bazë e cila bën propozimet dhe ndjek mbarrëvajtjen e këtij programi studimi, bashkë me ndryshimet përkatëse eventuale. Si i tillë, Departamenti i Informatikës Ekonomike ka të gjithë informacionin e nevojshëm që ka lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen programit të studimit <sup>65</sup> Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” (120 ECTS).
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” (120 ECTS), është i ndërtuar mbi bazën e planit mësimor i cili jep informacion të detajuar në lidhje me llojin e veprimtarisë, numrin total të krediteve për çdo lëndë, ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit <sup>66</sup> . Ky program studimi është i organizuar në 2 vite akademike (4 semestra) me një total kreditesh 120 ECTS. <sup>67</sup> Çdo vit akademik përmban 60 ECTS me ndarje të lëndëve të tipologjisë A, B, C, D dhe E. Gjuha e programit të studimit është Shqip. Në Rregulloren e institucionit, <sup>68</sup> Rregulloren e programit të studimit <sup>69</sup> si dhe në çdo

<sup>64</sup> 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI.

<sup>65</sup> 16.1. Kurrikula e programit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip); 16.3 Plani mësimor i programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS.

<sup>66</sup> 16.1. Kurrikula e programit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip); 16.3 Plani mësimor i programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS; 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip).

<sup>67</sup> 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Neni 17.

<sup>68</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU.

<sup>69</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip); 16.1. Kurrikula e programit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip); 16.3 Plani mësimor i programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS.

	<p>syllabus<sup>70</sup> përcaktohen rregullat për frekuentimin e mësimit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” (120 ECTS) përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që kanë lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve të cilat janë të specifikuar në Rregulloren e TBU-së,<sup>71</sup> në Rregulloren e transferimeve të TBU-së,<sup>72</sup> dhe në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” (120 ECTS).<sup>73</sup> Në këto dokumente të përmendura ndodhet i gjithë informacioni i nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit, njohjes së krediteve. Konkretisht, në nenin 12 të Rregullores së Programit të studimit Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” (120 ECTS) përcaktohet se: “a) Programi i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike”, është program i hapur për të gjithë ata studentë që zotërojnë diplomë Bachelor të shoqëruar me suplementin e diplomës, shqiptare ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe për studentët me transferim dhe b) Në këtë program studimi pranohen edhe kandidatët/studentët të cilët kanë një diplomë universitare të marrë në një institucion të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit dhe kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi.”<sup>74</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Ashtu sikurse është evidentuar edhe në kriteret e tjera më lart të këtij standardi, të gjitha elementët që kanë të bëjnë me programet lëndore (syllabuset),<sup>75</sup> strukturën e programit dhe planet mësimore<sup>76</sup> janë në përputhje të plotë me formatet e miratuara nga VKM Nr. 41, 24.01.2018 (e ndryshuar).<sup>77</sup> Në to paraqitet informacion i detajuar në lidhje me pasqyrën informative të lëndës, objektivat e të nxënies, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës (të renditura sipas javëve), formatet e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literaturën e detyrueshme (për çdo temë) dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë, dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale</p>	<p>Para fillimit të çdo viti akademik njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi (në bashkëpunim edhe me Departamentin e Inxhinierise Software që lidhet me të në lidhje me profilin “Inxhinieri Software”) bëjnë propozimin për planet mësimore që do të zbatohen për atë vit akademik, duke bërë propozime konkrete për ndryshime, përmirësime apo përditësime. Këto ndryshime kanë të bëjnë me shtesë lëndësh të reja për t’ju përshtatur kërkesave të tregut të punës për</p>

<sup>70</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSh\_IE (shqip & anglisht); 22 Formati i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018.

<sup>71</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Kreu III, Neni 6.

<sup>72</sup> 32. TBU - Rregullore e transferimeve 2024, Kreu II, Nenet 4-9.

<sup>73</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip).

<sup>74</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip), Neni 12, pika a dhe b.

<sup>75</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSh\_IE (shqip & anglisht); 22 Formati i

Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018.

<sup>76</sup> 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip).

<sup>77</sup> 65. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar; dhe 22. Formati i

Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018.

dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	njohuri dhe aftësim, kombinime lëndësh, që i shërbejnë më mirë formimit të studentëve, etj. Departamenti propozon ndryshimet në kurrikulë dhe Zyra e Kurrikulave shqyrton propozimin nëse përmbush kriteret ligjore. Më pas propozimi kalohet në dekanat dhe miratohet në Senatin Akademik, si hallka fundore e procesit <sup>78</sup> . I gjithë procesi, duke filluar nga propozimi i njësisë bazë e deri në vendimmarjen përfundimtare nga Senati duhet të dokumentohet dhe arkivohet pranë departamentit përgjegjës për programin e studimit, por për shkak të kohës së shkurter nga themelimi i FTI, deri tani nuk kemi pasur ndryshime. <sup>79</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.4</b>	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Po, i gjithë programi i studimit është konceptuar dhe organizuar në mënyrë të tillë që të përmbushë këto objektiva të thellimit të njohurive, ekspertizës dhe aftësimin të studentëve për tregun e punës.  Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarisë mësimore, shpërndarja e lëndëve në semestra dhe detyrimet përmbyllëse, mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve. Programi mësimor (lëndët) janë të organizuara në 5 kategori (A-E), si: <i>lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, me vlerësimin përkatës në orë mësimore e kredite</i> <sup>80</sup> . Plani mësimor i programit të studimit ka të integruar dhe të ndërthurur komponentët teorik me ato praktik. Në vitin e parë të studimit në programin Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike (120 kredite) studentët pajisen me njohuri të formimit në lende ndërdisiplinare/integruese/profilizuese dhe karakterizuese të kësaj fushe. Ndërsa në vitin e dytë vazhdojnë të ndjekin lëndë me njohuri të formimit të përgjithshëm, lëndë karakterizuese dhe lëndë ndërdisiplinare/integruese/profilizuese, duke përfshirë këtu edhe komponentin shumë të rëndësishëm të praktikës profesionale, që merr theks të vecantë në TBU, bashkë me detyrimin tjetër të dorëzimit të temës së diplomës/provimin të përgjithshëm (si detyrime përmbyllëse në kuadër të

<sup>78</sup> 2. Statuti i TBU, neni 14; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Neni 10; 7. Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike, Neni 4.

<sup>79</sup> 51.-Ndryshimet e kurrikulës MSh\_IE (Aneks Tabela 11).

<sup>80</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh "Informatikë Ekonomike" 120 ECTS (shqip), fq. 3-9; 16.3 Plani mësimor i programit të studimit MSh "Informatikë Ekonomike" 120 ECTS (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Informatikë Ekonomike" 120 ECTS.

	<p>organizimit të këtij programi studimi). Ne besojmë se përgatitja dhe aftësimi i studentëve me njohuri të thelluara të fushës dhe aftësimi i tyre për t'u punësuar gjatë (përpara përfundimit të studimeve) ose menjëherë pas përfundimit të studimit, është një nga pikat më të forta të TBU-së, dhe ky program studimi është organizuar/konceptuar në kuadër të realizimit të këtij qëllimi parësor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Ashtu sikundër evidentuam edhe në kriterin më lart, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike (120 kredite) bën të mundur arritjen e objektivave formuese të studentit, i përgatitur për të qënë i aftë për tregun e punës menjëherë pas diplomimit (ose edhe përpara tij). Shpërndarja e lëndëve realizohet përkatësisht në 4 semestra të shtrira përgjatë 2 viteve akademike, me kreditet e orët mësimore përkatëse, përputhet me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është në funksion të objektivave formues të programit e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit të studentëve<sup>81</sup>. Syllabuset e lëndëve në këtë program studimi (ashtu sikundër edhe në programet e tjera që ofrohen në TBU) kanë rubrikat e kontrollit të dijeve të ndarë në: pjesëmarrjen aktive në auditor, detyrë/ese/projekt përgjatë semestrit, provimin e ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar.<sup>82</sup> Pra, ky program studimi harmonizon dhe optimizon shpërndarjen e lëndëve në semestra, si edhe vlerësimin në kredite e orë mësimore për arritjen sa më të mirë të objektivave formuese dhe rezultateve të nxënit dhe aftësimit profesional. Rezultatet e arritura për përmbushjen e objektivave formuese të programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike 120 ECTS, si në terma të mësimnxënies dhe atë të aftësimit profesional dhe punësimit të studentëve, evidentohen edhe në raportin të analizës periodike nga ana e departamentit përgjegjës.<sup>83</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Organizimi i këtij program studimi (i sqaruar në dy kriteret më lart të këtij standardi) që në fillimet e tij është kujtuar duke marrë për bazë praktikën më të mira ndërkombëtare, por edhe në vazhdimësi është dhe do të përmirësohet për të qënë koherent me zhvillimet e reja të njohurive dhe atyre të fushës së informatikës ekonomike. Struktura e programit është e mirëgërshetuar, ku lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në harmoni të plotë me atë çka kërkon një program i një niveli Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” (120 kredite) si në nivelin kombëtar, edhe atë ndërkombëtar për sigurimin e aftësive, kompetencave të nevojshme dhe formimin të thelluar profesional të studentëve. Studentët e këtij programi mund të lëvizin edhe në universitete jashtë vendit (apo brenda vendit) për të përfunduar këtë program, pasi ai është ndërtuar në harmoni me kurrikula të ngjashme që ofrojnë universitete të vendeve Perëndimore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave</p>	<p>Forma dhe ndarja e veprimtarive formuese të programit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” 120 ECTS, është e tillë që mundëson një kombinim optimal të dijeve teorike me aftësimin praktik të studentëve. Fleksibiliteti që ofron kjo strukturë në raportet midis lëndëve bazë, karakterizuese,</p>

<sup>81</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatikë Ekonomike” 120 ECTS (shqip), fq. 2-9; 16:3 Plani mësimor i programit të studimit MSh “Informatikë Ekonomike” 120 ECTS (shqip).

<sup>82</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSh IE (shqip & anglisht).

<sup>83</sup> 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MSh IE.

<p>formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>ndërdisciplinore e ato me zgjedhje lehtëson çdo proces transferimi studimesh nga dhe në TBU. Kjo reflektohet në gamën e gjerë të lëndëve të ofruara për këtë program, dhe mundësitë për zgjedhje.<sup>84</sup> Gjatë dhe deri në përfundim të studimeve të këtij programi studimi, studentët përgjithësisht aftësohen për tregun e punës, si edhe të kenë mundësi të ngjisin shkallët e karrierës. Gjithashtu, programi mundëson transferimin e studimeve, mobilitetin e studentëve në universitete të tjera në rast të një zgjedhjeje të tillë nga ana e studentëve, sikurse dhe punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve pasi programi i studimit i pajis me ato me njohuritë dhe kompetencat e përshtatshme të fushës së studimit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit garanton formimin e aftësive dhe kompetencave profesionale për studiues dhe ekspertë të fushës së Informatikës Ekonomike, vecanerisht si Data Analyst, Business Intelligence Analyst, Financial Analyst, Market Research Analyst, Risk Analyst, etc. Ky program ofron dije, aftësi dhe kompetenca, të cilat garantojnë punësim, por ngritje në karrierë, duke harmonizuar dijet teorike me aftësimin praktik. Lëndët e programit kombinojnë teorinë me shembuj dhe raste studimore praktike nga biznesi shqiptar apo i huaj. Theksi i fortë dhe avantazhi i madh që TBU (në krahasim me universitetet e tjera në vend) ka në kryerjen/ofrimin e praktikave të mirëfillta profesionale/të punës duke ofruar gamën e gjerë të mundësive brenda kompanive të grupit BALFIN, garanton që punësimi i studentëve gjatë ose menjëherë përfundimit të studimeve të jetë një objektivi i arritshëm. Kështu, kurrikula e programit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” 120 ECTS<sup>85</sup>, bën të mundur përfitim të dijeve, aftësive e kompetencave që synohen nga programi i studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve që ofrohen në këtë program studimi<sup>86</sup> janë në përputhje me vendimet ligjore<sup>87</sup> (pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënësve, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu), dhe kontrollohen në fillim të cdo semestri nga përgjegjësit e grup-lëndëve përkatëse dhe përgjegjësi i departamentit përkatës (të Departamentit të Informatikës Ekonomike).<sup>88</sup> Në mënyrë periodike, institucioni dhe përgjegjësat e departamenteve në TBU u kërkojnë pedagogëve përditësimin e syllabuseve me literaturë bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit, por edhe të përfshijnë tema/cështje në përputhje me zhvillime të fundit, apo në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Mund të thuhet se ekziston “problematika” që në disa lëndë specifike të jetë ende inercia për të mos futur literaturë të pesë viteve të fundit (edhe për shkak të mungesës së botimeve të rëndësishme në fushat përkatëse), megjithatë kjo problematikë synohet të kapërcehet nga ana e institucionit duke nxitur pedagogët të përditësojnë literaturën bazë të lëndëve me</p>

<sup>84</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip), fq. 2-9; 16.3 Plani mësimor i programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS.

<sup>85</sup> 16.1. Kurrikula e programit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip).

<sup>86</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSh IE (shqip & anglisht).

<sup>87</sup> 65. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar; 22. Formati i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018.

<sup>88</sup> 39. Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve.

	<p>literaturë relevante të viteve të fundit, dhe duke futur procedurën e blerjes së literaturës në TBU me kërkesë nga stafi akademik.<sup>89</sup> Njekohesisht është rekomanduar dhe zbatuar përfshirja e elementeve të “Politikës së Rritjes së Angazhimit Akademik dhe Mesimdhënie”, si pjesë e syllabuseve duke pasuruar syllabuset dhe rritur cilësinë e mesimdhënieve.<sup>90</sup></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në evidentimet që kemi bërë në kriteret më lart në këtë standard, konkludojmë se programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” 120 ECTS, si anëtarë të Raportit Vlerësimi të Brendshëm arrijmë në konkluzionin se ky program u ofron studentëve njohuri të specializuara dhe të thelluara në fushën e informatikës ekonomike, duke u dhënë mundësi studentëve të marrin baza për të vijuar me studime të mëtejshme nëse ata dëshirojnë (edhe në ndjekje të proceseve të certifikimit profesional në profesionet e dedikuara si p.sh: Menaxher Projekti i Certifikuar, Auditues i Certifikuar në Sistemet e Informacionit, etj), të përshtaten plotësisht me kërkesat në tregun e punës, si edhe të synojnë më tej rritjen në karrierë të tyre.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.5</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri I.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>TBU rishikon në çdo vit të ri akademik përmbajtjen e programeve të tij të studimit. Procesi i rishikimit të programit dhe syllabuseve ndërmerret së pari nga secili departament i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, duke zhvilluar një diskutim mes anëtarëve të departamentit, procesi i cili zhvillohet para fillimit të secilit vit. Departamentet organizojnë diskutime gjithashtu me menaxherë dhe ekspertë të fushave, si p.sh.: nga kompanitë në sektorë të ndryshëm të "Balfin Group", për të shfrytëzuar eksperiencën e tyre në analizën dhe identifikimin e nevojave aktuale të tregut të punës. Përveç kësaj edhe partnerë të tjerë fitohen të japin përvojën në lidhje me fusha të caktuara si edhe organizohen takime periodike me bordin e tregut të punës të cilët përfshijnë edhe studentë të diplomuar Alumni të TBU-s<sup>91</sup>. TBU gjithashtu organizon mbi baza intervalesh</p>

<sup>89</sup> 47.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU.

<sup>90</sup> 72. TBU Academic Engagement and Learning Enhancement Policy.

<sup>91</sup> 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FTI; 14.1.1. Axxhenda e Takimit me BTP 2023-2024: 14.1.2. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.

	<p>të rregullta kohore marrëveshje bashkëpunimi me biznesin për studentët<sup>92</sup> si dhe përfiton nga feedback-u dhe propozimet që këto kompani ofrojnë në lidhje me përmirësime të mëtejshme në programet e studimit.<sup>93</sup> Po kështu, mund të thuhet se TBU ka shfrytëzuar edhe eksperiencën e fituar nga programet e mobilitetit nën projektin Erasmus+, duke përfshirë këtë përvojë dhe të tjera nga universitete partnere në përmbajtjen e programeve mësimore.<sup>94</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në nenin 42 të Statutit të TBU-së përcaktohet shprehimisht se: “TBU mirëpret dhe garanton dëgjimin e mendimeve, vërejtjeve dhe propozimeve të këshillave studentorë për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm që lidhen me veprimtarinë mësimore kërkimore siç janë: planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve...”<sup>95</sup> Po kështu, siç u theksua në kriterin më lart, TBU në mënyrë periodike organizon takime me bordet e tregut të punës, ku pjesë studentët e diplomuar (ALUMNI) të tij, për të mbajtur kontakte të rregullta dhe konsultuar vazhdimisht me ta me qëllim përmirësimin e programeve të studimit. Si institucion ne besojmë se studentët (tanë) të diplomuar mund të na japin ekspertizën më të vyer, si edhe të evidentojnë nevojat më kryesore që ka tregu i punës, me qëllimin që programet e studimit të jenë konform dhe në përputhje me këto kërkesa. Po kështu, edhe studentët aktualë të TBU-së inkurajohen të marrin pjesë në mbledhje të hapura të Departamentit për të dhënë opinionet/propozimet e tyre apo të bëjnë diskutime në funksion të përmirësimit të programeve të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësi përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nisur nga fokusi i fushave kryesore të studimit që TBU ka, materializuar në programet e studimit me fokus biznesin, bashkëpunimi në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit zhvillohet dhe mbahet i vijueshëm kryesisht me sektorin privat. TBU dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit si njësi kryesore (për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” 120 ECTS) ka një numër të lartë partnerësh nga fusha e biznesit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të cilët asistojnë dhe bëjnë sugjerime/propozime në shumë aspekte. Bashkëpunimi me ta është i shtrirë edhe në fushën e tërheqjes së mendimit të tyre për përditësimin, përshtatjen dhe riorganizimin e programeve të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe ato të zhvillimit që ato kanë.<sup>96</sup> TBU ka në fokus gjithashtu edhe bashkëpunimin dhe partneritetet me universitete të tjera (brenda dhe jashtë vendit) dhe është pjesë e rrjeteve dhe projekteve të bashkëpunimit universitar, shkencor e akademik me disa prej tyre<sup>97</sup>.</p>

<sup>92</sup> 14.4 Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI; 36.2. Memorandum TIP\_TBU\_Subjekt; 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MSh-IE); 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore.

<sup>93</sup> 36.1 Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MSh-IE).

<sup>94</sup> 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

<sup>95</sup> 2. Statuti i TBU, neni 42, fq. 20.

<sup>96</sup> 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MSh-IE).

<sup>97</sup> 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Strategjia e Zhvillimit e TBU-së (2024-2029) <sup>98</sup> , Strategjia e kërkimit shkencor <sup>99</sup> si edhe eksperiencia tashmë 15 vjeçare e TBU në ofrimin e programeve të ndryshme të studimit, ka bërë që institucioni të ketë përvojën e duhur për të hartuar dhe përshtatur çdo program studimi në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. Këto objektiva janë të materializuara në Planin Strategjik 2023-2028 për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” 120 ECTS, ku si objektivi kryesor thuhet se është: “Objektivi kryesor i programit është të arrijë nivele të larta të cilësisë së produktit të vet - studentë me dije teorike dhe aftësi praktike, të tilla që rrisin ndjeshëm mundësitë e tij për punësim, si rregull, para mbarimit të studimeve për studentët e pa punësuar, ndërsa për studentët e punësuar gjatë studimit në programin Master ata të bëjnë një hap më lart në karrierë. <sup>100</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore (Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit), si edhe njësia baze (Departamenti i Informatikës Ekonomike), janë përgjegjëse për garantimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” 120 ECTS. Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron. Në nenin 12 të Rregullores së Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (si njësia kryesore e programit të studimit), si edhe në nenin 4 të Rregullores së Departamentit të Informatikës Ekonomike (si njësia bazë e tij), në lidhje me funksionet/kompetencat e Departamentit thuhet se ai:  “a. Nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, kërkimit shkencor apo aktiviteteve të tjera, duke respektuar liritë e personelit akademik dhe të drejtën për të shfrytëzuar materialin dhe burimet financiare në dispozicion të departamentit,  b. Shqyrton planet mësimore dhe i propozon Dekanatit ndryshimet e përshtatshme,  c. Rishikon programin mësimor, bën ndryshimet e nevojshme dhe ia propozon ato Dekanatit, <sup>101</sup> duke përzgjedhur kështu personelin akademik që

<sup>98</sup> 3.1. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.

<sup>99</sup> 3.2. Strategjia e kërkimit shkencor TBU.

<sup>100</sup> 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSh-IEA 120 ECTS, fq. 1. Kjo e pasuar edhe nga objektivat e tjerë në këtë plan strategjik.

<sup>101</sup> 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, neni 12, pika a, b, c; 7. Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike, Neni 4.



	<p>angazhohet ne mësimdhënie, si edhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me parimet dhe kriteret e vendosura për të garantuar që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm në fushën e studimit. Respektimi i lirisë akademike në procesin mësimdhënës dhe të kërkimit shkencor është i shprehur në nenin 14, pika 1 e Statutit të TBU-së, ku thuhet se: “Senati Akademik (si-organi më i lartë kolegjal akademik) garanton autonominë e TBU, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve”.<sup>102</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Ne dokumentet themelore të TBU-së, si: Statuti, Strategjia e Zhvillimit të TBU 2024-2029, Strategjia e Kërkimit Shkencor 2024-2029, etj., shprehet qartë vizioni i TBU për ofrimin e programeve të studimit që synojnë nxitje dhe motivim për studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.<sup>103</sup> Neni 25 i Statutit të TBU-së, i cili përcakton funksionet e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike brenda IAL-së, shpreh qartë në pikën 4 të tij se QKSEJ: “4. Tërheq dhe aktivizon në veprimtarinë shkencore dhe botuese studentët më të mirë të fakulteteve, përgatit për studentët module suplementare dhe veprimtari të tjera të ngjashme”.<sup>104</sup> Për programin e studimit, në çdo lëndë<sup>105</sup> është e sanksionuar detyra e kursit (tipikisht një ese, por edhe një projekt aplikativ) që i mundëson studentëve realizimin e një punë kërkimore plotësuese. Gjithashtu, përmbyllja e studimeve me punim diplome angazhon studentët e programit në thellimin e dimensionit kërkimor të tyre.<sup>106</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Në vizionin e Strategjisë së Kërkimit Shkencor të TBU-së, shprehet: “Në TBU, ne duam të sigurojmë një pozicionim të mprehtë të kërkimit tonë. Kjo do të thotë zgjedhje më të fokusuara bazuar në veçantinë dhe avantazhin konkurrues të kërkimit në grupe pune të përbashkëta: komunitet shkencor – komunitet biznesi, si dhe përafrim më efektiv me çështjet sociale dhe ekonomike jashtë TBU. Misioni ynë është që njohuritë themelore të krijuara përmes kërkimit të rrisin njohuritë dhe pasurinë tonë shkencore dhe kulturore dhe të ofrojnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin dhe inovacionin e produkteve dhe shërbimeve. TBU gjithashtu do të vazhdojë të investojë në objektiva kërkimore bashkëkohore që do të përmirësojnë cilësinë e kërkimit. TBU e konsideron integritetin shkencor dhe shkencën e hapur si parakusht thelbësor për cilësinë e kërkimit”.<sup>107</sup> Institucioni mbështet financiarisht organizimin e konferencës shkencore ndërkombëtare: “Technology &amp; Business Update”, e cila u mbajt për herë të parë në Nëntor 2024, dhe që planifikohet të organizohet çdo vit në muajin Nëntor. Gjithashtu, Institucioni nëpërmjet Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike si njësi bazë që organizon dhe drejton veprimtarinë kërkimore të TBU, zhvillohen mbi baza periodike aktivitete/seminare informuese dhe trajnuese mbi stafin akademik në lidhje me kërkimin shkencor, publikimin në revista të indeksuara me faktor impakti, si edhe është në diskutimin e mundësive të dhënies</p>

<sup>102</sup> 2. Statuti i TBU, neni 14, pika 1.

<sup>103</sup> 2. Statuti i TBU, neni 8, pika 2 dhe neni 25, pika 4; 3.1. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029, pika 5 (b), fq. 12-13; 3.2. Strategjia e kerkimit shkencor TBU, pika 4-6, fq. 7, 9-10.

<sup>104</sup> 2. Statuti i TBU, neni 25, pika 4.

<sup>105</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSh-IE (shqip & anglisht).

<sup>106</sup> 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” 120 ECTS (shqip).

<sup>107</sup> 3.2. Strategjia e kerkimit shkencor TBU, pika 3, fq. 6-7.

	<p>së granteve (si incentivë) kërkimore për publikimet në këto revista për stafin. Nje dokument i rëndësishem ne nxitjen e pedagogeve ne lidhje me kerkimin shkencor eshte ai i indikatorëve<sup>108</sup> i matjes se performaces ne kerkimin shkencor. Indikatorët e performaces kane per qellim te orientojne perafersisht pedagogun ne planifikimin dhe zbatimin e punes se tij vjetore ose te ciklit kontraktual ne TBU, edhe ne funksion te kualifikimit shkencor te tij ne funksion te rritjes se cilesise se performaces se tij si pedagog sa i perket mesimdhënies, kualifikimit shkencor per graden dhe titullin e metejshe, kerkimi dhe zhvillimin si nje bilanc i TBU-se, ne perputhje me modalitete kontraktuale qe i ka kontrata e pedagogut te brendshem ne TBU<sup>109</sup>.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi II.7**

**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin e studimit (Departamenti i Informatikës Ekonomike) mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore brenda departamentit dhe siguron bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit ka si mision kryesor studentin dhe përparimin e tij në studime e mësimnxënie, duke krijuar kështu një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të thelluara kërkimore e shkencore, si dhe mbështetje të studentëve. Organizimi i Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Technology &amp; Business Update” (mbi bazë të përvitshme) nga TBU, është një nga mediumet kryesoret për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor (për stafin akademik të përfshirë në programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” 120 ECTS, por edhe për studentët më të mirë që studiojnë në të dhe që shprehin/kanë aftësi kërkimore).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin</p>	<p>Në vizionin dhe misionin e TBU, kërkimi shkencor është në funksion të rritjes cilësore të mesimdhënies e mesimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës të studentët, si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. Këto janë të sanksionuara edhe si qëllime dhe objektiva strategjike në Stratëegjinë e Zhvillimit të Institucionit (2024-2029), ku përcaktohet: “Rritja e nivelit të kërkimeve, studimeve dhe veprimtarive krijuese dhe Rritja e rëndësisë</p>

<sup>108</sup> 42.1. Indikatorët e matjes së performances.

<sup>109</sup> 3.2. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU 24-29, 42.1. Indikatorët e matjes së performances, 42.2. Politika për grantet e punës kërkimore dhe shkencore, 42. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike – QKSEJ; 54.3. Raporti Vjetor institucional 23-24.

<p>akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p><i>kombëtare dhe ndërkombëtare të fakultetit, që rrjedh nga kërkimi, bursat dhe veprimtaritë shkencore.</i></p> <p><i>Obj. 1: Sigurimi i zhvillimit profesional për studentët dhe stafin, me fokus në kërkimin shkencor.</i></p> <p><i>Obj. 2: Zhvillimi dhe zbatimi i mekanizmave me të cilët do të informohen studentët për mundësitë e granteve dhe trajnimeve.</i></p> <p><i>Obj. 3: Mentorimi i studentëve për kërkimin, bursat, veprimtaritë krijuese dhe performuese.</i></p> <p><i>Obj. 4: Lehtësimi i procesit të pjesëmarrjes së studentëve të diplomuar në projekte multidisiplinare.</i></p> <p><i>Obj. 5: Botimi i një reviste shkencore ku të pasqyrohet puna shkencore e stafit akademik dhe studentëve.</i></p> <p><i>Obj. 6: Organizimi i konferencave shkencore ndërkombëtare me punime të stafit dhe studentëve.</i></p> <p><i>Obj. 7: Angazhimi i stafit akademik dhe atij studentor në projekte studimore kërkimi, në funksion të nevojave apo kërkesave që vijnë nga tregu dhe/ose kompani apo institucione të veçanta" Kjo na jep mundësi që të optimizojmë binomin pedagogë -studentë në nivelin e efikasitetit të transferimit të dijeve apo shkëmbimit të eksperiencave midis tyre".<sup>110</sup></i></p> <p>Për arritjen e këtyre objektivave, tashmë organizimi i konferencës shkencore ndërkombëtare është një objektivi i arritur (Konferenca e parë e mbajtur në Nëntor 2024, dhe do të organizohet mbi baza të përvitshme). Për sa i përket botimit të revistës shkencore nga ana e TBU-së, kjo gjë është duke u materializuar në kohën e shkrimit të këtij raporti të vlerësimit të brendshëm, me numrin e parë të revistës shkencore të TBU (Journal of Economics and Technology) që pritet të dalë së shpejti, dhe që do shërbejë si një platformë e rëndësishme për kërkimin shkencor të stafit akademik të TBU-së, si edhe studentëve më të mirë që mund të bashkëpunojnë ose të paraqesin vetë artikuj shkencorë. Së fundmi, por jo më pak më e rëndësishme për t'u theksuar është se TBU kërkon nga stafi akademik i brendshëm raportim të përvitshëm mbi punën kërkimore-shkencore për secilin pedagog/e,<sup>111</sup> duke kërkuar që secili/a në bazë të gradës ose titujve shkencorë të realizojë një minimum pikësh nga publikimi i artikujve shkencore/pjesëmarrja në konferenca shkencore apo në projekte/ekspertizë për të tretë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë</p>	<p>Programi parashikon organizimin dhe pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në aktivitete akademike dhe kërkimore. TBU ka organizuar konferenca shkencore të hapura dhe simpoziume ku stafi i departamentit është ftuar të kontribuojë me prezantime dhe diskutime tematike në fushën e informatikës ekonomike,</p>

<sup>110</sup> 3.1: Strategjia e Zhvillimit të TBU 24-29, pika 5 (b), fq. 12-13.

<sup>111</sup> 42.1. Indikatorët e vlerësimit të performancës kërkimore-shkencore për personelin akademik; 42.1.2. TBU Formulari i raportimit të punës kërkimore shkencore; 42.1.2. TBU - FORMULAR VETEDEKLARIMI PËR PUNËN KËRKIMORE SHKENCORE.

personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	teknologjise se informacionit dhe softuerit <sup>112 113</sup> . Këto aktivitete ndihmojnë në rritjen e profilit të programit dhe në krijimin e një kulture të vazhdueshme kërkimi.			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Departamenti ndjek rregullisht rekomandimet e shoqatave dhe rrjeteve profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit. Për shembull, struktura e programit është përshtatur sipas direktivave dhe nevojave të nxjerra nga forume si IEEE, ACM dhe bashkëpunëtorë lokalë si ICTSmedia dhe Albanian ICT Academy. Kjo siguron që kompetencat që fiton studenti janë të aplikueshme dhe të certifikueshme edhe nëse kërkohet licencim profesional në të ardhmen.			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Ky program, për shkak të natyrës së tij, nuk aplikon pajisjen e studentëve me marrjen e licencës së profesionit përkatës.			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian ( <i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	Ky program, për shkak të natyrës së tij, nuk aplikon pajisjen e studentëve me marrjen e licencës së profesionit përkatës, por i pajis ata me diplomën përkatëse: Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” 120 ECTS.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<sup>112</sup> 58.1. Brochure Scientific Conference TBU

<sup>113</sup> 58.2. Program of TBU Conference

**Standardi III.1**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në rregulloret përkatëse të TBU-së shprehen qartësisht format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive si: leksione, seminarat për çdo lëndë, ese/detyra e kursit, praktika profesionale, etj.<sup>114</sup> Njëkohësisht në formë më të detajuar edhe në planin mësimor të programit paraqiten veprimtaritë formuese të tij.<sup>115</sup></p> <p>Programi i Studimit Master Shkencor në Informatikë Ekonomike është program i ciklit të dytë me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike dhe me 120 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë. Programi mësimor është parashikuar të realizohet në 3,000 orë, nga të cilat 1,175 orë janë orë studimi në auditor dhe 1,825 janë orë studimi individual.</p> <p>Leksionet dhe seminarat zgjasin për 15 javë (semestri) dhe në javën e 14,<sup>116</sup> të semestrit studentët dorëzojnë detyrat e kursit/ esetë në lëndët e zhvilluara. Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies qartësisht janë të përshtatshme për realizimin e programit të studimit. Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. Gjithashtu, në bashkëpunim me tregun e punës, Departamenti ka zhvilluar leksione të hapura me ekspertë të fushës së informatikës ekonomike.<sup>117</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Format, mënyrat dhe metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të specifikuara në syllabusin e lëndës, i cili ndërtohet në përgjigje të nevojave të lëndës dhe studentëve, dhe përmban rubrika si: “Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës”, “Literaturë bazë e detyrueshme”, “Literaturë e rekomanduar”, etj.<sup>118</sup></p> <p>Në zhvillimin e lëndëve në auditor përdoren gjerësisht edhe mjete ndihmëse si tabela, kompjuteri, projektori, etj.<sup>119</sup> Metoda të tjera për t’iu përgjigjur diversitetit përfshijnë diskutime dhe punë në grupe me studentët, analiza e rasteve të studimit, organizimi i diskutimeve që</p>

<sup>114</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 7. Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike; 9. Rregullore e programit të studimit MSH IE; 55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.


<sup>115</sup> 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSH IE.

<sup>116</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 9. Rregullore e programit të studimit MSH IE.

<sup>117</sup> 19. Studimi për tregun e punës 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FTI; 14.1.1. Axhenda e Takimit me BTP 2022-2024; 14.1.2. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.

<sup>118</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSHIE (shqip & anglisht).

<sup>119</sup> 43. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve; 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB MSH IE).





	<p>nxisin mendimin kritik, ekspertët e ftuar në auditor, forumet me grupe specialistësh, apo personalitete.<sup>120</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Stafi akademik qëndron gjithnjë i gatshëm për të përqaftuar qasjet më të reja të kompetencave didaktike duke ofruar kështu mësimdhënie në nivel bashkëkohor.<sup>121</sup> Gjithashtu, personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe për t'u njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes.<sup>122</sup></p> <p>Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të jashtëm, duke vënë theksin në njohjen e specifikave të rregulloreve të TBU-së, si edhe në aspekte metodike dhe të organizimit të mësimi.<sup>123</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie përzgjidhet me kujdes. Kështu, Përgjegjësi i Departamentit së bashku me drejtues të tjerë të IAL-së, është i përfshirë si në procesin e rekrutimit<sup>124</sup> të personelit akademik të njësisë së tij (saj), ashtu edhe në vlerësimin periodik të performancës të personelit akademik të njësisë. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidatave, janë treguesit e performancës së kandidatëve, si psh. përvoja në mësimdhënie në nivel universitar, karriera profesionale jashtë auditorit, kualifikimet, titujt dhe gradat shkencore, etj.<sup>125</sup> TBU ka një kuadër rregullativ të brendshëm mbi të cilin mbështetet procesi i punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjeshme. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs.<sup>126</sup></p> <p>Gjithashtu, metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik, përshkruhen në silabusin e secilës prej lëndëve/moduleve të programit të studimit. Seksioni “Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës”, është një element i rëndësishëm në formatin e miratuar për syllabuset<sup>127</sup> e lëndëve të programit të studimit, duke përshkruar materialet për diskutim dhe rastet studimore për secilën prej temave. Në këtë program studimi përdorimi i metodave</p>

<sup>120</sup> 55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.

<sup>121</sup> 55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies; 42.3. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programeve të studimit MSH IE (Aneks Tabela 19).

<sup>122</sup> 46.3. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studenteve.

<sup>123</sup> 37.1 Politika për zhvillimin profesional të stafit; 37.1.1. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin; 35.11. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu.

<sup>124</sup> 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.2. Politika e BNJ-ne TBU

<sup>125</sup> 23. CV e stafit akademik të angazhuar në programeet e studimit.

<sup>126</sup> 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.1. Shembull njoftim për vend vacant për staf akademik në ëbsite; 13.2. Politika e BNJ ne TBU.

<sup>127</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSHIE (shqip & anglisht).






	<p>interaktive dhe diskutimit në mësimdhënie nuk kufizohet vetëm për orët e seminareve, por zgjerohet edhe në orët e leksioneve, ku pedagogët përfshijnë edhe materiale audivizuale, që krijojnë situata diskutimesh, duke mundësuar zhvillimin e leksioneve interaktive, duke i bërë ato më tërheqëse dhe duke i shtuar ndërveprimin gjatë zhvillimit të tyre. Zhvillimi i orëve interaktive, të cilat ndërthurin shpjegimet teoriko- aplikative, duke u fokusuar te ndërveprimi i vazhdueshëm pedagog – student, garantojnë zhvillimin intensiv të procesit të angazhimit të studentëve. Diskutimet, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet janë disa nga instrumentet kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve.</p> <p>Nëpërmjet literaturës së rekomanduar,<sup>128</sup> ose artikujve shkencorë të dhënë për t’u studiuar në mënyrë të pavarur, nxitet zgjerimi i konsiderueshëm i të nxënit të studentit jashtë auditorit. Për të kultivuar bashkëpunimin midis studentëve, detyrat e kursit në programet master zhvillohen përmes prezantimeve në grup të studentëve. Kjo formë vlerëson jo vetëm dijet e studentëve, por edhe aftësitë e punës në grup, si edhe bën që studentët të shkëmbejnë eksperiencat me njëri-tjetrin, dhe të nxisë të menduarit kritik të studentët.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Përfshirja e studentëve dhe marrja e mendimit të tyre në kuadër të përmirësimit të cilësisë së personelit akademik dhe metodave të mësimdhënies është në qendër të vëmendjes së TBU. Studentët angazhohen për të dhënë mendimet e sugjerimet e tyre. Mësimdhënia bashkëkohore kërkon planifikim të mirëfilltë të materialit mësimor, metodologjisë mësimore dhe teknikave që do të përdoren për të arritur objektivat mësimore. Personeli akademik përmirëson format e metodat e mësimdhënies falë angazhimit të studentëve në këtë proces.<sup>129</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC),<sup>130</sup> ngrihet në nivel institucional. Anëtarët e saj propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit.<sup>131</sup></p> <p>NJSBC është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ajo vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe</p>

<sup>128</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSHIE (shqip & anglisht.)

<sup>129</sup> 36.7. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet; 36.8. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve; 36.9. Formati i pyetesorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët; 36.10. Raporti i Fokus-Grupeve; 55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.

<sup>130</sup> 35.1. Rregullore e NJSBC.

<sup>131</sup> 35.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25; 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025; 35.5. Raporti vjetor i NJSBC 23-24.

<p>përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>legjisacionit në fuqi.<sup>132</sup> Në bashkëpunim me Komisionet e Cilësisë, kjo njësi propozon masa për përmirësimin e programeve akademike dhe garanton që institucionet të respektojnë standardet e akreditimit kombëtar dhe ndërkombëtar.<sup>133</sup> Gjithashtu, NJSBC bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon një sërë aktiviteteve të parashikuara në planin e saj të veprimit, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.<sup>134</sup></p> <p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse përgjithësisht janë të hapura e suportuese dhe mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Falë përkrahjes nga këto struktura bëhet e mundur përcjellja e dijeve konform teknikave me të reja dhe bashkëkohore, ku studenti mund të përvetësojë më lehtë informacionin e përcjellë.<sup>135</sup></p> <p>Personeli akademik nëpërmjet literaturës që përzgjedh, temave që përdor, shembujve me të cilët i ilustron, formave të mësimdhënies që përdor, të cilat pasqyrohen në syllabusin e lëndës, dhe që përmirësohen në çdo semester, kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu, personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik është pjesë e trajnimeve të vazhdueshme, dhe kërkimit shkencor me qëllim kualifikimin dhe avancimin e qasjes së tij kundrejt mësimdhënies apo kërkimit shkencor në nivele më të avancuara<sup>136</sup>. Përmirësimi i mësimdhënies dhe implementimi i metodave të reja<sup>137</sup> mundësohet edhe nëpërmjet zhvillimit të leksioneve të hapura; vlerësimit nga studentë dhe fokus-grup me studentët; vlerësimit të Dekanit dhe/ose Përgjegjës të Departamentit, etj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
----------	-----------

<sup>132</sup> 2. Statuti TBU, Neni 27 & 28; 35.1.Rregullore e NJSBC.


<sup>133</sup> 35.4.Plani pune i KC FTI 24-25; 35.6. Raport i KC FTI 2023-2024.

<sup>134</sup> 35.1.Rregullore e NJSBC; 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025.

<sup>135</sup> 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSHIE.

<sup>136</sup> 37.1 Politika për zhvillimin profesional të stafit; 37.1.1. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin; 35.11. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu; 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSHIE (shqip & anglisht).

<sup>137</sup> 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSHIE.





<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Format e kontrollit të dijeve përcaktohen në mënyrë shumë të qartë në rregulloren e TBU-së, Rregulloren e Fakultetit, Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e Programit të Studimit.<sup>138</sup> Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit të programit Master janë: aktivizimet në orët e seminareve, provimi i ndërmjetëm/detyrat e kursit apo projektet dhe testimi final. Të gjitha këto elemente i bëhen të ditur studenteve.<sup>139</sup></p> <p>Në Rregulloren e Programit të Studimit përcaktohet kontrolli i dijeve. Gjithashtu këto kritere dhe mënyra bëhen publike për studentin në formatin e syllabusit të lëndës që i prezantohet studentit që në fillim të lëndës.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Mënyrat e vlerësimit të njohurive përcaktohen në programin/silabusin e modulit dhe planit mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit të programit Master Profesional në fillim të procesit mësimor. Studentët informohen nga pedagogu përkatës mbi programin e modulit, detyrimet që kanë ndaj procesit mësimor, mënyrën e vlerësimit të dijeve që në orën e parë të mësimit. Në fillim të çdo semestri për çdo vit akademik, prezantohet nga pedagogu i lëndës silabusi i lëndës. Një pjesë shumë e rëndësishme është që studentët që në fillim njihen me detyrimet e lëndës dhe forma e organizimit të tyre, koha e shlyerjes së tyre përgjatë semestrit. Studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe koherente marrin informacione përkatëse lidhur me rezultatet e vlerësimit, si dhe diskutohen në mënyrë transparente këto rezultate. Çdo pedagog ka të publikuar në portalin LMS Silabusin që përmban formën e vlerësimit dhe leksionet.<sup>140</sup></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Gjatë gjithë vitit studentët janë në një proces të pandërprerë të mësuarit dhe vlerësimit nepërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, projekteve, rasteve të studimit dhe provimit përfundimtar. Detyrat e kursit janë një pjesë e rëndësishme dhe elementë vlerësimi për studentët e nivelit master. Detyrimet e lëndës janë të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i vazhdueshëm lejon studentët në këtë mënyrë të kenë mundësinë që të përgatiten mbi lëndën gjatë gjithë semestrit. Mënyrat e kontrollit të dijeve përcaktohen në syllabusin/modulin dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor të studimeve të tij Master. Në këtë program organizohet Provimi i Përgjithshëm me shkrim.<sup>141</sup></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<sup>138</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; 7. Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike; 9. Rregullore e programit të studimit MSHIE.

<sup>139</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSHIE; 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSHIE (shqip & anglisht).

<sup>140</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSHIE (shqip & anglisht); 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS.

<sup>141</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSHIE (shqip); 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSHIE (shqip & anglisht); 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSHIE (shqip).

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në Rregulloren e Kolegjit Universitar TBU, Rregulloren e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit MSH në Informatikë Ekonomike përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të studentëve. Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin Akademik. Si rregull, provimet e ndërmjetme zhvillohen në javën e 7-të semestrit me kohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare në fund të semestrit. Shpërndarja e komponentëve të vlerësimit është në formën: provim të ndërmjetëm, detyrë kursi, niveli i diskutimit në seminar apo detyrat praktike, provim përfundimtar. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, ku secilit student i përcaktohet një numër sekretimi i cili përkon me emrin dhe numrin e ID. Sekretimi i tezave ofron sekretim të identitetit të studentit dhe paanshmëri të vlerësimit. Në fillim të çdo moduli, pedagogët përkatës në shpjegimin e silabusit, informojnë studentët edhe për afatet e parashikuara të vlerësimit Vlerësimi i studentit mbi njohuritë, dijet e përfituara apo dhe aftësitë kontrollohet sistematikisht nga pedagogu i lëndës dhe vlerësimi i tyre përfshihet në vlerësimin përfundimtar të lëndës. Studenti që tejkalon numrin e lejuar të mungesave, humbet të drejtën për të hyrë në provimin përfundimtar përkatës dhe është i detyruar ta rindjekë lëndën kundrejt pagimit të një tarife, sipas parashikimeve të Kontratës së lidhur mes Studentit dhe TBU-së.<sup>142</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>TBU në këtë Program Studimi të Ciklit të Dytë MSHIE, por edhe në programe të tjera, në situatë të zakonshme është mbështetur në Rregulloren e Programit të Studimit mbi zbatimin e formave të testimit dhe vlerësimit të dijeve.</p> <p>TBU për vlerësimin dhe testimin e dijeve të studentit është shprehur qartësisht në Rregulloren e Përgjithshme të TBU-së, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit mbi mënyrat e vlerësimit dhe testimit të njohurive të marra në modulet e zhvilluar për programet e studimit në MSH në Informatikë Ekonomike.<sup>143</sup> Komunikimi i pikëve dhe vlerësimi i vazhduar i komunikohet studentëve në auditor, në mënyrë që studentët të kenë informacionin e plotë përpara zhvillimit të testimit final.</p>

<sup>142</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 21-30; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Neni 25-29; 9. Rregullore e programit të studimit MSHIE (shqip) Neni 11; 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSHIE (shqip & anglisht); 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore; 12.1. Kalendar akademik 2023-2024; 12.2. Kalendar akademik 2024-2025.

<sup>143</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU Neni 21-30. 9. Rregullore e programit të studimit MSHIE (shqip)

<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Mënyrat e vlerësimit të njohurive përcaktohen në programin/syllabusin e modulit dhe planit mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit të programit Master në fillim të procesit mësimor. Studentët informohen nga pedagogu përkatës mbi programin e modulit, detyrimet që kanë ndaj procesit mësimor, mënyrën e vlerësimit të dijeve që në orën e parë të mësimin. Në secilin prej lëndëve/moduleve të programit të studimit MSH, studentët në fillim të çdo semestri për çdo vit akademik, prezantohen nga pedagogu i lëndës me silabusin e lëndës dhe përmbajtjen e tij.<sup>144</sup></p>
	<p>Një pjesë shumë e rëndësishme është që studentët që në fillim njihen me detyrimet e lëndës dhe forma e organizimit të tyre, koha e shlyerjes së tyre përgjatë semestrit. Studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe koherente marrin informacione përkatëse lidhur me rezultatet e vlerësimit, si dhe diskutohen në mënyrë transparente këto rezultate. Çdo pedagog ka të publikuar në sitin personal në portalin e TBU-së (LMS) programet e lëndëve ku paraqitet një informacion i plotë mbi këto lëndë dhe përqindja e pikëve. Pra studentëve u bëhet e ditur struktura e lëndëve dhe përqindjet e pikëve për të gjithë elementët.<sup>145</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në korrigjimin që i bëhet tezave të provimit pedagogu komenton dhe evidenton të gjitha plotësimin/mosplotësimin që lidhen me trajtimin e tezës së realizuar nga çdo student dhe vlerësimi nga ana e tij kryhet për çdo pyetje për të dalë me tej në vlerësimin përfundimtar. Pedagogu komunikon individualisht me studentin për rezultatet dhe mangësitë. Vetëm pas kësaj procedure të dhënat dërgohen në sekretari.<sup>146</sup> Po kështu realizohet dhe korrigjimi i testeve dhe detyrave të kurseve në kuadrin e vlerësimit të vazhduar duke u evidentuar mangësitë dhe pikat e dobta të çdo studenti.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Procesi mësimor dhe testimi i njohurive të studentëve është realizuar në auditor nga pedagogu i lëndës. Pedagogu shmang mundësinë e pajisjeve kopjuese dhe monitorojnë vazhdimisht sallën e provimit për të shmangur komunikimin ndërmjet studentëve. Gjithashtu studentit nuk i lejohej të hyjë në sallë pa mjet identifikimi si dhe nuk i lejohej mbajtja dhe përdorimi i aparatit telefonik. Një rëndësi të veçantë si nga stafi akademik por dhe përgjegjësi e departamentit i është vënë hartimit të tezave të reja në çdo sezon provimi dhe në disa variante. Mbështetur në Rregulloren e programit, në kalendarin e mbyqyrjes së çdo sezoni provimi, të gjitha strukturat përgjegjëse në TBU mbi këtë proces, angazhohen që të sigurojnë një klimë të qetë dhe bashkëpunuese gjatë zhvillimit të provimeve. Pedagogu përgjegjës i lëndës në mënyrë sistematike angazhohet të mos tolerojë dhe evitojë në maksimum kopjimin në provime, plagjiaturën në</p>

<sup>144</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSHIE (shqip) Neni 11; 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSHIE (shqip & anglisht).

<sup>145</sup> 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programet e studimit – MSHIE (shqip & anglisht); 44.2. Guide për pedagogun për përdorimin e LMS.

<sup>146</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 27; 9. Rregullore e programit të studimit MSHIE (shqip).

	detyra kursi, punime të përbashkëta mes studentëve dhe të jenë sa më origjinal në performancën semestrale. <sup>147</sup>			
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Kontrolli i dijeve është një proces i vazhdueshëm i veprimtarisë akademike. Natyrisht ky element i rëndësishëm është institucionalisht i përcaktuar pasi në çdo fund semestri ka sezonin përkatës të provimeve. Provimi është testi përfundimtar që lidh ecurinë, teorike e praktike të studentit përgjatë lëndës, por ai është në të njëjtën kohë vazhdim dhe lidhje organike me testimin e fundit që student i nënshtrohet procedurës së provimit apo mbrojtjes së mikrotezës. <sup>148</sup> Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij ose të ankimojë rezultatin brenda 3 ditëve nga data e komunikimit të rezultatit. Kjo procedurë është e sanksionuar në statut, rregullore dhe procedurat e provimeve. Pedagogu u komunikoi studentëve rezultatet e fituara nga gjithsecili prej tyre përgjatë semestrit, veçmas për secilin element vlerësues dhe në totalin e këtyre elementeve. Kjo procedurë është e sanksionuar plotësisht në Rregulloren e TBU-së. <sup>149</sup>			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Mbështetur në Rregulloren e TBU-së: "Ankimimi i Studentëve", parashikon gjithë procedurën e punës që ndiqet nëse ngrihet një ankimim nga student në Sekretarinë e IAL-së. <sup>150</sup>			
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studenti ka të drejtë të ankohet për çdo vlerësim të bërë. Ankimi bëhet në sekretari. Pedagogu përkatës i departamentit i rishqyrton kërkesat dhe i komunikoi sekretarisë qëndrimin dhe vlerësimin për ankimimin duke u shprehur për rezultatin. Kur student i sërish nuk është dakord, kjo ankesë përcillet në departament, i cili kërkon shqyrtim nga komisionet e ngritura posaçërisht. Komisioni përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Kur ankesa është e drejtë njoftohet pedagogu i lëndës i cili e rimerr në provim ose në të kundërt nga shefi i departamentit ngrihet një komision për të rimarë në provim. Kopja e praktikës së ankesës së studentit dhe vendimet e komisionit për rivlerësimin e provimit, depozitohen në sekretarinë e fakultetit të teknologjisë së informacionit dhe një kopje drejtuesit të njësisë kryesore. <sup>151</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

<sup>147</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 22-25 & Neni 29; 9. Rregullore e programit të studimit MSHIE (shqip); 12.1. Kalendar akademik 2023-2024; 12.2. Kalendar akademik 2024-2025.

<sup>148</sup> 11. Udhezim për përgatitjen e temës së diplomës.

<sup>149</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU Neni 27; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Neni 28; 9. Rregullore e programit të studimit MSHIE (shqip).

<sup>150</sup> 5. Rregullore e Kolegjit-Universitar TBU, Neni 28.

<sup>151</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 28.



				X
--	--	--	--	---

**Standardi III.4**


**Programi i studimit garanton rritjen e aftësiwe krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit të MSH-së është hartuar në atë mënyrë që të ofrojë për studentët njohuritë dhe kulturën e domosdoshme, të mjaftueshme për mundësinë e studimeve të mëtejme. dhe thellimin e dijeve në jetë profesionale në mënyrë të pavarur. Kurrikula e programit në përputhje me VKM Nr 41, datë 24.01.2018 dhe 185 /25.03.2021 është hartuar duke mbajtur në konsideratë zhvillimet bashkëkohore në fushën e administrimit të biznesit, aftësimin e studentëve me njohuri aplikative dhe praktike, në funksion të përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të tregut të punës, si në nivel kombëtar dhe rajonal.<sup>152</sup> TBU ofron periodikisht edhe kurse afatshkurtra, disajavore kualifikimi në fusha dhe sektorë të veçantë të ekonomisë, kontabilitetit, financës, IT, etj.<sup>153</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësiwe të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësiwe të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, ekonomike, dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara. Studentët përgatiten me njohuri bazë aplikative në këtë fushë si dhe nëndisiplinat përkatëse, duke synuar formimin e specialistëve me kompetenca të zgjeruara praktike. Një ndër objektivat e këtij programi është të plotësojë nevojat dhe kërkesat e studentëve për njohuri dhe aftësi praktike në drejtime të ndryshme të administrimit të një biznesi si: menaxhimit strategjik, lidhshpimit në organizata, menaxhimit financiar, menaxhimit të burimeve njerëzore, etj.<sup>154</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentin, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>Në programin e studimit të MSHIE personeli akademik kujdeset që të zbatojë me rigorozitet dhe përgjegjshmëri të gjitha detyrimet e syllabusit të lëndës që mbulon. Format e kontrollit të zotërimit të aftësiwe të studentit në përfundim të lëndës, prezantohen që në fillim të modulit nga pedagogu dhe monitorohen në process që ato të përmbushen nga studentët si: detyra kursi, teste të ndërmjetme, angazhime në seminare, apo edhe projekte të përbashkëta grupi nëse ka. Studenti orientohet që gjithë kohën të grumbullojë informacionin e duhur që të jetë i përgatitur për detyrimet përmblylëse me punim diplome.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë</p>	<p>Metodologjia e hartimit të syllabuseve të çdo lënde realizohet në mënyrë që t'u japë studentëve aftësi të materializimit të leksioneve të marra nëpërmjet seminareve të bëra në mënyrë interactive, ku përfshihen detyra kursi, raste</p>

<sup>152</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSHIE (shqip); 16.1. Kurrikula e programit MSHIE (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSHIE 120; 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSHIE.

<sup>153</sup> 37.1.1 Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët.

<sup>154</sup> 16.1. Kurrikula e programit MSHIE (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSHIE.



<p>studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>praktike, debate të ndryshme etj. TBU i jep një vëmendje të veçantë përgatitjes praktike të studentit, kjo me qëllim që studentët të jenë kandidatë potencial për punësim direkt pas përfundimit të studimeve. Falë bashkëpunimit që TBU ka me aktorë vendas dhe të huaj nga fusha e teknologjisë së informacionit, informatikës, ekonomisë si dhe industrive të ndryshme, bëjnë të mundur dhe realizimin e shumë vizitave studimore dhe praktikave të ndryshme profesionale.<sup>155</sup> Gjatë zhvillimit të këtyre vizitave studimore, studentët kanë mundësinë të njihen me elementët më të rëndësishme dhe të nevojshme për formimin e tyre profesional. Ndërthurja e teorisë me praktikën është një sukses i garantuar për studentët e së nesërme në tregun e punës. Studentët e TBU të cilët kanë qenë pjesë e këtyre vizitave studimore, praktikave profesionale si dhe intershipeve të ndryshme, sot janë të punësuar në pozicione kyçe në administratën publike si dhe biznese lider në Shqipëri.<sup>156</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>TBU pjesë të strukturës organizative të tij ka Zyrën e Çështjeve Studentore e cila, organizon një sërë eventesh që janë në mbështetje të edukimit kurrikular dhe ekstrakurrikular si: trajnime, ëorkshop-e, leksione të hapura, etj. Pjesë e këtyre eventeve kanë qënë gjithmonë: stafi pedagogjik i brendshëm dhe/ose i jashtëm i TBU, partnerë, personalitete, të ftuar të cilët kanë kontribute të vyera në fushën e tyre profesionale dhe ndajnë me studentët e TBU ekperiencat/përvojat më të mira në jetën e tyre profesionale.<sup>157</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>TBU i mbështet studentët për zhvillimin e ideve dhe studimeve të tyre. Përmes ofrimit të programeve të studimit të përshtatura me nevojat e tregut dhe përmes partneritetit me industrinë dhe komunitetin e biznesit, TBU synon të edukojë një brez të ri profesionistësh, të cilët do të jenë të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e një tregu global. Kjo përputhet me nevojat e zhvillimit të vazhdueshëm të ekonomisë shqiptare dhe me kërkesat e një shoqërie moderne, të integruar në tregun ndërkombëtar. Si pjesë integrale e Balfin Group, TBU ka mundësinë të përfitojë nga një sërë avantazhesh dhe sinergjish, si:<sup>158</sup></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Mundësi për Bashkëpunim dhe Zhvillim:</i> TBU mund të përfitojë nga përvoja dhe burimet e Balfin Group, për të zhvilluar programe dhe projekte novative në fushën e arsimit dhe zhvillimit të biznesit e teknologjisë së informacionit.</li> <li>• <i>Akses në Rrjetin e Biznesit dhe Industri:</i> Nëpërmjet Balfin Group, TBU ka mundësi për të ndërtuar lidhje të forta me industrinë dhe bizneset, duke siguruar mundësi praktike për studentët dhe shkëmbim informacioni për fusha të ndryshme të biznesit dhe teknologjisë së informacionit.</li> <li>• <i>Burimet dhe Mbështetja Financiare afatgjatë:</i> Balfin Group mund të ofrojë mbështetje financiare dhe burime për zhvillimin e infrastrukturës, programeve akademike dhe projekteve novative të TBU-së.</li> </ul>

<sup>155</sup> 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MSHIE); 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

<sup>156</sup> 34. Të dhëna për punësimin real të studentëve 22-25 (Aneks-Tabela 22).

<sup>157</sup> 14.3. Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Master FTI; 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentet master FTI; 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore.

<sup>158</sup> 3.1. Strategjia e Zhvillimit të TBU 24-29; 3.1.1. Strategjia e Zhvillimit të TBU 18-24.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Përfitim nga Ekspertiza e Grupit:</i> TBU mund të përfitojë nga ekspertiza dhe përvoja e Balfin Group në fusha të ndryshme të biznesit dhe teknologjisë së informacionit, duke e bërë atë një institucion akademik më të përshtatshëm me kërkesat e tregut të punës.</li> <li>• <i>Mundësi për Programe të Përbashkëta dhe Shkëmbim Kulturor:</i> Balfin Group dhe TBU mund të zhvillojnë programe të përbashkëta, shkëmbime studentore, dhe veprimtari të tjera, kombëtare dhe rajonale, që promovojnë shkëmbimin kulturor dhe arsimor.</li> </ul> <p>Në vitin akademik 2022-2024, Grupi Balfin, përmes Fondacionit Mane, ka akorduar 7 bursa për studentët e TBU-së duke ofruar mundësi të rëndësishme për mbështetje financiare dhe zhvillimin e talenteve. Po ashtu, për vitin akademik 2024-2025, ky grup ka rritur angazhimin e tij duke akorduar 14 bursa për studentët e TBU, duke e konsoliduar rolin e tij si një partner kyç në edukimin dhe avancimin e të rinjve. Gjithashtu, Grupi Balfin është një nga mbështetësit kryesorë për praktikant dhe mundësitë e punësimit për studentët e TBU, duke ofruar mundësi reale për t'u përfshirë në sektorin e biznesit dhe të zhvillimit profesional. Menaxherët e këtij grupi, të cilët kanë përvojë të pasur në menaxhimin e bizneseve dhe industrive të ndryshme, zhvillojnë shpesh biseda, trajnime dhe leksione për studentët, duke i mundësuar atyre të zhvillojnë aftësi të vlefshme, njohuri të thelluara dhe lidhje profesionale që do t'i ndihmojnë në karrierën e tyre të ardhshme. Kjo mbështetje e vazhdueshme e Grupit Balfin krijon një mundësi të pasur për studentët e TBU-së për t'u integruar në tregun e punës dhe për t'u shndërruar në liderë të ardhshëm në industrinë e biznesit dhe teknologjisë.<sup>159</sup></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike, që në fillim të semestrit. <sup>160</sup> Diplomimi për programet e ciklit të dytë të studimeve “Master Shkencor” sipas L-AL bëhet nëpërmjet mbrojtjes së një punimi diplome në fushën e arsimimit të kryer. <sup>161</sup>

<sup>159</sup> 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

<sup>160</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 35-37; 9. Rregullore e programit të studimit MSHIE (shqip); 12.1. Kalendarit akademik 2023-2024; 12.2. Kalendarit akademik 2024-2025.

<sup>161</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 35.

<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Diplomimi për programet e ciklit të dytë të studimeve “Master Shkencor” sipas L-AL bëhet nëpërmjet përgatitjes dhe mbrojtjes së një punimi diplome në fushën e arsimit të kryer.<sup>162</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Për programin e studimit Master Shkencor në Informatike Ekonomike, detyrimet përmbyllëse realizohen vetëm nëpërmjet mbrojtjes së punimit të diplomës, duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Punimi i diplomës konceptohet si një projekt kërkimor-shkencor, që reflekton njohuritë e grumbulluara nga studentët gjatë gjithë ciklit të dytë të studimeve. Kjo formë synon të testojë aftësitë analitike, shkencore dhe profesionale të studentit, përmes një procesi që kombinon thellimin teorik me zbatime praktike të dijës. Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin se ai përfaqëson përmbylljen akademike të studentit dhe ka në fokus përdorimin e metodologjive bashkëkohore të analizës dhe zgjidhjes së problemeve në fushën e inxhinierisë software<sup>163</sup>. Komisioni i posaçëm i ngritur për administrimin e mbrojtjes së diplomës merr në shqyrtim njohuritë e fituara nga studentët përgjatë gjithë programit dhe se si ato janë pasqyruar në projektin/punimin final. Për realizimin e kësaj detyre përmbyllëse, studenti udhëhiqet nga një pedagog i brendshëm ose i jashtëm i programit, i përzgjedhur me vendim të departamentit përkatës. Komisioni i vlerësimit merr parasysh jo vetëm përmbajtjen tekniko-shkencore të tezës, por edhe aftësinë e studentit për të argumentuar qasjen e ndjekur, për të analizuar burimet dhe për të propozuar zgjidhje alternative. Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës specifikon qartë mënyrën e përzgjedhjes së temës, kërkesat për strukturën e tezës, si dhe kriteret e vlerësimit që do të përdorë komisioni përkatës<sup>164</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studenti që realizon mbrojtjen e diplomës me temë duhet të respektojë kërkesat e “Udhëzimit për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës në TBU”. Çdo student gjatë përgatitjes së punimit ka një udhëheqës i cili në vijimësi ka raportuar në department mbi ecurinë e punës për përgatitjen e punimit sipas standardeve të kërkuara dhe udhëzimit përkatës.<sup>165</sup></p> <p>Departamenti, gjatë shqyrtimit të propozimeve të studentëve për temën e tezës master, garanton që udhëheqësi i propozuar nga studentët të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe temën e propozuar. Nëse nuk konstatohet përputhshmëri, atëherë Departamenti cakton një pedagog udhëheqës që i përmbush këto kriteret. Studentët njoftohen për listën e miratuar me temat dhe pedagogët udhëheqës.</p> <p>Udhëheqësi kur bindet së punimi është me cilësinë së kërkuar dhe veçanërisht shmang plagjaturën jep miratimin për ta mbrojtur atë. Në rast të kundërt mbrojtja shtyhet në një sezon tjetër. Në përfundim të punimit të temës së</p>

<sup>162</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 35.

<sup>163</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSH Informatike Ekonomike” (shqip)

<sup>164</sup> 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës

<sup>165</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 35; 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës.

	<p>diplomës së studentit, pedagogu udhëheqës plotëson Formularin e Vlerësimit Individual për çdo student që e ka nën udhëheqje, në të cilin shpreh mendimin e tij objektiv dhe të pavarur.<sup>166</sup></p> <p>Siç përmendet edhe në kriterin 3 studentët e Master Shkencor në Informatikë Ekonomike (kohëzgjatje 2 vite akademike), duke qenë se fokusi i programit janë përvetësimi i aftësive shkencore nga ana e studentit, i nënshtrohen punimit shkencor si detyrim përmbyllës.<sup>167</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike trajton çështje të tilla si: sqarimin e aspekteve metodologjike, përpunimin e të dhënave me metoda sasiore dhe cilësore; punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave, etj<sup>168</sup></p> <p>Siç përmendet edhe në kriterin 3 studentët e MSH në Informatikë Ekonomike (kohëzgjatje 2 vite akademike) i nënshtrohen punimit shkencor si detyrim përmbyllës.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Siç përmendet edhe më sipër studentët mbyllin detyrimet e Masterit Shkencor me një punim shkencor vlerësuar me një total 100 pikë. Konvertimi i rezultatit me pikë në notë përfundimtare, bëhet sipas sistemit të vlerësimit në fuqi në TBU.<sup>169</sup> Në rastet e studentëve Master i Shkencave që mbyllin detyrimet e studimit me temë diplome, vlerësimi kryhet si vijon: Kryetari i Komisionit plotëson formatin përkatës dhe bën mbledhjen e pikëve të vlerësimit të udhëheqësit, oponentit dhe të secilit anëtar të Komisionit, e përpjesëton atë me numrin e vlerësuesve dhe bën konvertimin e rezultatit në notë përfundimtare, sipas sistemit të vlerësimit në fuqi në TBU. Në rastet kur udhëheqësi dhe/ose oponenti i temës janë edhe anëtarë të Komisionit, vlerësimi i tyre llogaritet vetëm një herë. Rezultati përfundimtar shënohet në procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve.<sup>170</sup></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve të ciklit të dytë master shkencor studenti pajiset me diplomën dhe suplementin përkatës të programit Master. Studenti në suplementin e diplomës ka programin e zhvilluar me kreditet dhe vlerësimin përkatës gjatë dy viteve akademike sipas standardeve Evropiane me 120 kredite.<sup>171</sup></p> <p>Studentët mund të pajisen edhe me syllabuset të shkurtuara përkatëse të lëndëve të zhvilluara sipas programit në bazë të një kërkesë të depozituar në sekretarinë mësimore.<sup>172</sup></p>

<sup>166</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 35; 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës, Shtojca 4.

<sup>167</sup> 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës.

<sup>168</sup> 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës, Shtojca 2.

<sup>169</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 21.

<sup>170</sup> 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës, fq.18; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 21.

<sup>171</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 38; 17.1. Forma e re e propozuar e diplomës për MSHIE; 17.1.1.

Forma e re e propozuar e suplementit për MSHIE.

<sup>172</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 38.


<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Dokumentacioni i studentit në momentin e regjistrimit dhe në vijim dorëzohet dhe ndiqet nga sekretaria mësimore.<sup>173</sup> Kjo dosje transferohet në zyrën e arkivit të TBU-së kur studenti diplomohet/ transferohet/crregjistrohet. Dosjet individuale të studentëve pasi diplomohen/transferohen/crregjistrohen arkivohen duke u bashkangjitur edhe fotokopje e diplomës dhe suplementit në dosjen e tij. TBU ruan dhe arkivon sipas Ligjit Nr.9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Rregullores mbi funksionimin e arkivit në TBU të gjitha të dhënat e tjera në lidhje me regjistrin e amzës, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistri i tërheqjes së diplomave të lëshuar nga QSHA. Sekretaria e ushtron detyrën bazuar në Rregulloren për Sekretarinë Mësimore dhe kryen një sërë shërbimesh si: regjistrimi i studentëve, marrja e kërkesave dhe dokumentimi dhe bashkëpunimi dhe mbajtja e dosjes për procesin e transferimeve të studentëve, përditesimi i informacionit për portalin e TBU-së, përgatitja dhe dhënia e vërtetimeve të ndryshme gjatë studimeve dhe pas përfundimeve të cikleve të studimeve, konfirmimi i përfundimit të ciklit të studimeve, përgatitja dhe dhënia e vërtetimeve sipas kërkesave të studentëve si: ( vërtetime si student, listë pjesore të notave, vërtetime diplomimi, etj.) përgatitja dhe dhënia e diplomës dhe suplementit të diplomës, konfirmimi i vërtetësisë së diplomës, përgatitja dhe dhënia e listës së notave, përgatitja dhe dhënia e vërtetimeve të diplomës, përgatitja dhe dhënia e programeve të studimit. Informacion më i detajuar në lidhje me planin mësimor dhe ngarkesën orët në auditor mund të gjendet në format të shkruar dhe është i aksesueshëm me kërkesë të çdo studenti në sekretarinë përkatëse apo pranë zyrës së arkivit të institucionit.<sup>174</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.6</b></p>	
<p>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për</p>	<p>Departamenti i Informatikës Ekonomike dhe strukturat përkatëse, përmes bashkëpunimit me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës, garantojnë mundësitë e nevojshme për realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve pritëse.<sup>175</sup></p>

<sup>173</sup> 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore.

<sup>174</sup> 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore; 56. Rregullore e Arkivës.

<sup>175</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 33 & 34; 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.2. Memorandum TIP\_TBU\_Subjekt; 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MSHIF 120); 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëve Udhëheqës për Praktikant Mësimor për vitin 24-25 FTI.



41

<p>realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Nga ana tjetër, infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Auditorët e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura secili me desktop, projektorë, akses në internet me kabëll dhe mjete të tjera didaktike.</p> <p>Në të gjitha mjediset e TBU-së është e mundur lidhja e paisjeve kompjuterike me internetin nëpërmjet eifi. Kjo bën të mundur realizimin gjatë procesit mësimor të lidhjes me faqe të ndryshme eeb-i për ti ardhur në ndihmë stafit akademik të ilustrojnë me shembuj konkretë tematika të caktuara. TBU ka integruar disa sisteme të rëndësishme IT për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Këto sisteme përfshijnë: një Sistem të Menaxhimit të Mësimimit (LMS) të bazuar në Moodle, Office 365 për studentët dhe stafin akademik, dhe SharePoint për menaxhimin e skedarëve dhe informacionit dokumentar. Interneti sigurohet nga ISP-ja Tring Albania.<sup>176</sup> Këto sisteme jo vetëm që rrisin efikasitetin dhe produktivitetin, por gjithashtu përmirësojnë përvojën e përgjithshme të studentëve dhe stafit akademik. Përdorimi i Moodle, Office 365, SharePoint dhe një lidhje të besueshme interneti nga Tring Albania krijon një mjedis mësimor dhe administrativ që nxit inovacionin, bashkëpunimin dhe suksesin akademik.<sup>177</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Studentëve u mundësohet kryerja e praktikës në institucione të ndryshme me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi. Në këto institucione ata njihen me format dhe teknologjitë më të fundit dhe bashkëkohore, me qëllim përfitimin sa më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale që lidhen me këtë fushë në të cilën ata po studiojnë.<sup>178</sup></p> <p>Gjithashtu, Zyra e Çështjeve Studentore mbështet studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, duke ofruar konsulencë për aplikime dhe shpërndarë informacion për mundësitë e punësimit, apo mundësitë për vazhdimin e specializimeve brenda ose jashtë vendit me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.<sup>179</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me</p>	<p>Praktika Profesionale për programet MSH në Informatikë Ekonomike ka 12 kredite; pra një detyrim prej 300 orë punë për studentin, e cila realizohet e shpërndarë në dy vite. Përpara se studenti të futet në procesin e vlrësimit për praktikën e realizuar, dorëzon raportin e praktikës te pedagogu përgjegjës. Zyra e Çështjeve Studentore, në bashkëpunim me pedagogun përgjegjës për praktikën, përgatit dosjen e studentit (formulari aplikimi i praktikës, formular</p>

<sup>176</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5 fq. 5; 44.1.1. Udhëzues për përdorimin e strukturës së TI deri në Dhjetor 23; 48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17); 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS; 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS.

<sup>177</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5 fq. 6-8.

<sup>178</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 33 & 34; 36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse; 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.2. Memorandum TIP\_TBU\_Subjekt; 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MSHIE 120); 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëve Udhëheqës për Praktikrat Mësimore për vitin 24-25 FTI.

<sup>179</sup> 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 14.2. Panairi i punës-2024 (ftese); 14.3. Aktivitete të realizuara nga zyra për studentët FTI; 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët FTI.

mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	miratimi i praktikës, formular-i vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi në institucion/organizatë/kompani, dhe raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës) dhe më pas i kalohet komisionit vlerësues. Vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet përpara një komisioni duke ndjekur një procedurë të caktuar. Komisioni përbëhet nga tre pedagogë me titullin Dr. Kryetari dhe dy anëtarë të cilët vlerësojnë praktikën e studentit, mbi bazën e raportit të zhvillimit të praktikës mësimore dhe formularit të vlerësimit të studentit praktikant. <sup>180</sup>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë	<p>Personeli akademik, i angazhuar me kohë të plotë dhe të pjesshme në programin e studimit MSH në Informatikë Ekonomike, është në përputhje me kërkesat e L-AL 80/2015. Ai përfshin pedagogë me kualifikime të përshtatshme akademike, tituj dhe grada, duke përfshirë lektorë, ndihmës lektorë dhe specialistë të fushës përkatëse. Detyrat dhe rolet e tyre janë të përcaktuara qartë, gjithmonë në përputhje me objektivat dhe qëllimet e programit.<sup>181</sup></p> <p>Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie sipas fushave të tyre të diplomimit dhe specializimit. Niveli i kualifikimit dhe fusha kërkimore e çdo</p>

<sup>180</sup> 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSHIE 120 (shqip); 36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse Neni 6 & fq.5-15; 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTL.

<sup>181</sup> 26. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2); 27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit MSHIE 120 (Aneks Tabela 6.12.7 & 8); 28. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit MSHIE 120 (Aneks Tabela 4); 23. CV e stafit akademik të angazhuar në programet e studimit.

<p>kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>anëtari të stafit janë të përputhshme me programin e studimit. Modulet mësimore shpërndahen bazuar në përvojën kërkimore dhe praktike të pedagogëve. Çdo njësi bazë ka së paku dy pedagogë me gradë shkencore, ose titull akademik.<sup>182</sup></p> <p>Grada minimale për stafin akademik të përfshirë në mesimdhënie është “Master i Shkencave”. Ngarkesa mësimore shpërndahet në përputhje me gradën shkencore dhe titullin akademik, duke respektuar normat e përcaktuara nga Senati Akademik.</p> <p>Zyra për Burimet Njerëzore (ZBNJ) siguron që kontratat e punësimit të përcaktohen sipas kategorisë së personelit akademik, në përputhje me LAL 80/2015, Statutin dhe Rregulloret e TBU-së. Çdo modul mbulohet nga personel akademik me kualifikimin e duhur dhe profil studimi të përputhshëm me fushën formuese dhe kërkimore të modulit.<sup>183</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore. Gjithë stafi akademik i TBU sipas fushës së kualifikimit që ka, angazhohet në programet e studimit të Ciklit të Dytë dhe për këtë arsye ata kanë një ngarkesë të vlerësuar në këto programe studimi. Ata janë kryesisht të kategorisë Profesor dhe natyrisht Doktor.<sup>184</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi demonstroi qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi në procesin mësimor në TBU. Një pjesë e mirë e personelit akademik rezultoi të ketë vite pune në TBU. Si rezultat, ata kanë ndërtuar një klimë bashkëpunuese me studentët, kolegët dhe punëdhënësit, e cila reflektohet në të gjithë mjediset e institucionit.<sup>185</sup></p> <p>Marrëdhënia e punësimit të stafit akademik bazohet në kontrata individuale pune, ndërsa Zyra e Financës garanton përmbushjen e detyrimeve ekonomike dhe financiare, në përputhje me këto kontrata dhe legjisllacionin në fuqi mbi pagat dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore mujore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit</p>	<p>Marrëdhëniet e punës në TBU bazohen në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, L-AL Nr.80/2015, Statutin, Rregulloren e Punës, si dhe rregulloret tjera bazë. TBU ndjek një politikë të hapur dhe transparente në punësimin</p>

<sup>182</sup> 23. CV e stafit akademik të angazhuar në programet e studimit; 26. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2); 57. Mareveshja e MAS\_TBU\_dt.9.07.2024 Përcaktimi i Personeli Akademik.

<sup>183</sup> 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.2. Politika e BNJ në TBU; 13.3. Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE).

<sup>184</sup> 28. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit MSHIE120 (Aneks Tabela 6,12,7 & 8); 29. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit MSHIE120 (Aneks Tabela 4);

<sup>185</sup> 26. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2); 27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit MSHIE 120 (Aneks Tabela 6,12,7 & 8); 28. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit MSHIE 120 (Aneks Tabela 4); 23. CV e stafit akademik të angazhuar në programeet e studimit.

<p>me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>dhe rekrutimin e stafit akademik.<sup>186</sup> Në Rregulloren e Punësimit përcaktohen parimet themelore, rregullat, kriteret, standardet dhe procedurat për marrëdhëniet e punës në TBU, përfshirë rekrutimin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Institucioni i kushton vëmendje të veçantë përzgjedhjes dhe punësimit të stafit akademik, duke synuar përputhjen e kualifikimeve të tyre me programet e studimit që ofrohen.<sup>187</sup> Për rekrutimin e personelit, TBU ndjek një procedurë transparente, duke publikuar pozicionet vakante në seksionin e njoftimeve në faqen zyrtare të IAL-së dhe rrjetet sociale.<sup>188</sup> Faqja zyrtare e IAL-së është: <a href="http://www.tbu.edu.al">www.tbu.edu.al</a>. Pas aplikimeve, kandidatët vlerësohen dhe rankohet me pikë, duke siguruar transparencë në proces. Vlerësimi dhe përzgjedhja bëhen nga një Komision, duke u bazuar fillimisht në dokumentacionin e dorëzuar dhe më pas në intervista. Kandidati me numrin më të lartë të pikëve vazhdon më tej me intervistën përfundimtare, e cila çon në përzgjedhjen dhe nënshkrimin e kontratës së punës nga Rektori i TBU. Në të njëjtën kohë, publikohet edhe Urdhri i Emërimit. E gjithë kjo procedurë është plotësisht transparente, duke garantuar përzgjedhjen më të përshtatshme për çdo pozicion akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në TBU nuk ka staf ndihmes akademik te punesuar per te mirembajtur labororet apo per te dhene ndihme gjate oreve qe realizohen senacat praktike. Institucioni ka siguruar dhe garantuar angazhimin e personelit akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike të programit të studimit MSH-IE. Stafit Akademik i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit kontribuon në zhvillimin e sesioneve praktike në mjediset laboratorike, të pajisura me teknologji bashkëkohore për programim, testim softuerësh, menaxhim të të dhënave dhe simulime të proceseve softuerike<sup>189</sup>. TBU siguron mjedise moderne të pajisura me aparatura dhe platforma softuerike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Labororët janë të pajisur me kompjuterë, licenca softuerësh profesionalë, dhe ofrojnë akses në platformat online si Office 365, Moodle LMS dhe SharePoint për organizimin dhe dokumentimin e procesit akademik<sup>190</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit,</p>	<p>Në zbatim të L-AL 80/2015, Neni 3, Pika 4, gërma ç, Rregullores së Përgjithshme të TBU, si dhe Rregullores e Punësimit në TBU, Zyra e Burimeve Njerëzore, e TBU-së administron në mënyrë të strukturuar dokumentacionin e punonjësve në aspektin procedural dhe dokumentar. Kjo zyrë është përgjegjëse për:<sup>191</sup></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpalljen e vendeve të lira të punës,</li> </ul>

<sup>186</sup> 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.1. Shembull njoftim për vend vacant për staf akademik në website; 13.2. Politika e BNJ në TBU.

<sup>187</sup> 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit.

<sup>188</sup> 13.1. Shembull njoftim për vend vakant për staf akademik në website.

<sup>189</sup> 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)

<sup>190</sup> 44. Strategjia e Zhvillimit të IT

<sup>191</sup> 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.2. Politika e BNJ në TBU

<p>angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrimin e formularëve të vlerësimit të performancës,</li> <li>• Mbajtjen dhe përditësimin e dosjeve të pedagogëve me kohë të plotë dhe të pjesshme,</li> <li>• Ruajtjen e lidhjeve të ngushta me personelin,</li> <li>• Ndjekjen e të gjitha procedurave për rekrutimin e stafit akademik dhe administrativ.</li> </ul> <p>TBU, nëpërmjet ZBNJ-së, siguron që për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies dhe në këtë program studimi, të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm për stafin me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Zyra e Burimeve Njerëzore në TBU disponon një listë të plotë të stafit akademik dhe administrativ të institucionit, e detajuar sipas njësive kryesore, njësive bazë dhe programeve të studimit.<sup>192</sup> Kjo listë pasqyron ndarjen e stafit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, të organizuar sipas viteve akademike.<sup>193</sup></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>TBU, e ka në praktikën e punës së tij që në kuadrin e marrëveshjeve me subjektet e ndryshme private dhe IAL të tjera, përcakton staf akademik me ekperiencë për të ndjekur nga afër studentët në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike për programin e studimit MSH në Informatikë Ekonomike.<sup>194</sup></p> <p>Në varësi të numrit të studentëve që zhvillojnë praktikën, departamenti përcakton edhe numrin e pedagogëve mbikëqyrës. Personeli akademik i angazhuar në mbikëqyrjet e praktikave është njëkohësisht edhe në përbërje të Komisionit që departamenti ngre për mbrojtjen e praktikës nga studentët.</p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikëqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.<sup>195</sup></p> <p>Siç është shpjeguar edhe në kriteret e mësipërme,, Praktika Profesionale për programin MSH në Informatikë Ekonomike ka një detyrim prej 300 orë për studentin. Nga këto 75 orë seminari realizohen në salla leksionesh me të gjitha mjetet e nevojshme për zhvillimin e praktikës në auditor. TBU garanton se</p>

<sup>192</sup> 26 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2); 27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit MSHIE (Aneks Tabela 6,12,7 & 8).

<sup>193</sup> 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.2. Politika e BNP në TBU; 13.3. Format Dosje staf akademik (administrrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE).

<sup>194</sup> 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MSHIE); 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëve Udhëheqës për Praktikën Mësimore për vitin 24-25 FTI.

<sup>195</sup> 36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse Neni 6 & fq.5-15.

	zotëron kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të praktikës mësimore. <sup>196</sup>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi IV.2**

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimitarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>TBU garanton sigurimin dhe funksionalitetin e infrastrukturës laboratorike dhe shërbimeve mbështetëse për programet e studimit, duke krijuar një mjedis optimal për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve. Institucioni ofron pajisje moderne laboratorike dhe lehtëson kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve, si brenda ambienteve të institucionit ashtu edhe jashtë tij, në përputhje me temat e praktikave profesionale dhe fushën e studimit.<sup>197</sup></p> <p>Në kuadër të këtij angazhimi, TBU siguron staf ndihmës akademik të kualifikuar për mbështetjen e studentëve gjatë orëve laboratorike, duke garantuar një proces mësimor efektiv dhe të sigurt. Gjithashtu, institucioni merr masa të vazhdueshme për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e laboratorëve dhe ambienteve të tjera didaktike, duke i përshtatur ato sipas nevojave specifike të programeve të studimit dhe standardeve akademike.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Auditorët, sallat dhe mjediset e tjera ofrojnë të gjithë komoditetin e nevojshëm për studim, pune shkencore dhe individuale, si për studentet dhe stafin akademik. TBU, ka një infrastrukturë specifike të prekshme dhe shumë funksionale në varësi të përmbajtjes së programeve të studimeve. Në TBU, studentët dhe stafi akademik kanë qasje në një gamë të gjerë të pajisjeve kompjuterike për të mbështetur nevojat e tyre akademike dhe administrative. Koncretisht, në TBU ka dy laboratorë kompjuterikë: i pari është i pajisur me 30 kompjuterë HP të fuqizuar nga procesori Intel Core i5 6100 CPU @3-7 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Ëindoës 10 Pro 64-bit, ndërsa laboratori dytë është i pajisur me 60 kompjuterë Fujitsu të fuqizuar nga procesori Intel Core i3-9100 CPU @3.6 GhZ, 8 GB RAM dhe sistem operativ: Ëindoës 11 Pro 64-bit si dhe 2 projektor të lidhur paralel Epson EB-Ë42. Këto pajisje të përditësuara</p>

<sup>196</sup> 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSHIE (shqip).

<sup>197</sup> 43. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (22-23); 43.1. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024); 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Anëks Tabela 16).

	<p>ofrojnë performancë të lartë dhe stabilitet, duke u mundësuar përdoruesve të kryejnë detyra komplekse dhe të përdorin softuerë të avancuar pa vonesa.<sup>198</sup></p> <p>Gjithashtu, TBU disponon 10 salla të pajisura me nga një kompjuter HP me Intel Core i3 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Windows 10 Pro 64-bit. Secila nga këto salla është gjithashtu e pajisur me një projektor ACER X1226AH DLP, duke lejuar prezantime dhe leksione interaktive me cilësi të lartë vizuale.<sup>199</sup></p> <p>Për pedagogët dhe stafin administrativ, TBU ka në dispozicion 20 njësi kompjuterike HP me Intel Core i3 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM, 64-bit, Windows 10 Pro, dhe 5 njësi me HP EliteDesk të pajisura me Intel Core i7 6700 CPU dhe 16 GB RAM. Këto pajisje të fuqishme sigurojnë që stafi të mund të kryejë detyrat e tyre me efikasitet të lartë dhe me mbështetje teknologjike të avancuar.<sup>200</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>TBU ka dy laboratorë kompjuterikë, i pari është i pajisur me 30 kompjuterë HP të fuqizuar nga procesori Intel Core i5 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Windows 10 Pro 64-bit, ndërsa laboratori dytë është i pajisur me 60 kompjuterë Fujitsu të fuqizuar nga procesori Intel Core i3-9100 CPU @3.6 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ: Windows 11 Pro 64-bit si dhe 2 projektor të lidhur paralel Epson EB-142. Këto pajisje të përditësuara ofrojnë performancë të lartë dhe stabilitet, duke u mundësuar përdoruesve të kryejnë detyra komplekse dhe të përdorin softuerë të avancuar pa vonesa.<sup>201</sup></p> <p>Laboratorët e Informatikës kanë kapacitet të mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të TBU-së për programet që zhvillon. Në këto laboratorë zhvillohen leksione, seminare, praktika pune.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Siç përmendet në Kriterin 1 &amp; 2, më sipër, TBU ofron për studentët 2 laboratorë të Informatikës të cilët janë të lidhur në rrjet dhe në internet non stop. Në to janë instaluar edhe Programe/Softë aplikative. Në këto laboratorë zhvillojnë mësim studentët që ndjekin programet e studimit Bachelor dhe Master në Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Softërike si dhe Inxhinieri Kompjuterike.<sup>202</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave</p>	<p>Nga 300 orë punë, 75 orë të praktikës profesionale studentët e programit të studimit MSH në Informatikë Ekonomike e realizojnë në salla leksionesh me të gjitha mjetet e nevojshme për zhvillimin e praktikës në auditor. TBU zotëron kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të praktikës mësimore.<sup>203</sup> Praktika zhvillohet në institucione dhe kompani të ndryshme, në kuadër të bashkëpunimeve të vendosura nga institucioni me institucione të tjera të larta arsimore, biznese, organizata, qendra zhvillimi etj. TBU ka krijuar një rrjet të</p>

<sup>198</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq.6-8.

<sup>199</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq.6-8.

<sup>200</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq.6-8.

<sup>201</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq.6-8.

<sup>202</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq.6-8.

<sup>203</sup> 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSHIE 120 (shqip).

profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.	gjerë partneritetesh me kompani dhe institucione të ndryshme, duke synuar të lehtësojë integrimin e studentëve në tregun e punës. Bashkëpunimi me kompani prestigjioze si BALFIN Group, bankat kryesore në Shqipëri (Tirana Bank, Raiffeisen Bank, OTP Bank, etj.), si dhe organizata si: Albanian Microfinance Association, i ofron studentëve mundësi të shumta për punësim dhe zhvillim profesional. <sup>204</sup> Njëpërmjet këtyre partneriteteve, studentët e TBU-së kanë akses në zhvillimin e praktikës profesionale në kompani të ndryshme, duke u mundësuar atyre të fitojnë përvojë praktike në sektorët përkatës. <sup>205</sup>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**Standardi IV.3**

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	TBU disponon literaturë fizike dhe digjitale që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve dhe njohurive sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Programi i studimit ka literaturë të mjaftueshme digjitale dhe fizike. Literatura përkatëse e përcaktuar në silabuset e lëndëve të programit mësimor, është literaturë lehtësisht e disponueshme në Bibliotekën e TBU-së, e cila ka mbi 300 tituj në fushën e teknologjisë së informacionit, informatikës dhe financës <sup>206</sup> . Gjithashtu, TBU është impenjuar gjithmonë në pasurimin e bibliotekës me tekstet më të fundit. <sup>207</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Institucioni parashikon fonde për pasurimin e literaturës dhe teksteve në bibliotekë. Drejtuesit e njësive bazë në bashkëpunim me drejtuesit e njësive kryesore dhe pedagogët e lëndëve, bashkëpunojnë për të shtuar literaturën e bibliotekës çdo vit akademik, duke e pasuruar atë me materiale cilësore dhe bashkëkohore në ndihmë të studentëve dhe stafit për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore në kolegji. <sup>208</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke	Për realizimin e programit të studimit funksionon dhe është biblioteka e TBU e cila luan një rol të rëndësishëm në shërbim të procesit mësimor dhe formimit profesional të studentëve, stafit akademik dhe administrativ. Qëllimi i

<sup>204</sup> 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MSHIE); 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

<sup>205</sup> 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (MSHIE).

<sup>206</sup> 47. Rregullore e bibliotekës; 47.1. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit.

<sup>207</sup> 47.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU.

<sup>208</sup> 47. Rregullore e Bibliotekës Neni 6; 47.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU.


<p>garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>përdorimit të saj është ofrimi i shërbimeve dhe informimi nëpërmjet-burimeve të informacionit dhe mjediseve për të mbështetur kërkimin shkencor, të mësuarit dhe mësimdhënien e TBU-së.<sup>209</sup> Të gjitha tekstet mësimore ose leksione të shkruara, të cilat zhvillohen në të gjitha programet e studimit gjenden në Bibliotekën e TBU-së. Në funksion të mbështetjes së programeve mësimore, TBU ju garanton studentëve për disiplinat formuese, tekste, skripte, leksione të shkruara si dhe informacion të konfiguruar në ppt në sitet e çdo pedagogu në LMS.<sup>210</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka gjatë funksionimit të saj është e domosdoshme të ruajë specifikat që kërkohen në përdorimin e literaturës që përbën fondin e saj. Ajo përmban në fondin e saj literaturë nga fusha e së drejtës, ekonomisë dhe shkencave shoqërore e teknike, me qëllim që të plotësojë kërkesat e studentëve për secilin program studimi.<sup>211</sup> Biblioteka është njësi ndihmëse e institucionit dhe ushtron aktivitetin e saj brenda hapësirës së TBU-së. Ajo është në shërbim të procesit mësimor, edukativ, formimit profesional dhe veprimtarisë shkencore të përdoruesve të saj. Biblioteka është në katin I dhe është e shtrirë në një sipërfaqe të mjaftueshme dhe lehtësisht e aksesueshme nga studentët, brenda hapësirës së TBU-së. Biblioteka është e pajisur me fond të caktuar, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme sipas natyrës e specifikës së programeve të studimit. Biblioteka vendos në shërbim të përdoruesve materiale në përshtatje me kërkesat akademike, shkencore për studentët, personelin mësimdhënës akademik dhe administrativ (libra, fjalor, internet). TBU gjithashtu ka të aksesueshme dhe bibliotekën online e cila u vjen në ndihmë studentëve dhe pedagogëve me titujt e shumtë në dispozicion.<sup>212</sup> Salla e bibliotekës në TBU u vjen në ndihmë studentëve jo vetëm për studim, por edhe për fotokopje ose printime të materialeve të ndryshme si: detyra kursi, leksione etj. Biblioteka është pasuruar edhe me revista shkencore në fushën e drejtësisë. Pasurimi i literaturës në përputhje me kurrikulat mësimore është proces i vazhdueshëm, që kryhet nëpërmjet blerjeve të planifikuara, dhurimeve, artikujve shkencore, tezave të diplomave. Biblioteka gjithashtu ka një punonjës të ngarkuar për menaxhimin e saj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët përmes aksesit në burime akademike të njohura. Biblioteka online EBSCO, e cila ka qenë e disponueshme për studentët e TBU deri në dhjetor 2022, ka siguruar qasje në artikuj shkencorë, revista, libra dhe materiale kërkimore nga fusha të ndryshme studimi. Aktualisht, institucioni po punon për të rinovuar këtë shërbim për vitin akademik 2024-2025 dhe po shqyrton mundësinë e abonimit në bazën e të</p>

<sup>209</sup> 48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17); 47.1. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit MSHIE.

<sup>210</sup> 47.1. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit MSHIE; 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS.

<sup>211</sup> 47.1. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit MSHIE.

<sup>212</sup> 47. Rregullore e Bibliotekës 48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17).



	dhënave Scopus Research. Këto iniciativa dëshmojnë angazhimin e institucionit për të mbështetur studentët me literaturë cilësore dhe të përditësuar, duke lehtësuar procesin e tyre akademik dhe kërkimor. <sup>213</sup>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e TBU-së ka një sallë studimi për studentët e cila ka një kapacitet të mjaftueshëm për të pritur studentët. Biblioteka është e pajisur me kompjutera që kanë internet free gjithë kohën, kështu që studentët mund ta shfrytëzojnë gjatë gjithë proceseve në ambjentet e IAL-së. Biblioteka ndodhet në katin e parë të godinës. <sup>214</sup>			
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Shërbimi i bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit, përfshirë programin e studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar, me 3 profile. Ky shërbim ofrohet në pesë ditë të javës. Orari i bibliotekës për ditët e Hënë - E Premte është 9.00-20.00. Gjatë sezonit të provimeve shërbimi i bibliotekës është me orar të zgjatur. Me qëllim organizimin dhe mirëfunksionimin e bibliotekës TBU ka edhe një rregullore për këtë qëllim të miratuar nga Senati Akademik i tij. <sup>215</sup>			
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse e programit raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit sallat e leximit, përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online etj. Institucioni kryen blerje të reja të literaturës moderne, të teksteve që përdor stafi akademik për lëndën përkatëse, por dhe libra të cilët shërbejnë si literaturë studimore plotësuese e rekomanduar, që në të shumtën e rasteve janë autorë të huaj që janë personalitete të fushës. Këto nevoja përpilohen nga vetë pedagogët e lëndës dhe TBU bën blerjen e tyre. <sup>216</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<sup>213</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq.12-13.

<sup>214</sup> 43.1 Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024); 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.

<sup>215</sup> 47. Rregullore e Bibliotekës.

<sup>216</sup> 47. Rregullore e Bibliotekës 48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17); 47.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU.

Standardi IV.4	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>TBU ka të ngritur një sistem të konsoliduar të menaxhimit të institucionit, për të administruar informacionin që lidhet me studentin, nga dita e kontaktit me TBU, marrje informacionit, ditën e regjistrimit, sekretarinë mësimore, fillimin e procesit mësimor, struktura organizative e TBU dhe stafi akademik, informacion mbi programin, zhvillimin dhe vlerësimin e ecurisë nga pedagogu i lëndës, deri te provimet përmbyllëse e diplomimin, komisionin e vlerësimit dhe autoriteti i përfaqësimit të diplomës. Për çdo hallkë të këtij zinxhiri ka struktur organizative përkatëse që veprimtarinë e vet e ka të ligjëruar me aktet administrative, rregullore, urdhëra e udhëzime të institucionit.<sup>217</sup></p> <p>Sistemi Pitagora, i zhvilluar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH), ofron një zgjidhje të avancuar për menaxhimin e të dhënave akademike dhe administrative në TBU. Ai mundëson regjistrimin dhe administrimin e rezultateve të studentëve, përfshirë notat, mesazhet dhe transkriptet akademike, duke automatizuar proceset e sekretarisë mësimore si regjistrimi i studentëve, planifikimi i provimeve dhe lëshimi i diplomave. Në aspektin financiar, Pitagora ndihmon në monitorimin e pagesave të studentëve, faturimin dhe krijimin e raporteve financiare, duke lehtësuar menaxhimin e detyrimeve akademike. Gjithashtu, sistemi mbështet administrimin e burimeve njerëzore, duke përfshirë regjistrimin e stafit akademik, m dhe prodhimin e dokumenteve të punës.<sup>218</sup> Përmes automatizimit të proceseve, transparencës dhe raportimit të avancuar, TBU do të përmirësojë ndjeshëm efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve dhe stafit akademik. Me Pitagora, TBU do të ketë një sistem të centralizuar, të sigurtë dhe të lehtë për menaxhim, duke modernizuar administrimin akademik dhe financiar në përputhje me standardet më të larta.<sup>219</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të</p>	<p>SharePoint është një platformë për menaxhimin e dokumenteve dhe bashkëpunimin që lehtëson ndarjen e informacionit brenda organizatës. Kjo platformë mundëson krijimin e faqeve të brendshme të internetit (intranets), bibliotekave të dokumenteve dhe portaleve të projektit që ndihmojnë në menaxhimin e informacionit dhe proceset e punës. SharePoint është i integruar me Office 365, duke lehtësuar krijimin dhe ndarjen e dokumenteve nga aplikacionet e njohura të Microsoft-it. Personeli akademik dhe administrative nëpërmjet SharePoint mund të aksesojë në kohë reale të dhëna lidhur me</p>

<sup>217</sup> 48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17); 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS; 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS; 44.4. Trajnime mbi sistemin LMS; 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU; 44.1.1. Udhëzues për përdorimin e strukturës së TI deri në Dhjetor 23.

<sup>218</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 13.

<sup>219</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 13.

<p>angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>strategjitë, rregulloret, urdhërat administrativ, standartet si dhe çdo informacion apo dokumentacion tjetër lidhur me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në realizimin e programit.<sup>220</sup></p> <p>Përsa i përket aktivitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik në sistemin TBU LMS, aty integrohen të dhëna në lidhje me veprimtarinë mësimore si materialet e leksioneve dhe seminareve, detyrat e kursit/esetë, tezat e provimit, rezultatet e vlerësimit etj. Gjithashtu, mbahet komunikim me studentët përmes e-mail, forum/chat etj.<sup>221</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit ofron akses të dedikuar dhe informacion lidhur me çdo hap të procesit mësimor. Studentët dhe personeli akademik mund të ruajnë, ndajnë dhe bashkëpunojnë në dokumente në mënyrë të sigurtë. SharePoint ofron një qendër të centralizuar ku mund të aksesohen të gjitha dokumentet e rëndësishme, duke përfshirë manualët, politikët, procedurat dhe materialet mësimore. Ndërsa administrata mund të menaxhojnë dokumentet dhe proceset administrative më lehtë dhe më efektivisht. SharePoint mundëson automatizimin e shumë proceseve administrative, duke përfshirë aprovimet dhe rrjedhat e punës.<sup>222</sup> Gjithashtu, studentët kanë akses mbi informacionin e programit të studimit për lëndët përkatëse në të cilat regjistrohen në platformën TBU LMS.<sup>223</sup></p> <p>Të gjithë pedagogët dhe stafi administrativ i TBU zotëron dhe menaxhon një adresë e-mail, të unifikuar nën domainin e TBU-së. Kjo postë elektronike, ndër të tjera, shërben si një mjet i brendshëm efektiv komunikimi. Përmes automatizimit të proceseve, transparencës dhe raportimit të avancuar, TBU do të përmirësojë ndjeshëm efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve dhe stafit akademik. Me Pitagora, universiteti do të ketë një sistem të centralizuar, të sigurt dhe të lehtë për menaxhim, duke modernizuar administrimin akademik dhe financiar në përputhje me standardet më të larta.<sup>224</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët mund të komunikojnë virtualisht nëpërmjet platformës së posaçme TBU LMS, por gjithashtu edhe nëpërmjet emailit. Në secilin rast, studentëve u vihet në dispozicion çdo lloj materiali lidhur me lëndët e programit të studimit dhe çdo informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve akademike.<sup>225</sup></p> <p>Për njohjen dhe aftësimin në përdorimin e platformës TBU LMS, vijnë në ndihmë guidat përkatëse të hartuara nga Zyra e IT-së: guidë për pedagogun dhe guidë për studentët si dhe trajnimet e realizuara.<sup>226</sup></p>

<sup>220</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 4-5.

<sup>221</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 4-5.

<sup>222</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 4-5.

<sup>223</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 2-3; 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS; 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS; 44.4. Trajnimet mbi sistemin LMS.

<sup>224</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 13.

<sup>225</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 2-3.

<sup>226</sup> 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS; 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS; 44.4. Trajnimet mbi sistemin LMS.

	-Pra, e gjithë kjo platformë shërben si një mjet komunikimi i brendshëm efikas mes pedagogëve. <sup>227</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në kuadër të analizës së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimit ndaj studentëve në TBU, analizohet aktivizimi i çdo pedagogu në platformën interaktive TBU LMS, për lëndët dhe grupet e veta. Me Pitagora, TBUdo të ketë një sistem të centralizuar, të sigurt dhe të lehtë për menaxhim, duke modernizuar administrimin akademik dhe financiar në përputhje me standardet më të larta. <sup>228</sup>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja zyrtare e TBU: <a href="http://tbu.edu.al">http://tbu.edu.al</a> është dy gjuhëshe, në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Në të mund të gjenden informacione për kolegjin, programet e studimit, kurrikulën e studimit për çdo program, personelin akademik dhe joakademik, aktivitete dhe njoftime të ndryshme. Gjithashtu, dokumentet kryesore dhe materiale të rëndësishme gjenden në ëeb në gjuhën angleze si: Statuti, Rregullore e Përgjithshme e TBU, Raporti Vjetor të Institucionit, e shumë materiale të tjera për ngjarje dhe evente të ndryshme të Institucionit. Informacioni i përgjithshëm bazik i TBU përcillet nëpërmjet të gjitha kanaleve të informimit dhe social media si: Web, Instagram, LinkedIn.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	TBU, mbështetur në L-AL Nr. 80/2015 Neni 2, 3, 49 dhe Kreu XI, në Kodin dhe Standardet e Cilësisë në Arsimin e Lartë në RSH, në Statutin e TBU-së dhe Rregullores së tij në vijimësi merr të gjitha masat për të siguruar financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për procesin mësimor-kërkimor për institucionin dhe realizimin e programeve të studimit të tij. TBU, në mbështetje të Ligjit Nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Standardeve Kontabël Kombëtare, përgatit çdo vit Pasqyrat Financiare (PF) Vjetore. <sup>229</sup> Këto Pasqyra Financiare sigurojnë informacione të rëndësishme dhe të hollësishme për aktivet dhe detyrimet (Pasqyra e Bilancit) e TBU-së, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyra e Ndryshimeve të Kapitalit, Pasqyra Cash Floë e tjera. Në këto pasqyra dhe informacionet shoqëruese të tyre

<sup>227</sup> 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS.

<sup>228</sup> 44.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 13.

<sup>229</sup> 50.3. Pasqyrat Financiare 2021\_2022\_2023

	<p>identifikohen të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe nga burime të tjera, si ato nga studimet dhe projektet, nga trajnime të ndryshme, nga shërbimet, të ardhura nga shërbimet administrative, si dhe nga burime të tjera. Ndërkohë, jepen të plota dhe të detajuara informacionet për drejtimet se ku janë kryer shpenzimet, duke siguruar kostot sipas zërave kryesore të shpenzimeve dhe kryesisht: Kosto e Punës, Kosto e Qirave, Kosto për Kërkimin Shkencor, Kosto e reklamës dhe publicitetit, për mirëmbajtje e riparime, kancelari, amortizimet e tjera.<sup>230</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë</p>	<p>TBU për çdo vit harton Planin Buxhetor Vjetor dhe afatmesëm (3-vjeçar). Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në nivel institucioni dhe sipas njësive kryesore dhe bazë, bëhet mbështetur në kërkesat e LAL nr. 80/2015, Kreu XI. Shpenzimet në buxhet, strukturohen sipas kërkesave dhe parashikimeve të LAL, duke i detajuar përveç në nivel institucioni edhe sipas njësive kryesore dhe njësive bazë të tyre. Shpenzimet e buxhetit të TBU parashikohen të ndara, për një proces mësimor cilësor, për trajtimin ekonomik të stafit, duke mos harruar këtu edhe zbatimin e politikës së institucionit, i cili bën çdo vit përmirësimet e nevojshme të nivelit të pagave për punonjësit e stafit që përmirësojnë nivelin e kualifikimit shkencor, që kanë shënuar arritje në performancën e tyre, ose për shkak të vjetërsisë në punë në TBU për zgjidhjen e nevojave për kryerjen e praktikave mësimore e profesionale të studentëve.<sup>231</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Në TBU, është ngritur dhe funksionon një Sistem Kontrolli i Brendshëm, mbështetur në një sistem dokumentacioni sipas kërkesave të L-AL 80/2015, akteve në zbatim të tij, të Ligjit "Për Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar" dhe standardeve kontabël të zbatueshme në zbatim të tij. TBU me persona të specializuar kryen herë pas here Auditime të brendshme, për sektorë dhe problematika me risk.<sup>232</sup> Raportet e auditimit për pjesën e pasqyrave financiare për vitet fiskale 2021, 2022 janë kryer nga auditi i pavarur Kreston Albania, ndërsa për vitin 2022 janë kryer nga auditi i pavarur Nexia Albania.<sup>233</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>TBU, për çdo vit akademik në një mbledhje të hapur, të përbashkët, Senati Akademik (SA) dhe Bordi Administrimit, prezanton dhe analizon një përmbledhje me informacionet e Pasqyrave Financiare Vjetore të saj, shoqëruar me raportin e lëshuar nga audituesi i pavarur. Në takim marrin pjesë përfaqësues nga stafi akademik, administrativ dhe studentët. SA, pasi njihet dhe i analizon treguesit dhe rezultatet financiare të paraqitura për vitin buxhetor e fiskal, i miraton me vendim të posaçëm. Përmbledhja e informacioneve të Pasqyrave Financiare Vjetore, shoqëruar me raportin e lëshuar nga Audituesi i pavarur dhe me Vendimin e SA, diskutohen dhe miratohen me Vendim të BA dhe të</p>

<sup>230</sup> 50.1. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1); 50.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2); 50.3. Pasqyrat Financiare 2021\_2022\_2023; 50.4. Raport auditimi 2021\_2022\_2023

<sup>231</sup> 50.5. Procedura e miratimit të buxhetit 2022 dhe planit buxhetor 24-27.

<sup>232</sup> 50.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2); 50.4. Raport auditimi 2021\_2022\_2023;

50.3. Pasqyrat Financiare 2021\_2022\_2023

<sup>233</sup> 50.4. Raport auditimi 2021\_2022\_2023

	<p>ortakeve. Pas këtij momenti Pasqyrat Financiare pasi miratohen edhe nga BA dhe ortakët e shoqërisë, dërgohen në Zyrat e Tatimeve dhe Qendrën Kombëtare të Bizneseve (QKB), dhe publikohen. Në Relacionin e PF dhe në Raportin e auditimit financiar, jepen informacione të dedikuara lidhur me politikën dhe masën e tarifave që arkëtohen nga studentët, mënyra dhe drejtimet e përdorimit të tyre, duke i dhënë mundësinë për të gjykuar se burimet financiare përdoren në mbështetje dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve të tjera për studentët dhe trajtimin e stafit akademik. Mbeshtetur në informacionet e 2 viteve të fundit të PF, Zyra e Financës dhe Administratori përgatit si pjesë e Relacionit të realizimit të treguesve financiarë të vitit edhe një Tabelë të posaçme me të dhënat e detajuara lidhur me të gjithë elementet e shpenzimeve të 2 viteve të fundit dhe planin për vitin në vijim.<sup>234</sup></p> <p>Nëpërmjet këtyre informacioneve bëhet e mundur dhe vlerësimi i realizimit të programit të studimit, efektiviteti i tij dhe përcaktohen ndërhyrjet e nevojshme për sigurimin e vijimësisë së zhvillimit të programit në të ardhmen dhe garantimin e mbarëvajtjes financiare të tij.<sup>235</sup></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>TBU disponon burime financiare sistematike dhe të qëndrueshme që sigurohen nga tarifat dhe pagesat e studentëve. Ndërkohë, investitori grupi Balfin ka financuar sa herë lind nevoja për situatat e krijuara për diferencat midis të ardhurave e shpenzimeve, apo nevojave për të kryer investime, që sigurojnë standardet e nevojshme për realizimin e procesit mesimor në kushte sa më normale. Burime të dyta modeste janë ato që realizohen nga Projektet që në mënyrë modeste realizon TBU me stafin e tij gjatë veprimtarisë së tij. Në përfundim, duhet nënvizuar se TBU, në vijimësi, ka siguruar një qëndrueshmëri financiare konstante, për sigurinë e realizimit të veprimtarisë akademike.<sup>236</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<sup>234</sup> 50.4.Raport auditimi 2021\_2022\_2023 ; 50.3.Pasqyrat Financiare-2021\_2022\_2023; 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MSHIE.

<sup>235</sup> 50.3.Pasqyrat Financiare 2021\_2022\_2023

<sup>236</sup> 50.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB MSHIE).

**V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE**

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Tirana Business University (TBU) ka ndërtuar dhe zbaton një kuadër të plotë politikash dhe procedurash që mbështesin ciklin e plotë akademik të studentëve të programit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”, duke filluar nga pranimi i tyre në universitet deri në momentin e diplomimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 dhe me aktet rregullative të brendshme të institucionit. Statusi i studentit përcaktohet që në fazën fillestare të regjistrimit dhe rregullohet nëpërmjet kontratave të studimit dhe dokumenteve përkatëse institucionale, të cilat përfshijnë të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” është konceptuar mbi një bazë të qëndrueshme ligjore dhe institucionale, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, VKM nr. 41/2018 që përcakton përbërësit e programeve të studimit, si dhe dokumentet themelore të TBU-së si Statuti, Strategjia e Zhvillimit, Rregullorja e Përgjithshme e Kolegjit dhe Rregulloren e programit të studimit MSh “Informatikë Ekonomike”<sup>237</sup>.</p> <p>Rregullorja përkatëse e programit detajon organizimin e brendshëm të tij, garanton zbatimin e legjislacionit në fuqi, mbështet të drejtën për liri akademike dhe përcakton qartësisht përgjegjësitë dhe të drejtat e personelit dhe të studentëve. Ky program i ciklit të dytë është me kohë të plotë dhe përmban 120-kredite-ECTS, të cilat realizohen përgjatë një periudhe dyvjeçare akademike. Ai përfshin të gjithë përbërësit e përcaktuar në kuadrin ligjor: qëllimet akademike, kriteret e pranimit, planin e detajuar mësimor, metodat e vlerësimit, si dhe kushtet për vijimin dhe përmbylljen e studimeve. Të gjitha këto elemente janë të dokumentuara në rregullore specifike të programit, në përputhje me strukturën akademike të institucionit dhe Kodin e Cilësisë për Arsimin e Lartë.<sup>238</sup></p> <p>Pas përmbushjes me sukses të detyrimeve akademike, studentëve u akordohet diploma përkatëse e shoqëruar me suplementin që dokumenton rrugëtimin e tyre akademik. Procesi i pranimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit të studentëve në TBU zbatohet në përputhje me udhëzimet ligjore dhe me politikat institucionale. Gjithashtu, institucioni u krijon mundësi studentëve për të ndryshuar profilin e studimeve dhe për të përfituar nga skemat e bursave, duke u ofruar mbështetje përgjatë gjithë ciklit të tyre akademik.<sup>239</sup></p> <p>Të drejtat dhe detyrimet e studentëve janë të formuluara qartësisht dhe përfshijnë, ndër të tjera, angazhimin në jetën institucionale, dhënien e mendimit mbi cilësinë e mësimdhënies, si dhe zbatimin e rregullave të brendshme të universitetit. Këto elemente kontribuojnë në sigurimin e një përvoje të mirëstrukturuar akademike dhe ligjërish të garantuar që nga momenti i pranimit deri në përfundimin e suksesshëm të studimeve.<sup>240</sup></p>

<sup>237</sup> 6T.Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”2. Statuti i TBU; 3.1. Strategjia e Zhvillimit të TBU 24-29; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip).

<sup>238</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip).

<sup>239</sup> 31. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. e TBU).

<sup>240</sup> Rregullore e Fakultetit të Teknologjise se Informacionit.

**Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.

Tirana Business University (TBU) zbaton politika të mirëpërcaktuara dhe të barabarta në procesin e pranimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për programet e studimit, duke u mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet institucionale. Ky proces garanton transparencë në renditjen e kandidatëve dhe trajtim të barabartë për të gjithë aplikantët, pa dallim.

Studentëve u ofrohet mundësia për të zgjedhur apo ndryshuar profilin e studimeve gjatë ciklit akademik dhe njëkohësisht përfitojnë mbështetje përmes bursave apo lehtësimeve financiare të bazuara në merita akademike ose kritere sociale. Statusi i studentit trajtohet në mënyrë të unifikuar dhe të qartë, duke garantuar të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjatë gjithë periudhës së studimeve.<sup>241</sup>

Procedurat që lidhen me çregjistrimin, ndjekjen e frekuentimit, administrimin e provimeve, komunikimin zyrtar dhe dokumentimin e vlerësimeve janë të mirëpërcaktuara dhe zbatohen në mënyrë të standardizuar për të gjithë studentët. Këto procedura sigurojnë një trajtim të drejtë, të dokumentuar dhe në përputhje me të gjitha rregulloret institucionale, duke mbrojtur të drejtat akademike të çdo studenti në çdo fazë të ciklit të studimeve.

Sekretaria Mësimore luan një rol kyç në menaxhimin akademik të studentëve, duke vepruar mbi parime të qarta transparence, përgjegjshmërie dhe bashkëpunimi të ngushtë me strukturat e tjera të institucionit. Ajo siguron një mbështetje të njëtrajtshme dhe të vazhdueshme për të gjithë studentët që nga regjistrimi deri në përfundimin e programit.<sup>242</sup>

Në TBU janë të përcaktuara dhe zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme rregullat e sjelljes dhe detyrimet e studentëve, të cilat vlejnë për të gjithë gjatë gjithë periudhës së studimeve. Respektimi i normave të ndershëmërisë akademike, sjelljes qytetare dhe etikës institucionale mbikëqyret përmes një sistemi disiplinor të ndërtuar mbi transparencën dhe drejtësinë, ku çdo shkelje trajtohet në përputhje me vendimet e Këshillit të Etikës. Çdo student ka të drejtën të raportojë shkelje të mundshme dhe të përfshihet në mënyrë të barabartë në proceset disiplinore dhe administrative, të cilat zhvillohen mbi bazën e dispozitave të miratuara nga organet drejtuese të universitetit.<sup>243</sup>

Zyra e Çështjeve Studentore së bashku me Këshilltarët Akademikë në TBU ofrojnë shërbime të strukturuar dhe të aksesueshme për të gjithë studentët, duke filluar nga orientimi në fazën hyrëse të studimeve e deri te mbështetja për integrimin në tregun e punës pas diplomimit. Përmes këshillimit individual, mundësive për praktika profesionale, trajnimeve dhe bashkëpunimit me aktorë të tregut, kjo zyrë garanton një mbështetje të vazhdueshme dhe të barabartë për çdo student përgjatë gjithë rrugëtimit të tij akademik dhe profesional<sup>244</sup>.

**Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni

Tirana Business University (TBU) përcakton dhe publikon çdo vit akademik kriteret e pranimit për të gjitha programet e studimit, të ndara në kritere të përgjithshme të bazuara në legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë dhe kritere specifike të miratuara nga Senati Akademik për secilin program. Këto kritere sigurojnë renditje transparente të kandidatëve dhe trajtim të barabartë, ndërsa regjistrimi dhe fitimi i statusit të studentit kryhen brenda afateve ligjore. Studentëve u garantohej gjithashtu mundësia për të zgjedhur ose ndryshuar profilin e studimeve dhe për të përfituar bursa apo reduktime tarifash të bazuara në merita

<sup>241</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU".

<sup>242</sup> 8. Rregullore për sekretarinë mesimore.

<sup>243</sup> 18. Kodi i Etikës.

<sup>244</sup> 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 14.7. Rregullore e Këshillimit Akademik.

<p>bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>akademike ose kritere sociale, çka siguron barazi dhe akses të njëjtë për të gjithë aplikantët<sup>245</sup>.</p> <p>Për programin Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”, kriteret specifike të pranimit përfshijnë pasjen e një diplome të fituar Bachelor në Shqipëri ose në vende të tjera të njohur nga MASR, pagesën e tarifës së regjistrimit të vendosur çdo vit nga Senati Akademik, si dhe kritere shtesë të miratuara çdo vit nga Rektori me propozim të njësisë përgjegjëse. Këto kritere bëhen publike përpara hapjes së aplikimeve dhe vlejnjë për të gjithë kandidatët, përfshirë ata që kërkojnë program të dytë ose transferim, ndërsa afatet maksimale të përfundimit të studimeve mbeten të përcaktuara qartë, duke garantuar transparencë në çdo hap të procesit të pranimit.<sup>246</sup></p> <p>Për të rritur ndërgjegjësimin dhe orientimin e kandidatëve, TBU merr pjesë çdo vit në panairë arsimore, ditë informimi dhe aktivitete të tjera promovuese, ku prezanton ofertën akademike, kuotat dhe kriteret e pranimit, mundësitë e bursave dhe informacion të detajuar për secilin program studimi. Këto platforma shërbejnë si mjete transparente për publikimin e kriterëve të veçanta të pranimit dhe demonstronjë angazhimin e universitetit për të ofruar informacion të plotë dhe të saktë për të gjithë kandidatët, duke theksuar standardet e barazisë dhe transparencës në procesin e pranimit.<sup>247</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat që rregullojnë pranimin, përzgjedhjen, regjistrimin dhe ndryshimin e profilit në TBU janë formuluar qartë, mbështeten në legjislacionin kombëtar dhe në rregulloret e brendshme të universitetit, dhe publikohen në kohë për çdo vit akademik. Aplikimet dorëzohen brenda afateve të shpallura, ndërsa përzgjedhja kryhet mbi bazën e renditjes së kandidatëve që plotësojnë kushtet përkatëse, duke respektuar kuotat maksimale të miratuara për secilin program. Statusi i studentit fitohet me përfundimin e procesit të regjistrimit dhe humbet në rast diplomimi, transferimi, çregjistrimi ose përjashtimi. Të gjitha hapat janë të dokumentuara dhe të aksesueshme publikisht, duke garantuar transparencë dhe barazi për të gjithë aplikantët. Në lidhje me pranimin, transferimin dhe njohjen e studimeve të mëparshme, TBU zbaton një rregullore të detajuar që bazohet në Ligjin nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore shoqëruese, duke siguruar përputhje të plotë me parimet e Kartës së Bolonjës. Rregullorja parashikon hapat për aplikim, dokumentacionin e nevojshëm, dhe procedurën e vlerësimit nga Komisioni për Transferimet dhe Njohjen e Krediteve, i cili vendos mbi ekuivalentimin e lëndëve, krediteve dhe notave. Ky proces është i strukturuar, objektiv dhe i kufizuar në afate të qarta kohore; gjithë informacioni i nevojshëm u vihet në dispozicion studentëve përmes Zyrës së Pranimeve dhe Zyrës së Regjistrimit. Në këtë mënyrë, kriteret dhe procedurat për përparimin akademik, vlerësimin dhe diplomimin mbeten të hapura, të kuptueshme dhe të monitorueshme nga çdo palë e interesuar.<sup>248</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me</p>	<p>Në respektim të Statutit dhe Rregullores së institucionit, Tirana Business University (TBU) siguron informimin e pandërprerë dhe transparent të publikut dhe kandidatëve potencialë përmes një gamë të gjerë kanalesh komunikimi: faqes zyrtare të internetit, rrjeteve sociale, portaleve informative, televizioneve dhe radiove kombëtare, materialeve publicitare outdoor, si edhe pjesëmarrjes aktive në panairë arsimore dhe aktivitete orientimi në</p>

<sup>245</sup> 31. Procedura e Pranimit te Studenteve ne TBU (Shkëputur nga Rregullore e TBU).

<sup>246</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSH “Informatike Ekonomike” (shqip), Neni 12 “Kriteret dhe Procedura e Pranimit të Studentëve”, 60.2. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025.

<sup>247</sup> 49. Politika e Marketingut të TBU për Programet e Studimit.

<sup>248</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar “TBU”; 9. Rregullore e programit të studimit MSH “Informatike Ekonomike” (shqip); 31. Procedura e Pranimit te Studenteve ne TBU (Shkëputur nga Rreg. e TBU); 32. Rregullore per Transferimin e studimeve.

<p>kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>karrierë. Kjo qasje multimediale-garanton që të gjitha të dhënat mbi programet e studimit, tarifat dhe kriteret e pranimit të jenë lehtësisht të aksesueshme përpara fillimit të çdo viti akademik.<sup>249</sup></p> <p>Transparenca për kriteret e pranimit mbështetet veçanërisht mbi dokumentin “Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU”, i cili publikon qartësisht kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të parashikuara nga Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”. Në këtë mënyrë, çdo kandidat informohet në kohë për të gjitha kërkesat ligjore, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim dhe regjistrim në programet e studimit të TBU-së.<sup>250</sup></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Tirana Business University (TBU) zbaton një politikë të qartë gjithëpërfshirëse, duke u siguruar që kandidatët me aftësi të veçanta, pjesëtarët e pakicave dhe grupet e tjera të marginalizuara të kenë akses të barabartë në arsimin e lartë. Për këtë qëllim, çdo vit hartohen dhe publikohen në faqen zyrtare së bashku me dokumentet rregullatore institucionale kriteret të veçanta pranimit dhe kuota të dedikuara, të cilat i dërgohen zyrtarisht Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) në përputhje me rregulloret në fuqi. Përtej procedurave të pranimit, TBU ofron mbështetje akademike dhe sociale të personalizuar, duke vënë në dispozicion shërbime këshillimi, ndihmë pedagogjike dhe përshtatje infrastrukturore, me synim krijimin e kushteve optimale për përfshirjen dhe suksesin e këtyre studentëve. I gjithë procesi zhvillohet në përputhje të plotë me kornizën ligjore për arsimin e lartë, duke reflektuar angazhimin e institucionit për barazi, diversitet dhe integrim të plotë në jetën akademike.<sup>251</sup></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Tirana Business University (TBU) siguron trajtim të barabartë për aplikantët ndërkombëtarë, duke u ofruar mundësi regjistrimi në të dy ciklet e studimeve në përputhje me kriteret e përgjithshme ligjore dhe me kushtet specifike të miratuara nga organet drejtuese të institucionit. Këto kërkesa shpallen çdo vit akademik dhe zbatohen njësoj për studentët vendas dhe të huaj, përfshirë procedurat e transferimit të studimeve dhe njohjes së krediteve, në respekt të legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të TBU-së.<sup>252</sup></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>TBU zbaton politika të qarta financimi për studentët nga shtresat në nevojë, duke ofruar bursa dhe lehtësime në pagesën e tarifës së shkollimit që garantojnë akses të barabartë në arsim dhe mbështesin pranimin në programe strategjike për universitetin dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Skemat e bursave dhe ndihmës financiare përditësohen çdo vit, publikohen në faqen zyrtare të institucionit<sup>253</sup> dhe jepen mbi kriteret akademike e sociale, në përputhje me rregulloret e brendshme dhe udhëzimet e MASR. Përveç fondeve të veta, TBU bashkëpunon me partnerë publikë e privatë për të siguruar burime shtesë për studentët e shkëlqyer dhe ata në kushte socio-ekonomike të vështira.<sup>254</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<sup>249</sup> 49. Politika e Marketingut të TBU për Programet e Studimit; website <https://tbu.edu.al>

<sup>250</sup> 31. Procedura e Pranimit te Studenteve ne TBU (Shkëputur nga Rregulloret e TBU).

<sup>251</sup> 60.6. Skema e bursave sociale në TBU; 60.1. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 23-24 ; 60.2. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025.

<sup>252</sup> 6. Rregulloret e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; 69.1. Procedura për rialokimin e kuotave të pranimit 24-25; 69. Tabela e kuotave sipas trojeve, transferime 2024-2025.

<sup>253</sup> <https://tbu.edu.al/kriteret-e-pranimit/#bursat>

<sup>254</sup> 60.1. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 23-24; 60.2. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025; 60.4. Kontratë dhurimi Mane Foundation, dt. 9.11.23; 60.5. Kontratë dhurimi Mane Foundation TBU studenti Klejvi Pero 24-25; 60.6. Skema e bursave sociale në TBU.

				X
--	--	--	--	---

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Tirana Business University (TBU) siguron transparencë të plotë për progresin akademik të studentëve dhe kalimin në vitet pasuese. Struktura e vitit akademik, ngarkesa mësimore, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi, si edhe kushtet e kalueshmërisë përshkruhen në rregulloret institucionale dhe në syllabus-et e lëndëve. Vlerësimi kryhet me kontroll të vazhdueshëm dhe kombinon provime, detyra kursi, pjesëmarrje aktive dhe projekte, ndërsa riprovimet dhe përsëritja e vitit rregullohen me procedura të qarta dhe lehtësisht të aksesueshme. Studentët marrin njoftime të rregullta përmes sekretarisë mësimore dhe platformës së menaxhimit të mësimi (LMS), e cila u mundëson akses të pandërprerë në të dhënat e performancës së tyre, duke garantuar standarde të larta transparence dhe mbështetje akademike përgjatë gjithë programit të studimeve. <sup>255</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Për transferimet dhe njohjen e kualifikimeve të mëparshme, TBU zbaton një rregullore të veçantë në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, udhëzimet e MAS-it dhe parimet e Kartës së Bolonjës. Ajo përshkruan, hap pas hapi, procesin e aplikimit për studentët që vijnë nga institucione të tjera brenda ose jashtë vendit si dhe procedurën e njohjes së krediteve të mëparshme. Dokumentacioni i nevojshëm, afatet e shqyrtimit dhe roli i Komisionit të Transferimeve dhe Njohjes së Krediteve janë të përcaktuara qartë: ky komision vendos për ekuivalentimin e lëndëve, sasinë e krediteve të njohura dhe vitin e regjistrimit të studentit. Gjatë gjithë procesit, Zyrat e Pranimeve dhe të Çështjeve Studentore informojnë studentët në çdo hap, duke garantuar trajtim të barabartë, transparencë dhe respektim të standardeve akademike. Për më tepër, studentët njoftohen rreth detyrimeve akademike të mbetura dhe procedurave financiare përkatëse, duke siguruar integrimin e tyre të plotë në programin e zgjedhur në TBU. <sup>256</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimi të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në TBU, vlerësimi i studentëve zhvillohet sipas rregullave të mirëpërcaktuara që u prezantohen në fillim të çdo lënde përmes syllabus-it dhe sesioneve orientuese të organizuara nga pedagogët. Metodat e vlerësimi përfshijnë provime të shkruara, detyra kursi, projekte dhe forma të kombinuara, të përcaktuara hollësisht në programin e lëndës. Të gjitha rezultatet regjistrohen zyrtarisht në fletët e provimit dhe procesverbalet përkatëse, ndërsa studentët mund t'i konsultojnë notat në sistemin elektronik dhe të kërkojnë rishqyrtim kur nuk pajtohen me vlerësimin. Afatet, procedurat dhe mënyra e publikimit të

<sup>255</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; 9. Rregullore e programit të studimit MSH « Informatikë Ekonomike » (shqip); 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS; 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS; 55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies; 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore.

<sup>256</sup> 9. Rregullore e programit të studimit MSH "Informatikë Ekonomike" (shqip); 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 31. Procedura e Pranimi të Studenteve në TBU (Shkeputur nga Rregullore e TBU); 32. Rregullore për Transferimin e studimeve.

	rezultateve sigurojnë transparencë të plotë dhe trajtim të barabartë për çdo student gjatë gjithë procesit të vlerësimit. <sup>257</sup>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Tirana Business University (TBU) u ofron studentëve udhëzime të qarta për gjithë procesin e hartimit të diplomës dhe procedurat e diplomimit. Në fund të ciklit të studimeve, kandidatët mund të diplomohen nëpërmjet hartimit dhe mbrojtjes së tezës. Tema e punimit dhe udhëheqësi miratohen në fazën finale të studimeve, sipas udhëzimeve zyrtare. Mbrojtjet zhvillohen në sesione të caktuara nga Rektori; pas suksesit, lëshohet diploma e shoqëruar me suplementin evropian, në përputhje me standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Përfundimisht, studentët marrin pjesë në një ceremoni zyrtare diplomimi. <sup>258</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Tirana Business University (TBU) zbaton një strategji të plotë informimi dhe promovimi, e cila siguron që çdo i interesuar të marrë në kohë të gjitha të dhënat mbi programet e studimit. Para çdo viti akademik, universiteti organizon konkurse kombëtare për gjimnazistët, trajnime tematike dhe merr pjesë në panairë apo ditë informuese në qytete të ndryshme të vendit. Përveç aktiviteteve në terren, TBU promovon ofertën e vet akademike përmes kanaleve digjitale dhe tradicionale—rrjete sociale, portale online, televizione, radio dhe reklama urbane—duke përfshirë edhe studentët aktualë si ambasadorë të suksesit të institucionit. Kjo qasje shumëkanalëshe garanton informim të vazhdueshëm, të strukturuar dhe gjithëpërfshirës për të gjithë kandidatët e mundshëm. <sup>259</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët e programit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” në TBU marrin qysh në fillim informacion të plotë dhe të qartë mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve përmes rregullores së programit, planit mësimor dhe kurrikulës së publikuar. Programi është i shtrirë në dy vite akademike dhe mbart 120 kredite ECTS, të ndara sipas kategorive të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion përfshin gjithashtu kriteret e pranimit, afatet e regjistrimit, procedurat për zgjedhjen e profilit dhe rregullat që lidhen me statusin e studentit, përjashtimet apo njohjen e krediteve. TBU siguron transparencë të plotë duke shpallur publikisht çdo

<sup>257</sup> 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; 9. Rregullore e programit të studimit MSh Informatikë Ekonomike” (shqip).

<sup>258</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar “TBU”; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; 11. Udhezim për përgatitjen e temës së diplomës; 12.2. Kalendar i Akademik 2024-2025; 17.1. Forma e re e propozuar e diplomës dhe suplementit për programin e studimit MSh “Informatikë Ekonomike”; 17.1.1. TBU - FTI - MSH Informatikë Ekonomike - Suplementi i propozuar i diplomës.

<sup>259</sup> 14.2. Ftesë për panair; 14.3. Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Master FTI; 14.5. Ditët informuese në TBU; 49. Politika e Marketingut të TBU për Programet e Studimit.

	kriter pranimi, transferimi apo përjashtimi, si dhe duke ofruar akses të lehtë në të gjitha të dhënat mbi lëndët, përmbajtjen dhe kalendarin akademik <sup>260</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Rregullorja e TBU-së për pranimin dhe transferimin e studentëve siguron që çdo kandidat të ketë akses të plotë në informacionin për lëndët, përmbajtjen dhe aktivitetet formuese të programit. Ajo përshkruan në mënyrë të qartë procedurën e njohjes së krediteve, duke kërkuar dokumente si syllabuset, listat e notave dhe vërtetimet zyrtare, si dhe vendos kritere ekuivalentimi sipas ECTS: Komisioni i Transferimeve dhe Njohjes së Krediteve shqyrton përputhjen e orëve, tematikës dhe rezultateve të të nxënit, duke garantuar transparencë dhe koherencë akademike në çdo vendim. Vendimet e ekuivalentimit regjistrohen e ruhen në dosjen personale të studentit, duke mundësuar gjurmueshmëri të plotë për secilin modul të njohur. <sup>261</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e Çështjeve Studentore në TBU luan një rol qendror në orientimin drejt karrierës dhe hyrjen e studentëve në tregun e punës. Si pjesë integrale e strukturës institucionale, kjo zyrë ndihmon në zhvillimin profesional të studentëve përmes këshillimit individual, praktikave të detyrueshme, trajnimeve, bursave, pjesëmarrjes në panairë punësimi dhe lidhjeve të drejtpërdrejta me punëdhënësit. Falë bashkëpunimeve të vazhdueshme me sektorin privat e public, veçanërisht me grupin Balfin duke qënë TBU pjesë e tij, studentët përfitojnë mundësi punësimi dhe internship-esh të përshtatura me profilin e tyre. Krahas ZÇS vepron dhe këshilltari akademik pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit që i orienton studentët për mundësitë në tregun e punës, këshillim karriere etj. <sup>262</sup> Zyra organizon rregullisht takime me profesionistë të fushave të ndryshme, workshop-e dhe aktivitete që i ekspozojnë studentët ndaj realitetit të tregut dhe i ndihmojnë të krijojnë rrjete profesionale. Praktika mësimore, e detyrueshme për çdo program, koordinohet gjithashtu nga kjo njësi: studentët angazhohen në institucione publike ose private dhe përgatitin raport përvojash që vlerësohen nga një komision i dedikuar. Përmes rrjetit Alumni, TBU forcon lidhjet midis të diplomuarve dhe studentëve aktualë, duke shtuar mundësitë e informimit dhe punësimit. Këto iniciativa plotësojnë standardet për informim të detajuar dhe mbështetje institucionale në tranzicionin e studentëve drejt karrierës. <sup>263</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe	Programet e studimit në TBU zhvillohen sipas një kalendarit akademik vjetor me semestre të përkufizuara qartë. Për secilin program, rregullorja përkatëse

<sup>260</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"; 9. Rregullore e programit të studimit MSh "Informatikë Ekonomike" (shqip); <https://tbu.edu.al>; 14.5. Ditët Informuese n. Ditët informuese në TBU.

<sup>261</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 9. Rregullore e programit të studimit MSh "Informatikë Ekonomike" (shqip); 32. Rregullore për Transferimin e studimeve; 16.1. Kurrikula e programit MSh "Informatikë Ekonomike" (shqip); 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Informatikë Ekonomike" (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Informatikë Ekonomike"; 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Informatikë Ekonomike" (shqip & anglisht).

<sup>262</sup> 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 14.2 Panairi i punës 2024(ftesë); 14.3. Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Master FTI; 14.4. Aktivitete dhe bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI; 14.7. Rregullore e Këshillimit Akademik; 14.7.1. Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI; 36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse.

<sup>263</sup> 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet dhe bizneset në lidhje me programin e studimit MSh-IE; 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

<p>i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>përshkruan qëllimin, strukturën, numrin total të krediteve ECTS, kategoritë e lëndëve, si dhe mënyrën e realizimit të procesit mësimor dhe të kontrollit të njohurive. Syllabuset, të përgatitura nga pedagogët dhe të miratuara nga departamentet, standardizohen në mënyrë uniforme dhe ofrojnë informacion të plotë mbi tematikën, orët e kontaktit, metodat e vlerësimit dhe pjesëmarrjen në seminare ose praktika.</p> <p>Orari mësimor i çdo viti akademik shpallet nga Rektori, në përputhje me strukturën e miratuar nga Senati, dhe përcakton ditët e mësimi, ngarkesën javore në auditor, pushimet zyrtare, sezonin e provimeve, mbrojtjes së praktikave, temave të diplomës etj. Një element themelor i informimit është sistemi LMS, ku ngarkohen materialet didaktike, shpallen rezultatet e provimeve, publikohen kalendarët akademikë dhe jepen njoftimet zyrtare. Përmes këtij sistemi, studentët kanë akses në syllabus-et e çdo lënde, të cilat detajojnë metodat e mësimdhënies, mënyrat e vlerësimit dhe literaturën bazë. Në këtë mënyrë, të gjitha të dhënat lidhur me organizimin e procesit mësimor, përfshirë oraret, format e mësimdhënies dhe kriteret e vlerësimit, u ofrohen studentëve në mënyrë të plotë, duke përbushur plotësisht kërkesat e standardeve për transparencë akademike.<sup>264</sup></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Tirana Business University (TBU) siguron përbushjen e plotë të kriterit që lidhet me aksesin në informacionin për programin e studimit përmes një sistemi të integruar të menaxhimit të brendshëm të informacionit. Ky sistem përfshin përdorimin aktiv të platformës elektronike të të mësuarit (LMS), e cila funksionon si një mjet qendror për shpërndarjen e informacionit akademik dhe administrativ për studentët. Përmes LMS, çdo student ka akses të sigurt dhe të personalizuar në programin e studimit, syllabuset e lëndëve, oraret e leksioneve dhe seminareve, kalendarin akademik, njoftimet zyrtare, rezultatet e provimeve, si dhe materialet mësimore të përditësuara të ngarkuara nga pedagogët. Gjithashtu, sistemi përdoret për menaxhimin e detyrave, feedback-ut nga pedagogët dhe komunikimin dypalësh me stafin akademik dhe administrativ. Aksesueshmëria në distancë është plotësisht e garantuar, duke mundësuar që studentët të informohen dhe të ndjekin progresin akademik në kohë reale, pavarësisht vendndodhjes së tyre fizike. Kjo strukturë siguron transparencë, efikasitet dhe mbështetje të vazhdueshme për të gjithë procesin mësimor.<sup>265</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>
<p><b>Standardi V.4</b></p>				

<sup>264</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 44.1. Udhëzues për Përdorimin e teknologjisë të informacionit; 43.2. Mjediset e Fakultetit Njësive Bazë (Aneks Tabela 16); 44.4. Trajnime mbi sistemin LMS; 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS; 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS.

<sup>265</sup> 44.4. Trajnime mbi sistemin LMS; 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS; 44.1. Udhëzues për Përdorimin e teknologjisë të informacionit.

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Tirana Business University (TBU) përpilon dhe ruan, çdo vit, statistika të detajuara për numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në <b>programin Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike</b> , si edhe në programet e tjera studimore. Të dhënat mbledhen përmes sistemeve të brendshme të informacionit dhe sekretarive mësimore, të cilat përditësojnë në vazhdimësi regjistrat akademikë në përputhje me Rregulloren e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Rregulloren e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. Saktësia e statistikave kontrollohet rregullisht në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse, ndërsa departamenti përkatës harton raporte analitike të hyrjes, daljes dhe diplomimit të studentëve, të pasqyruara në Raportin Vjetor të DIE dhe në analizat e realizimit të objektivave të programit. Ky sistem i mirëadministruar i grumbullimit dhe përditësimit të statistikave siguron transparencë, besueshmëri dhe mundësi verifikimi nga organet e brendshme dhe të jashtme, duke mbështetur zhvillimin strategjik dhe cilësinë e programeve të studimit në TBU. <sup>266</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Për programin <b>Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike</b> , Tirana Business University (TBU) mban statistika vjetore të hollësishme që pasqyrojnë numrin e studentëve nga momenti i regjistrimit deri në diplomim, si dhe të dhënat për tërheqjet, largimet para përfundimit dhe rastet e mospërfundimit të suksesshëm të vitit akademik. Këto informacione administrohen në sistemet e brendshme dhe përditësohen rregullisht nga sekretaritet mësimore dhe departamentet përgjegjëse. Analizimi periodik i statistikave u lejon njësive akademike të ndjekin ecurinë e studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve dhe të ndërmarrin masa për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të programit <sup>267</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në Tirana Business University (TBU), Zyra e Çështjeve Studentore është një njësi e organizuar dhe funksionale, e përkushtuar për të mbështetur studentët gjatë gjithë ciklit të tyre akademik, me fokus të veçantë në orientimin profesional, lidhjen me tregun e punës dhe zhvillimin e karrierës. Kjo zyrë mbledh dhe menaxhon të dhëna të hollësishme për studentët, duke përfshirë regjistrimet, praktikat profesionale, aktivitetet këshilluese, mundësitë e punësimit dhe lidhjet me alumnitë. Të gjitha këto informacione ruhen dhe përpunohen nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit të institucionit, i

<sup>266</sup> 54.2. Raporti Vjetor TBU 2022-2023; 54.3. Raporti Vjetor institucional 23-24; 53.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 29. Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela 3 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB); 30. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Aneks Tabela 21 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB); 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore.

<sup>267</sup> 43.1. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024); 54.2. Raporti Vjetor TBU 2022-2023; 78. Raporti Vjetor TBU 23-24; 53.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 69. Tabela e kuotave sipas troje, transferime 2024-2025; 69.1. Procedura për rialokimin e kuotave të pranimit 24-25; 31. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore e TBU); 30. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Aneks Tabela 21 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB).

	<p>cili garanton ruajtjen e konfidencialitetit, aksesin ekskluziv vetëm për personat e autorizuar dhe verifikueshmërinë e të dhënave.</p> <p>Zyra përdor këto të dhëna për të analizuar progresin e studentëve dhe për të propozuar përmirësime të vazhdueshme në kurrikula, në përputhje me kërkesat dhe zhvillimet e tregut të punës. Në funksion të monitorimit dhe menaxhimit të të dhënave akademike, sekretaria mësimore mban regjistra zyrtarë të pjesëmarrjes dhe ndjekjes së mësimin nga studentët, të cilët administrohen dhe ruhen sipas rregulloreve të veçanta dhe përbëjnë pjesë të arkivit zyrtar të TBU-së. Këto regjistra përmbajnë informacione të verifikueshme mbi zhvillimin e procesit mësimor dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve. Për më tepër, Sekretaria dhe Kryesekretari janë përgjegjës për administrimin, kontrollin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me pranimin, transferimin, regjistrimin dhe diplomimin e studentëve, duke siguruar kështu një menaxhim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të informacionit akademik.<sup>268</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Rregullorja e Tirana Business University (TBU) dhe ajo e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit janë hartuar në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përcaktuar bazën ligjore, strukturën organizative, organet drejtuese dhe kompetencat përkatëse në nivel universitar dhe të fakultetit. Fakulteti përbëhet nga 3 departamente të ndryshme dhe drejtohet nga dekani, i cili ushtron kompetenca të plota menaxheriale dhe akademike në bashkëpunim me dekanatin dhe administratën përkatëse. Rregulloret përcaktojnë gjithashtu marrëdhëniet ndërmjet palëve të përfshira, parimet e lirisë akademike dhe cilësisë së mësimdhënies, si dhe rregullat për organizimin e procesit mësimor, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve, duke siguruar kështu një funksionim institucional të qëndrueshëm dhe të rregullt<sup>269</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Për të garantuar cilësinë dhe efektivitetin e programit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike, njësia përkatëse kryen në mënyrë periodike hartimin e raporteve analitike mbi profilin dhe performancën e studentëve gjatë hyrjes dhe daljes nga programi. Këto raporte përfshijnë të dhëna statistikore dhe analiza të cilësisë akademike të studentëve në fazën e regjistrimit, ecurinë e tyre gjatë studimeve, rezultatet në përfundim të programit, si dhe shkallën e punësimit pas diplomimit. Bazuar në këto analiza, njësia vlerëson përputhshmërinë midis objektivave të programit dhe rezultateve të arritura, duke identifikuar faktorët që ndikojnë në suksesin ose vështirësitë e studentëve. Në bazë të gjetjeve, ndërmerren masa konkrete për përmirësimin e programit, duke përfshirë rishikimin e përmbajtjes së lëndëve, përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe forcimin e bashkëpunimit me aktorët e tregut të punës. Këto mekanizma sigurojnë ruajtjen e relevancës akademike dhe profesionale të programit, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e punësimit të të diplomuarve dhe në përbushjen e pritshmërive të studentëve dhe industrisë<sup>270</sup>.</p>

<sup>268</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore; 14. Rregullore e Zyrës së Çeshtjeve Studentore; 53.2. Raporti vjetor i DIE-2023-2024.

<sup>269</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore.

<sup>270</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 53.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 54.2. Raporti Vjetor TBU 2022-2023; 54.3. Raporti Vjetor institucional 23-24; 30. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Aneks Tabela 21).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi V.5**

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Në Tirana Business University (TBU), studentët fitojnë statusin e tyre që nga momenti i regjistrimit dhe e mbajnë atë deri në diplomim ose çregjistrim, pas të cilit kalojnë në statusin e alumni-t. Të drejtat dhe detyrimet e tyre përcaktohen qartë në ligjet dhe aktet rregullatore të institucionit, duke përfshirë të drejtën për të ndjekur mësimet, për të përdorur infrastrukturën universitare, për të marrë pjesë në proceset vendimarrëse dhe për të dhënë vlerësime mbi cilësinë e mësimdhënies. Studentët përfaqësohen në organet e universitetit përmes Këshillit Studentor dhe Senatit Studentor, të cilët zgjedhen në mënyrë demokratike. Këto organe mbrojnë interesat e studentëve, bëjnë propozime për përmirësimin e jetës akademike dhe shërbimeve, si dhe nxisin pjesëmarrjen e tyre në aktivitete kulturore, shkencore dhe sociale. Përfshirja e studentëve në vendimarrje është e garantuar nga legjislacioni dhe rregulloret e brendshme të TBU-së<sup>271</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Tirana Business University (TBU) ka krijuar një mekanizëm funksional dhe të dokumentuar për përfshirjen aktive të studentëve në procesin e vlerësimit akademik, i cili menaxhohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi harton pyetësorë që fokusohen në cilësinë e mësimdhënies, infrastrukturën, metodologjinë e punës së stafit akademik dhe marrëdhëniet me studentët. Procesi i anketimit zhvillohet me pjesëmarrjen aktive të studentëve të programeve Bachelor dhe Master, të cilët informohen paraprakisht për rëndësinë dhe mënyrën e realizimit të tij në auditorë, pranë përfaqësuesve të stafit dhe drejtuesve të njësive përkatëse. Të dhënat e mbledhura analizohen dhe përfshihen në raporte me qëllim identifikimin e problematikave dhe nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm institucional.</p> <p>Përmes zhvillimit të strukturave dhe mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, TBU ka garantuar përfshirjen e matshme dhe aktive të studentëve në procesin akademik. Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit (FTI), i themeluar në vitin 2023, ka ndërmarrë hapa konkretë për të përfshirë studentët në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit të ofruar. Një nga instrumentet kryesore për këtë qëllim janë fokus-grupet studentore, në të cilat studentët e programeve të ndryshme marrin pjesë në diskutime të strukturuar që adresojnë çështje të ndryshme si zgjedhja e programeve, cilësia e mësimdhënies, angazhimi i stafit, shërbimet akademike dhe administrative, si dhe perspektivat e punësimit. Sugjerimet dhe vlerësimet e nxjerra nga këto fokus-grupe përdoren për të përmirësuar proceset e brendshme akademike.</p>

<sup>271</sup> 2. Statuti TBU; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; 59. Rregullore e Këshillit Studentor; 59.1. Përfshirja-e studentëve në qeverisjen e TBU; 59.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25; 59.3. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25.

	Gjithashtu, monitorimi i mësimdhënies dhe vlerësimi i performancës së pedagogëve përfshin elementë që lidhen me komunikimin me studentët dhe respektimin e standardeve të procesit mësimor. Këto vlerësime kontribuojnë jo vetëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, por edhe në vendimmarrjet institucionale për zhvillimin profesional të stafit akademik. <sup>272</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Tirana Business University (TBU), përmes strukturave akademike dhe Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), siguron përfshirjen aktive dhe të qëndrueshme të studentëve në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Kjo realizohet në mënyrë të strukturuar dhe periodike, duke përfshirë pyetësorë të fokusuar në cilësinë e mësimdhënies, përmbajtjen dhe përputhshmërinë me kërkesat e tregut, si dhe përdorimin e grupeve të fokusit për opinionet e thelluara të studentëve. Përfaqësuesit e studentëve marrin pjesë me të drejtë diskutimi në mbledhjet e departamenteve, ku sjellin perspektivën e tyre për përmirësimet e nevojshme në strukturën dhe përmbajtjen e programeve. Sugjerimet e tyre dokumentohen dhe trajtohen me seriozitet, duke u reflektuar realisht në ndryshimet akademike, çka garanton përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit në TBU <sup>273</sup> . Njëkohësisht studentët janë pjesë e komisioneve të përhershme apo strukturave si NJSBC, ku ata kontribuojnë aktivisht në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike, duke sjellë perspektivën e tyre në vendimmarrje dhe duke siguruar përfshirjen e zërit studentor në proceset zhvillimore të universitetit.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Tirana Business University College (TBU) garanton zbatimin e parimeve të barazisë, transparencës dhe ndershmërisë në çdo fazë të procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve të studentëve. Institucioni operon me një kuadër të qartë rregullator, të përfshirë në Rregulloren e Studimeve dhe dokumente të tjera përkatëse, që i njohin studentëve të drejtën për të shprehur mendimin e tyre dhe për të bërë ankesa mbi mënyrën e vlerësimit. Studentëve u mundësohet të kërkojnë rishikim të rezultateve përmes një procedure zyrtare, duke paraqitur kërkesë me shkrim për rishikimin e provimit ose të notës së lëndës; ata gjithashtu kanë të drejtë të kërkojnë transparencë në proces duke u informuar mbi kriteret e vlerësimit dhe duke pasur akses në provimet e korrigjuara, kur e kërkojnë. Për më tepër, studentët përfshihen në pyetësorë institucionalë që vlerësojnë ndershmërinë dhe objektivitetin e procesit të vlerësimit. Njësitë akademike dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) shqyrtojnë çdo ankesë studentore duke garantuar një proces të paanshëm rishikimi, i cili përfshin konsultimin me pedagogun përkatës dhe, kur nevojitet, me strukturat drejtuese të fakultetit ose institucionit. Çdo reflektim apo përmirësim që rrjedh nga këto ankesa dokumentohet dhe trajtohet me seriozitet, në mënyrë që të përmirësohen

<sup>272</sup> 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24; 35.6. Raporti vjetor KC FTI 2023-2024; 35.10. Raporti i Fokus Grupeve; 35.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët.

<sup>273</sup> 2. Statuti i TBU, neni 42 "Këshillat e studentëve"; 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24; 35.6. Raporti vjetor KC FTI 2023-2024; 35.10. Raporti i Fokus Grupeve; 35.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët; 35.7. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetësorit nga studentët; 35.8. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve.

	praktikat e vlerësimit dhe të forcohet besimi-i studentëve në ndershmërinë e procesit mësimor. <sup>274</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Tirana Business University (TBU) ka vendosur dhe zbatuar procedura të qarta, të dokumentuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme, me qëllim garantimin e shërbimeve të plota dhe cilësore për studentët. Në këtë kuadër, funksionojnë disa njësi të specializuara, të aksesueshme dhe të organizuara për të përmbushur nevojat e studentëve në fushat e informimit, orientimit dhe mbështetjes. Zyra e Çështjeve Studentore është njësia kryesore që menaxhon çështjet akademike dhe shërbimet e ndryshme për studentët, përfshirë regjistrimin, dokumentacionin, transferimet dhe trajtimin e ankimimeve apo problematikave gjatë studimeve. Zyra e Këshillimit Akademik ofron asistencë të vazhdueshme për studentët në lidhje me përparimin akademik, zgjedhjen e lëndëve dhe orientimin, duke i ndihmuar në planifikimin dhe monitorimin e rrugës së tyre studimore. Për orientimin profesional dhe përgatitjen për tregun e punës, Zyra e Këshillimit të Karrierës siguron këshillim profesional, organizon seminare dhe aktivitete për zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu, si dhe ndihmon në organizimin e praktikave profesionale dhe lidhjen me partnerët institucionalë dhe bizneset. Këto njësi bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Informatikës Ekonomike dhe strukturat akademike për të siguruar informacion të përditësuar mbi ndryshimet në kurrikulë, kalendarin akademik, procedurat e vlerësimit dhe diplomimit, dhe për t'u përgjigjur në mënyrë të shpejtë dhe transparente ndaj nevojave dhe shqetësimeve të studentëve. Ky sistem i organizuar dhe funksional garanton që çdo student të ketë qasje të drejtë, të lehtë dhe të plotë në informacion dhe shërbime lidhur me procesin mësimor dhe aspektet e tjera të jetës akademike, duke respektuar në çdo rast normat ligjore dhe rregulloret institucionale. <sup>275</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Tirana Business University (TBU) ka ngritur dhe funksionalizuar një sistem të veçantë dhe të strukturuar për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit akademik dhe asistimin e studentëve në të gjitha çështjet që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Ky sistem operohet përmes njësisve të dedikuara, si Zyra e Çështjeve Studentore dhe Zyra e Këshillimit Akademik, të cilat bashkëpunojnë ngushtë me stafin akademik dhe strukturat menaxhuese të institucionit. Në këtë kuadër, Këshilltarët Akademikë kanë një rol kyç në orientimin e studentëve, duke ofruar këshilla të personalizuara për zgjedhjen e

<sup>274</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, neni 28 "Kërkesa për rivlerësim"; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore.

<sup>275</sup> 2. Statuti TBU; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"; 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 31. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore e TBU).


	<p>lëndëve, planifikimin e orarit dhe monitorimin e progresit, sipas një dokumenti të posaçëm, Planit të Këshilltarit Akademik, që përcakton rolet, përgjegjësitë dhe procedurat e këshilltarit gjatë bashkëpunimit me studentët, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme dhe të koordinuar gjatë gjithë periudhës së studimeve. Sistemi përfshin gjithashtu instrumente për ndjekjen e përparimit akademik, ku regjistrohen dhe monitorohen rezultatet e studentëve, duke mundësuar ndërhyrje të hershme në rast vështirësish ose vonesash në procesin studimor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe uljen e nivelit të braktisjes. Studentët përfitojnë asistencë të plotë në aspektet administrative dhe akademike lidhur me programin e studimit, duke përfshirë informimin mbi ndryshimet në kurrikulë, kriteret e vlerësimit, procedurat e provimeve dhe diplomimit, si dhe mundësitë për zhvillim akademik dhe profesional. Ky sistem i mirëorganizuar dhe funksional siguron një përvojë të integruar dhe mbështetëse për studentët, duke respektuar plotësisht kërkesat ligjore dhe standardet më të larta të menaxhimit të arsimit të lartë.<sup>276</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>TBU ka ngritur dhe e ka bërë plotësisht funksionale Zyrën e Këshillimit të Karrierës, e cila ofron shërbime të specializuara për studentët në drejtim të orientimit profesional, përgatitjes për tregun e punës dhe ndërlidhjes së procesit akademik me zhvillimin e karrierës. Kjo zyrë është një njësi e dedikuar që bashkëpunon ngushtë me fakultetet, stafin akademik dhe partnerët institucionalë për të siguruar që studentët të marrin mbështetje të vazhdueshme dhe të personalizuar gjatë gjithë ciklit të studimeve dhe më tej. Shërbimet e këshillimit të karrierës ofrohen në mënyrë të rregullt, si me anë të takimeve individuale ashtu edhe përmes aktiviteteve të strukturuar si workshop-e, trajnime, ditë informuese dhe panairë pune. Studentët informohen dhe këshillohen lidhur me mundësitë për praktikë profesionale në institucionet publike dhe private, si dhe për hapat që duhet të ndjekin për të integruar njohuritë akademike në përvoja konkrete të tregut të punës. Zyra ofron gjithashtu udhëzime mbi përgatitjen e CV-së, letrës së motivimit, zhvillimin e intervistave për punë dhe ndërtimin e një plani afatgjatë të karrierës. Në bashkëpunim me strukturat e brendshme dhe jashtme, Zyra e Karrierës nxit lidhjen e studentëve me biznese, organizata dhe institucione partnere, duke ofruar mbështetje për zhvillimin e praktikave profesionale si pjesë përbërëse e programeve të studimit. Gjithashtu, studentët orientohen për mundësitë e mëtejshme të studimeve apo punësimit, brenda dhe jashtë vendit. Ky mekanizëm i organizuar dhe funksional siguron një qasje të integruar midis formimit akademik dhe zhvillimit profesional të studentëve, duke përmbushur standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për këshillimin e karrierës dhe duke kontribuar në rritjen e punësueshmërisë së tyre pas përfundimit të studimeve.<sup>277</sup></p>

<sup>276</sup> 14.7 Rregullore e Këshillimit Akademik; 14.7.1 Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI; 12.1. Kalendari Akademik 2023-2024; 12.2. Kalendari Akademik 2024-2025; 32. Rregullore per sekretarine mesimore; 35.7. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet.

<sup>277</sup> 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 14.1. Vendim dekanati për Bordin e Tregut të Punës FTI; 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh II; 3.1. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.

<b>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës</b> ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Tirana Business-University (TBU), përmes Zyrës së Çështjeve Studentore, ka krijuar një mekanizëm të strukturuar për ndjekjen dhe monitorimin e studentëve pas diplomimit, duke siguruar mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre. Kjo zyrë ka një rol thelbësor në sigurimin e informacionit të besueshëm dhe të përditësuar, i cili shërben si bazë për vlerësimin e performancës së programeve të studimit dhe përshtatshmërisë së tyre me kërkesat e tregut të punës. Procesi i ndjekjes realizohet përmes mjeteve të ndryshme, duke përfshirë pyetësorë të strukturuar, intervista periodike, platforma elektronike dedikuar dhe bashkëpunime me rrjetet e alumnëve. Të dhënat e mbledhura përfshijnë informacion mbi kohëzgjatjen e tranzicionit drejt punësimit, fushat ku punësohen ish-studentët, lidhjen mes profilit të studimit dhe vendit të punës, si dhe nivelin e kënaqësisë së tyre me përgatitjen e marrë gjatë studimeve. Këto të dhëna analizohen nga Zyra e Karrierës, e cila përgatit raporte vjetore dhe i bën ato të disponueshme për strukturat drejtuese të institucionit, duke kontribuar në informimin, planifikimin strategjik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës akademike. Gjithashtu, informacioni u ofrohet studentëve aktualë dhe atyre potencialë, në mënyrë që të mbështeten në procesin e orientimit profesional dhe në marrjen e vendimeve të informuara për zhvillimin e karrierës së tyre. Përmes këtij mekanizmi të mirëorganizuar, TBU siguron një lidhje të qëndrueshme me të diplomuarit dhe një pasqyrë të qartë mbi ndikimin e programeve të studimit në përgatitjen e burimeve njerëzore për tregun e punës, duke plotësuar në mënyrë të plotë kriterin e kërkuar. <sup>278</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<sup>278</sup> 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB MSHIE Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Aneks Tabela 23).



**VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Tirana Business University (TBU) është një institucion privat i arsimit të lartë, i riorganizuar sipas kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, ku përcaktohet qartë statusi, emërtimi, struktura dhe funksionimi i tij si “Kolegj Universitar”. Institucioni ka ngritur mekanizma të brendshëm për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike, përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NSBC), e cila realizon vlerësime periodike të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, organizon pyetësorë studentorë në fund të çdo semestri për të matur cilësinë e procesit mësimor, dhe zhvillon studime për ndjekjen e punësimit të të diplomuarve dhe efektivitetin e programeve. Përveç kësaj, TBU ka krijuar Komisione të përhershme, përfshirë Komisionin e Cilësisë dhe atë të Marrëdhënieve me Studentët, të cilët punojnë për përmirësimin e programeve dhe përshtatjen e tyre sipas nevojave të studentëve. Këshilli i Etikës monitoron zbatimin e parimeve morale dhe etike në aktivitetet akademike dhe kërkimore. Për më tepër, TBU bashkëpunon me autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare për sigurimin e jashtëm të cilësisë dhe ndjek proceset e akreditimit në përputhje me kërkesat ligjore dhe Kodin e Cilësisë të arsimit të lartë. <sup>279</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Në Tirana Business University (TBU) janë ngritur dhe funksionojnë struktura të specializuara për sigurimin e cilësisë dhe monitorimin e vazhdueshëm të veprimitarisë akademike. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Komisioni i Cilësisë, në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e departamenteve, zbatojnë mekanizma të strukturuar për vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik. Procesi i monitorimit përfshin pyetësorë të strukturuar që plotësohen nga studentët në fund të çdo semestri për të mbledhur të dhëna mbi cilësinë e mësimdhënies, përdorimin e metodave bashkëkohore dhe integrimin e teknologjisë në mësim, si dhe vlerësime të drejtpërdrejta nga drejtuesit e departamenteve që monitorojnë zhvillimin e lëndëve, përgatitjen pedagogjike, angazhimin në auditore dhe inovacionin në qasjen mësimore, të dokumentuara dhe diskutuar në mbledhje periodike. Për më tepër, realizohet analizë e performancës akademike dhe kërkimore sipas standardeve shtetërore dhe objektivave institucionale, si dhe identifikohen nevojat për trajnime apo mbështetje profesionale për stafin, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga NJSBC, komisionet dhe drejtuesit e departamenteve i prezantohen Senatit Akademik dhe organeve të tjera përkatëse, duke ndihmuar në marrjen e vendimeve të bazuara në informacione të plota për menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore në institucion. Ky proces gjithëpërfshirës siguron

<sup>279</sup> 2. Statuti TBU; 20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale; 35.1. Rregullore NJSBC

	monitorim të vazhdueshëm dhe -nxit-praktikat inovative në mësimdhënie, në përputhje me misionin dhe strategjinë e TBU-së. <sup>280</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Tirana Business University (TBU) garanton përfshirjen aktive dhe të strukturuar të studentëve në vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe mënyrës së vlerësimit të dijeve, përmes mekanizmave institucionalë të formalizuar. Studentët marrin pjesë drejtpërdrejt në këtë proces përmes pyetësorëve të strukturuar që zhvillohen në fund të çdo semestri për të gjitha lëndët, ku vlerësohen aspekte të rëndësishme si qartësia e ligjërimit, përdorimi i metodave didaktike, ndihmesa e pedagogut, mënyra e vlerësimit dhe ngarkesa akademike. Rezultatet përpunohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), ku studentët janë përfaqësuar si anëtarë dhe kontribuojnë në rekomandimet për përmirësimin e cilësisë. Përfshirja e studentëve realizohet edhe nëpërmjet strukturave përfaqësuese si Këshilli Studentor, i cili aktivisht identifikon dhe adreson çështje lidhur me përvojën akademike dhe metodologjinë e mësimdhënies, duke përcjellë opinione dhe propozime në Senatën Akademik dhe drejtuesit institucionalë. Në mbledhjet e departamenteve, përfaqësues studentësh kontribuojnë në diskutimet mbi përmbajtjen e kurrikulave, zhvillimin e mësimin dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive. Studentët janë gjithashtu pjesë e komisioneve të përhershme institucionale, përfshirë Komisionin e Cilësisë dhe atë të Marrëdhënieve me Studentët, ku ata luajnë rol në vlerësimin e performancës akademike dhe përmirësimin e përvojës studentore, sipas përqindjes së përcaktuar nga Ligji për Arsimin e Lartë. Për më tepër, TBU ka përcaktuar procedura të qarta për trajtimin e ankimeve dhe shqetësimeve të studentëve, të cilat mund të adresohen pranë departamenteve, dekanatit ose Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët, duke u shqyrtuar në mënyrë të dokumentuar dhe transparente. Përmes këtyre formave të përfshirjes, TBU garanton që vlerësimi i mësimdhënies dhe i metodave të vlerësimit të dijeve të jetë një proces aktiv, gjithëpërfshirës dhe thelbësor për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe angazhimin institucional me studentët si partnerë kyç në edukim. <sup>281</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Tirana Business University (TBU), në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kodin e Cilësisë, ka krijuar dhe funksionalizuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila ka përgjegjësinë për vlerësimin dhe monitorimin periodik të procesit të mësimdhënies dhe shërbimeve akademike. Çdo semestër, NJSBC organizon pyetësorë studentorë për të matur cilësinë e mësimdhënies në të gjitha programet e studimit. Të dhënat e mbledhura përpunohen dhe analizohen në raportet vjetore të vlerësimit, që përmbajnë indikatorë të matshëm mbi performancën e stafit akademik, infrastrukturën mësimore dhe përmbushjen e pritshmërive të studentëve. Rezultatet e këtyre raporteve i komunikohen organeve drejtuese të TBU-së dhe

<sup>280</sup> 35.1. Rregullore NJSBC; 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24; 35.6. Raporti vjetor KC FTI 2023-2024; 35.10. Raporti i Fokus Grupeve; 35.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët; 35.7. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetësorit nga studentët; 35.8. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve; 35.11. TBU - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu; 41. Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.

<sup>281</sup> 35.1. Rregullore NJSBC; 35.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët; 35.7. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetësorit nga studentët; 35.8. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve; 59. Rregullore e Këshillit Studentor.

	janë të aksesueshme për stafin akademik. Ky mekanizëm jo vetëm plotëson kërkesat ligjore, por gjithashtu ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe siguron përfshirjen aktive të studentëve në procesin e vlerësimit. <sup>282</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	TBU nëpërmjet Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe strukturave të tjera përkatëse, ka ngritur një sistem funksional dhe të vazhdueshëm për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi cilësinë e mësimdhënies. Pyetësorët e studentëve dhe vlerësimet e brendshme nga drejtuesit e departamenteve përbëjnë mekanizmat kryesorë që ndihmojnë në identifikimin e praktikave efektive të mësimdhënies dhe të elementëve që kanë nevojë për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve analizohen në takimet e rregullta të departamenteve dhe senatit akademik, ku evidentohen shembuj konkretë të performancës së lartë nga ana e stafit akademik. Këta shembuj promovohen si praktika të mira dhe ndahen me personelin përmes aktiviteteve të përbashkëta, trajnimeve të brendshme, diskutimeve akademike dhe mentoring-ut ndër kolegjal. Ky cikël i vazhdueshëm i vlerësimit, analizës, reagimit dhe promovimit të praktikave të mira është i institucionalizuar në TBU dhe shërben si një instrument i fuqishëm për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimin profesional të stafit. Në këtë mënyrë, institucioni arrin të adresojë në kohë problematikat, të ndërtojë një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm dhe të nxisë përsosmërinë akademike në të gjitha nivelet. <sup>283</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Tirana Business University (TBU) ka ngritur dhe zbatuar politika, struktura dhe procedura të qarta dhe të qëndrueshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi. Në përputhje me Statutin dhe rregulloret e veta, TBU ka krijuar mekanizma të specializuar për menaxhimin dhe monitorimin e cilësisë në të gjitha nivelet akademike dhe administrative. Struktura të dedikuara brenda institucionit, si komisionet për cilësinë dhe njësitë përkatëse në fakultete dhe departamente, garantojnë zbatimin efektiv të politikave dhe procedurave të SBC. Këto politika janë të koordinuara dhe harmonizuar me kërkesat ligjore kombëtare, duke siguruar një mjedis akademik transparent, përgjegjës dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve arsimore që TBU ofron. <sup>284</sup>

<sup>282</sup> 35.1. Rregullore NJSBC; 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24; 35.6. Raporti vjetor KC FTI 2023-2024.

<sup>283</sup> 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025; 35.4. Plani pune i KC FTI 24-25; 35.1. Rregullore NJSBC.

<sup>284</sup> 61.Ligj 80-2015 22.07.2015; 2. Statuti TBU; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; 7. Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike; 37.1. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik.

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të-ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Tirana Business University (TBU)-ka vendosur dhe zbatuar politika, struktura dhe procedura të qarta dhe të qëndrueshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje të plotë me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi. Sipas Statutit dhe rregulloreve të brendshme, TBU ka krijuar mekanizma të specializuar për menaxhimin dhe monitorimin e cilësisë në të gjitha nivelet akademike dhe administrative. Struktura të dedikuara brenda institucionit, përfshirë komisionet për cilësinë dhe njësitë përkatëse në fakultete dhe departamente, sigurojnë zbatimin efektiv të politikave dhe procedurave të SBC. Këto politika janë koordinuar dhe harmonizuar me kërkesat ligjore kombëtare, duke krijuar një mjedis akademik transparent, përgjegjës dhe të përqendruar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve arsimore që ofron TBU<sup>285</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>TBU përdor një sërë instrumentesh dhe treguesish të standardizuar për të siguruar cilësinë në të gjitha aspektet e veprimtarisë akademike dhe administrative. Institucioni mbështetet në tregues sasiorë dhe cilësorë që lidhen me performancën e stafit akademik, rezultatet e të nxënit të studentëve, efikasitetin e mësimdhënies, përmbushjen e objektivave të programeve të studimit dhe kënaqësinë e studentëve. TBU zhvillon në mënyrë periodike sondazhe, analiza dhe raporte të brendshme vlerësimi, të cilat shërbejnë si bazë për vendimmarrje strategjike dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Për më tepër, TBU është i angazhuar në proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë, duke marrë pjesë në vlerësime të jashtme të akreditimit nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), si dhe duke analizuar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse me qëllim përmirësimin institucional dhe të programeve të studimit. Gjithashtu, TBU realizon vlerësime krahasuese dhe analitike në raport me institucionet homologe, duke nxitur konkurrueshmërinë dhe përshtatjen me praktikat më të mira në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto procese e vendosin cilësinë në qendër të veprimtarisë akademike të universitetit dhe ndihmojnë në përmbushjen e misionit të tij edukativ.<sup>286</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Tirana Business University ka përcaktuar qartë në aktet e veta rregullatore mekanizmat dhe treguesit e matshëm për vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Këta tregues përfshijnë norma kalueshmërie, vlerësimet e studentëve për lëndët dhe pedagogët, rezultatet në provime, publikimet shkencore të stafit akademik, pjesëmarrjen në konferenca dhe projektet kërkimore. Analiza periodike e këtyre treguesve realizohet në nivel departamenti dhe fakulteti dhe shërben si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. TBU përdor këto të dhëna për të identifikuar arritjet, problematikat dhe fushat që kërkojnë ndërhyrje, duke mundur reagim të shpejtë dhe efektiv në drejtim të sigurimit të cilësisë. Për më tepër, institucioni zbaton politika promovuese për stafin akademik dhe studentët me rezultate të larta, përmes vlerësimeve morale dhe profesionale, përfshirjes në projekte të</p>

<sup>285</sup> 2. Statuti TBU; 35.1. Rregullore NJSBC; 20. Rregullore për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"; 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24; 35.6. Raporti vjetor KC FTI 2023-2024.

<sup>286</sup> 52. Shkresa për akreditimin e programeve MShIE në ASCAL; 43. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2022-2023); 43.1. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024); 66. VKM Nr. 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"; 64. Urdhër MAS Nr. 326, dt. 15.08.2013 Akreditimi Institucional dhe i Programeve; 54.1. Raporti Vjetor TBU 2021-2022; 54.2. Raporti Vjetor TBU 2022-2023; 54.3. Raporti Vjetor institucional 23-24.

	brendshme dhe ndërkombëtare, si dhe mundësive për avancim në karrierë. Këto mekanizma nxisin cilësinë, konkurrueshmërinë dhe angazhimin e vazhdueshëm për përmirësim në të gjitha nivelet e programit të studimit. <sup>287</sup>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>TBU zbaton një proces të rregullt, të formalizuar dhe të dokumentuar për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit të ciklit të dytë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe udhëzimet përkatëse të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Ky proces siguron që programet të jenë në përputhje me zhvillimet akademike dhe shkencore, të adresojnë nevojat e tregut të punës dhe të ruajnë standarde të larta akademike dhe profesionale.</p> <p>Procesi i rishikimit dhe miratimit fillon në nivel departamenti, ku zhvillohen analiza periodike mbi përmbajtjen, rezultatet dhe ecurinë e programeve të studimit. Vlerësimi mbështetet në të dhëna të brendshme, si analiza e performancës së studentëve, vlerësimi i mësimdhënies, sugjerime të dala nga vlerësimet e brendshme të cilësisë, si dhe feedback nga studentët, stafi akademik dhe aktorët e jashtëm, përfshirë përfaqësues të tregut të punës. Propozimet për përmirësim apo ndryshim hartohen nga grupet përkatëse akademike dhe paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Fakultetit.</p> <p>Pas shqyrtimit dhe diskutimit në Këshillin e Fakultetit, propozimet kalojnë për miratim në Senatën Akademik, i cili garanton integritetin akademik dhe përputhjen me strategjinë institucionale të zhvillimit. Këto hapa përbëjnë një cikël të qartë vendimmarrjeje dhe reflektimi, që e bën të mundur rishikimin e vazhdueshëm të programeve për të siguruar cilësinë dhe relevancën e tyre në kohë. Gjithashtu, çdo program i ciklit të dytë i nënshtrohet mbikëqyrjes së vazhdueshme, përmes mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe përmes raportimeve të rregullta dhe analizave institucionale. Këto përfshijnë monitorimin e indikatorëve të performancës, si dhe vlerësimin e përmbushjes së objektivave të të nxënit dhe standardeve të programit. Programet rishikohen jo vetëm në aspektin përmbajtësor, por edhe në strukturën, metodologjinë mësimore dhe format e vlerësimit. Përmes këtij procesi të qartë, gjithëpërfshirës dhe të mirëstrukturuar, TBU siguron që të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë</p>

<sup>287-30</sup>. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Aneks Tabela 21 dokumenti 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB); 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB) Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Aneks Tabela 23); 35.10. Raporti i Fokus Grupeve; 41. Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik; 53.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 35.11. TBU - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu; 37.1.1. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin studentët.

	të jenë objekt i një mbikëqyrjeje akademike të qëndrueshme dhe të mirëkoordinuar <sup>288</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet e vlerësimit përmbajnë në detaje rezultatet e pritshme dhe ato të arritura nga programet akademike, duke ofruar një analizë të strukturuar të performancës së tyre. Në këto raporte shpjegohet motivimi pas praktikave më të mira dhe suksesit të evidentuar në mësim dhe kërkim nga stafi akademik dhe studentët, duke theksuar faktorët kryesorë që kanë kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm. Përveç arritjeve pozitive, raportet identifikojnë mangësitë ekzistuese dhe përshkruajnë masat konkrete e efektive që janë ndërmarrë për t'i adresuar, duke siguruar një qasje sistematike dhe të qëndrueshme për ngritjen e cilësisë. Këto masa përfshijnë riorganizimin e përmbajtjes dhe metodologjive mësimore, përmirësimin e infrastrukturës dhe burimeve, si dhe forcimin e mbështetjes për studentët dhe personelin akademik përmes trajnimeve dhe iniciativave motivuese. Gjithashtu, raportet promovojnë krijimin e një mjedisi stimulues ku arritjet akademike dhe kërkimore nxisin përkushtimin dhe angazhimin e vazhdueshëm të të gjithë aktorëve, duke kontribuar në forcimin e kulturës së cilësisë dhe standardeve të larta në arsimin dhe kërkimin shkencor. Kjo qasje gjithëpërfshirëse siguron që përmirësimet të jenë të qëndrueshme dhe të reflektojnë nevojat reale të programit dhe komunitetit akademik <sup>289</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit, TBU përdor një qasje të shumëanshme dhe të strukturuar përmes metodave të drejtpërdrejta të vlerësimit. Një ndër mekanizmat kryesorë është mbledhja sistematike e feedback-ut nga studentët përmes pyetësorëve të detajuar për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, të cilët analizohen për të identifikuar pikat e forta dhe fushat për përmirësim në performancën akademike të stafit. Krahas kësaj, vlerësohet didaktika e përdorur nga pedagogët dhe përmbajtja e kurrikulës në raport me objektivat e programit dhe nevojat e tregut të punës. Vlerësimi i të nxënit realizohet nëpërmjet analizës së detyrave, provimeve dhe projekteve të studentëve, duke mundësuar edhe krahasime paralele ndërmjet grupeve ose moduleve të ndryshme për të garantuar barazi në vlerësim dhe koherencë metodologjike. Gjithashtu, zhvillohen vëzhgime në auditor për të monitoruar mënyrën e realizimit të orëve të mësimit dhe për të vlerësuar interaktivitetin, zbatimin e metodave moderne didaktike, si dhe për të siguruar që orët praktike dhe ushtrimet të përmbushin objektivat mësimore. Institucioni aplikon gjithashtu testime të brendshme dhe të standardizuara për të matur progresin e studentëve dhe për të ndjekur rezultatet akademike në mënyrë të vazhdueshme. Në rastet kur programi i studimit përgatit profesionistë për fusha

<sup>288</sup> 2.1.2. Vendim Senati 9-1 dt.16.11.22 Per hapjen e programeve Informatike Ekonomike, Inxh.Kompjuterike dhe Inxhienieri Softwerike; 2.1.3. Vendim SA Nr. 51, dt.11.09.23 mbi ristrukturimin ne zbatim te urdherave 195, 196 MAS ; 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit ; 7. Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike; 9. Rregullore e programit të studimit MSh Informatikë Ekonomike (shqip); 35.6. Raporti vjetor KC FTI 2023-2024; 3.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024; 54.2. Raporti Vjetor TBU 2022-2023; 78. Raporti Vjetor TBU 23-24.

<sup>289</sup> 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24; 35.6. Raporti vjetor KC FTI-2023-2024; 35.10. Raporti i Fokus Grupeve; 35.11. TBU - Formulari i vlerësimit te pedagogut nga eprori – kolegu; 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIE; 41. Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik; 54.2.. Raporti Vjetor TBU 2022-2023; 54.3. Raporti Vjetor-institucional 23-24; 53.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024.

	<p>të rregulluara, analizohen rezultatet në provimet kombëtare apo të licencimit, si një tregues objektiv i përgatitjes dhe përmbushjes së standardeve të jashtme të cilësisë. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga këto instrumente përpunohen dhe analizohen nga strukturat e brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat hartojnë raporte periodike vlerësimi. Këto raporte përfshijnë rezultatet e arritura, evidentimin e praktikave të suksesshme, si dhe masa konkrete për adresimin e mangësive të identifikuara, duke u shoqëruar me rekomandime të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor. Kjo qasje gjithëpërfshirëse dëshmon përkushtimin e TBU ndaj standardeve të larta akademike dhe ndërtimit të një kulture të qëndrueshme cilësie.<sup>290</sup></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutura nga ky program.</p>	<p>Për të vlerësuar në mënyrë të plotë realizimin, funksionimin dhe cilësinë e programit të studimit, Tirana-Business-University (TBU) përdor një gamë të gjerë metodash dhe mjeteve të integruara që ofrojnë një pasqyrë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse të progresit dhe ndikimit të programit. Këto përfshijnë sondazhe dhe intervista të rregullta me studentët aktualë, të diplomuarit (alumni), si dhe me stafin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. Informacioni i mbledhur nga këto burime shërben për të vlerësuar perceptimet lidhur me cilësinë e mësimdhënies, përmbajtjen e kurrikulës dhe nivelin e mbështetjes institucionale. Përveç kësaj, TBU zhvillon bashkëpunime të ngushta me punëdhënës dhe partnerë institucionalë që marrin pjesë në realizimin e praktikave profesionale dhe projekteve të përbashkëta, duke siguruar një feedback të drejtpërdrejtë mbi përgatitjen dhe aftësitë e studentëve në mjediset reale të punës. Kjo qasje ndihmon në vlerësimin e aplikueshmërisë së njohurive dhe kompetencave të fituara gjatë studimeve. Të dhënat e mbledhura përpunohen dhe analizohen nga strukturat përgjegjëse të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe përfshihen në raportet periodike të vlerësimit, të cilat përdoren për të orientuar vendimet për përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe përshtatjen e tij me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet e fundit në fushën akademike.<sup>291</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.4**

<sup>290</sup> 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIE; 41. Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik; 35.10. Raporti i Fokus Grupeve; 35.11. TBU - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu; 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24; 35.6. Raporti vjetor KC FTI 2023-2024; 54.. Raporti Vjetor TBU 2022-2023; 53.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 39. Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve; 22. Formati i Syllabusit (shqipanglisht) – VKM 41/2018; 30. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Aneks Tabela 21); 11. Udhëzimet për përgatitjen e temës së diplomës.

<sup>291</sup> 35.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët; 35.8. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve; 35.7. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetësorit nga studentet; 14.5. Ditët informuese në TBU; 19. Studimi i tregut të punës; 0.2-Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB MShIE Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Aneks Tabela 23); 36.3. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh IE; 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5).

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**



Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike, Tirana Business University (TBU) ka ngritur një sistem të konsoliduar të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC), i cili garanton përfshirjen aktive dhe të strukturuar të të gjithë aktorëve të interesuar, si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm, në mënyrë të dokumentuar. Politikat dhe procedurat institucionale të cilësisë janë të detajuara në një seri rregulloresh që përcaktojnë qartë funksionimin e strukturave vendimmarrëse dhe këshillimore, si dhe rolin e aktorëve të ndryshëm në procesin e SBC. Përfshirja e aktorëve të brendshëm realizohet përmes strukturave si Komisioni i Cilësisë në Fakultet, departamenti, koordinorët e programeve, Këshilli Studentor, si dhe përmes aktiviteteve të organizuara, si fokus grupet dhe pyetësorët vlerësues për studentët dhe stafin akademik. Këto mekanizma sigurojnë marrjen e feedback-ut dhe angazhimin konkret në analizën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve. Përveç kësaj, përfshirja e aktorëve të jashtëm realizohet nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm me tregun e punës, institucionet partnere dhe ekspertët e fushës, të cilët kontribuojnë në hartimin dhe rishikimin e kurrikulave, në aktivitete të përbashkëta dhe në procesin e praktikave profesionale. TBU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe biznese kyçe dhe ka krijuar struktura si Bordi i Tregut të Punës, që ofron rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të programeve. Dokumente institucionale si Politika e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Politika për Mësimin, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies formalizojnë përfshirjen e aktorëve në të gjitha fazat e jetës së programeve – nga planifikimi dhe zbatimi, deri te vlerësimi dhe rishikimi periodik. Përfshirja e studentëve është e garantuar përmes rregullores së Këshillit Studentor dhe pjesëmarrjes së tyre në komisione dhe fokus grupe, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe të ndikojë në vendimmarrje. Në përfundim, TBU demonstroi një angazhim të fortë dhe të dokumentuar për përfshirjen gjithëpërfshirëse të aktorëve relevantë, duke integruar këtë proces në kulturën institucionale të cilësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike.<sup>292</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë në programin e studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike është një proces i strukturuar, ku çdo njësi dhe aktor i përfshirë ka përgjegjësi të qarta dhe rol aktiv në zbatimin e tij. Institucioni ka ndërtuar një kulturë të brendshme bashkëpunimi dhe përgjegjshmërie, ku stafi akademik dhe administrativ, studentët, si dhe përfaqësues të jashtëm kontribuojnë në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin cilësor të programit. Detyrat dhe përgjegjësitë nuk mbeten vetëm në nivel formal, por zbatohen në praktikë përmes mekanizmave të koordinimit, vlerësimit dhe reflektimit të përbashkët. Ky</p>

<sup>292</sup> 6. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; 9. Rregullore e programit të studimit MSh Informatikë Ekonomike (shqip); 20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale; 15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU; 33. Projektet e fituara nga TBU/Projekte ku janë përfshirë pedagogët e DIE/Projekte të fituara tek AKKSHI; 55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.

	<p>angazhim i përbashkët siguron që çdo vendimmarrje që ndikon në cilësinë e programit të bazohet në analiza të mirëfillta dhe të reflektojë interesin e të gjitha palëve të përfshira, duke nxitur kështu zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e vazhduar të tij. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) luan një rol thelbësor në këtë proces. Ajo ka funksionin mbikëqyrës dhe koordinues për zbatimin e standardeve të cilësisë në përputhje me kuadrin ligjor dhe objektivat institucionale. NJSBC monitoron dhe vlerëson vazhdimisht veprimtaritë mësimore, kërkimore dhe administrative, duke analizuar të dhënat, rekomandimet dhe ecurinë e realizimit të detyrave që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e programit. Nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me strukturat drejtuese të fakultetit dhe departamenteve, NJSBC siguron që çdo aktor të jetë i informuar, i përfshirë dhe i mbështetur në përmbushjen e rolit të tij. Për më tepër, NJSBC inkurajon pjesëmarrjen e studentëve dhe palëve të jashtme në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë, duke përfshirë instrumente të tilla si vlerësimet e rregullta të kënaqshmërisë, konsultimet me alumnit dhe bashkëpunimin me sektorin e industrisë. Ky bashkëveprim i organizuar në mënyrë sistematike krijon një mekanizëm efikas për reflektimin dhe ndërhyrjen në kohë mbi nevojat për përmirësim, duke garantuar që standardet e cilësisë jo vetëm të plotësohen, por edhe të tejkalohen në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të programit.<sup>293</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Cilësia e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike në TBU sigurohet përmes një organizimi të qartë dhe një kulture bashkëpunimi midis njësive të përfshira. Njësitë kryesore që mbajnë përgjegjësi për këtë program janë vazhdimisht të përfshira në zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe përmirësimin e tij, duke koordinuar proceset e sigurimit të cilësisë së bashku me të gjithë aktorët relevantë. Hartimi i syllabuseve, përshtatja e përmbajtjeve në përputhje me zhvillimet shkencore dhe kërkesat e tregut të punës, si dhe vlerësimi i vazhdueshëm i rezultateve të të nxënit, janë kontributet kryesore të stafit akademik. Mbështetjen teknike, logjistike dhe organizative të procesit mësimor dhe vlerësues e siguron personeli ndihmësakademik dhe administrativ. Studentët marrin pjesë aktive në këtë proces përmes vlerësimeve periodike të cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve, si dhe përfaqësimit në strukturat këshillimore dhe pjesëmarrjes në diskutimet që synojnë përmirësimin e programit. Kjo angazhim shumëpalësh është i strukturuar dhe konkret, duke nxitur rritjen e vazhdueshme të cilësisë. Pjesëmarrja aktive e këtyre aktorëve përmirëson në mënyrë të vazhdueshme proceset e reflektimit, komunikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar që zhvillimi i programit të jetë i bazuar në nevojat reale, praktikat më të mira dhe standardet akademike të qëndrueshme.<sup>294</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet</p>	<p>Tirana Business University (TBU) siguron që të gjithë aktorët e brendshëm të përfshihen në mënyrë aktive dhe të organizuar në proceset periodike të vlerësimit të programeve të studimit, duke respektuar në mënyrë rigorozë parimet e</p>

<sup>293</sup> 35.11. TBU - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu; 41. Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik; 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore.

<sup>294</sup> 35.6. Raporti vjetor KC FTI 2023-2024; 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24; 53.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025; 35.4. Plani pune i KC FTI 24-25; 53.1. Plani vjetor i DIE-2023-2024; 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIE.



të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	integritetit akademik dhe barazisë. Stafi akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentët kanë mundësinë e lirë dhe të barabartë për të dhënë mendimet, vlerësimet dhe sugjerimet e tyre, pa frikë nga paragjykimet apo përjashtimet e mundshme. Kultura e institucionit mbështetet në respektin reciprok dhe profesionalizmin, duke përjashtuar çdo formë trajtimi të padrejtë apo diskriminimi. Proceset e vlerësimit zhvillohen në mënyrë të hapur dhe të paanshme, duke përdorur kritere të qarta dhe objektive, ku çdo zë ka rëndësi dhe çdo kontribut trajtohet në mënyrë të barabartë. Kështu, TBU nuk plotëson vetëm kërkesat ligjore për sigurimin e cilësisë, por edhe krijon një mjedis akademik të fortë dhe të besueshëm, ku përfshirja e gjithsecilit është e garantuar dhe besimi në proceset e brendshme të vlerësimit rritet vazhdimisht. <sup>295</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	TBU siguron përfshirjen aktive të bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit, nëpërmjet mekanizmave të strukturuar dhe të institucionalizuar. Një nga format kryesore të këtij angazhimi është organizimi i takimeve periodike me Bordin e Tregut të Punës, i cili përbëhet nga përfaqësues të bizneseve, institucioneve partnere, organizatave profesionale dhe ekspertë të fushës përkatëse. Këto takime shërbejnë si platforma bashkëpunimi për të analizuar zhvillimet në tregun e punës, për të diskutuar përputhshmërinë e programit me nevojat reale të sektorëve profesionalë, si dhe për të marrë sugjerime konkrete për përmirësimin e përmbajtjes, metodave të mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënit. Përveç takimeve me Bordin, institucioni organizon gjithashtu diskutime tematike, tryeza të rumbullakëta dhe aktivitete vlerësimi me pjesëmarrjen e ekspertëve të jashtëm, të cilët kontribuojnë me vlerësime të pavarura dhe objektive mbi aspektet cilësore të programit. Kjo përfshirje siguron që procesi i vlerësimit të jetë gjithëpërfshirës, i balancuar dhe në përputhje me standardet më të mira të arsimit të lartë, duke ndihmuar në përshtatjen dinamike të programit me kërkesat e kohës dhe në rritjen e cilësisë akademike e profesionale. <sup>296</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>

<sup>295</sup> 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"; 18. Kodi i Etikës; 20. Rregullore për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale; 55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies; 35.1. Rregullore NJSBC; 35.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25; 59. Rregullore e Këshillit Studentor; 59.1. Përfshirja e studenteve në qeverisjen e TBU.

<sup>296</sup> 14.1. Vendim dekanati për Bordin e Tregut të Punës FTI; 14.1.1. Axhendat e takimit me BTP 2023-2024; 14.1.2. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP - 28.05.2024; 14.2. Panairi i punës 2024 (Ftese); 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh IE; 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 33. Projektet e fituara nga TBU/ Projekte ku janë përfshirë pedagogët e DIE/Projekte të fituara tek AKKSHI.

<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike tregon një përkushtim të vazhdueshëm për ndërtimin dhe funksionimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe transparent të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në TBU, politikat, strategjitë dhe strukturat organizative që lidhen me sigurimin e cilësisë janë të qarta, të aksesueshme dhe të kuptueshme për të gjithë aktorët e përfshirë, përfshirë studentët. Të gjitha aktivitetet, nga informimi i studentëve mbi funksionimin e programit dhe cilësinë e mësimdhënies, deri te përfshirja e tyre aktive në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit, zhvillohen në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente. Sistemi i cilësisë mbështetet në parimet e pjesëmarrjes, transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke i mundësuar stafit dhe studentëve të informohen dhe të kontribuojnë në vendimmarrje që synojnë avancimin e cilësisë. Përveç kësaj, informacioni lidhur me standardet e cilësisë, praktikat mësimore, objektivat e programit dhe rezultatet e vlerësimeve të brendshme publikohet në forma të ndryshme, duke ndihmuar në krijimin e një kulture të fortë transparence dhe përmirësimi të vazhdueshëm. Me këtë qasje, programi Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike reflekton një sistem të konsoliduar dhe funksional sigurimi cilësie, ku politikat dhe praktikat zbatohen me rreptësi dhe komunikohen në kohë dhe në mënyrë të qartë me të gjithë palët e interesuara<sup>297</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Publikimi i rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit në TBU realizohet duke respektuar parimet themelore të transparencës, etikës akademike dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në mënyrë që informacioni të jetë i aksesueshëm dhe i kuptueshëm për të gjithë aktorët përkatës. Raportet e përgatitura nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përmbajnë analiza të hollësishme mbi cilësinë akademike dhe zhvillimin e programeve, përfshirë edhe të dhëna sensitive që kërkojnë trajtim të kujdesshëm dhe përputhje të plotë me rregullat për mbrojtjen e privatësisë. Për shkak të natyrës së ndjeshme të informacionit, shpërndarja e raporteve bëhet në mënyrë të kontrolluar dhe të segmentuar: drejtuesit kanë qasje në raportin e plotë për të mundësuar vlerësim të përgjithshëm dhe vendimmarrje strategjike, ndërsa në nivel departamentesh dhe strukturash të tjera shqyrtohen vetëm pjesët që lidhen drejtpërdrejt me fushën e tyre të përgjegjësisë, për të siguruar fokus dhe efikasitet në përmirësimin e cilësisë. Në rastet kur raportet përmbajnë të dhëna veçanërisht të ndjeshme, ato trajtohen me konfidencialitet në takime individuale mes strukturave drejtuese dhe personave të prekur, duke respektuar standardet më të larta të profesionalizmit dhe etikës gjatë gjithë procesit. Kjo qasje siguron një balancë të drejtë midis transparencës dhe mbrojtjes së privatësisë, duke krijuar një mjedis akademik ku informacioni përdoret në mënyrë konstruktive për avancimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit<sup>298</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit trajtohen në mënyrë të detajuar dhe shoqërohen me plane konkrete masash për përmirësimin e të gjitha dobësive dhe mangësive të identifikuara. Të dhënat e mbledhura nga</p>

<sup>297</sup> 2. Statuti TBU; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"; 20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale; 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025; 35.4. Plani pune i KC FTI 24-25; 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24; 35.6. Raporti vjetor KC FTI 2023-2024.

<sup>298</sup> 54.2. Raporti Vjetor TBU 2022-2023; 78. Raporti Vjetor TBU 23-24; 53.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 35.6. Raporti vjetor KC FTI 2023-2024; 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24; 35.10. Raporti i Fokus Grupeve.

<p>përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>vetëvlerësimet periodike përbëjnë një burim të rëndësishëm informacioni për analizën e gjendjes aktuale dhe identifikimin e sfidave që ndikojnë në cilësinë akademike. Procesi i mbledhjes së këtyre të dhënave zhvillohet përmes pyetësorëve të strukturuar dhe të përpunuar me mjete dixhitale, që mundësojnë një analizë të shpejtë dhe të saktë.</p> <p>Rezultatet i bëhen të ditura drejtuesve të institucionit dhe stafit akademik në mënyrë të personalizuar, për të siguruar një vlerësim të drejtë dhe të fokusuar në zhvillimin individual. Pas analizës së rezultateve, hartohen dhe implementohen masa të ndryshme që synojnë përmirësimin e performancës, si organizimi i trajnimeve dhe seminareve për zhvillimin e aftësive mësimore dhe kërkimore, inkurajimi i pjesëmarrjes në aktivitete shkëmbimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe krijimi i mundësive për zhvillim profesional përmes programeve si Erasmus+. Ky proces i strukturuar dhe i vazhdueshëm ndihmon në ngritjen e cilësisë së programeve të studimit dhe në zhvillimin e stafit akademik, duke siguruar që çdo dobësi të adresohet me masa të efektshme dhe duke promovuar një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm brenda institucionit.<sup>299</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, Tirana Business University (TBU) ka vendosur një mekanizëm të strukturuar dhe efektiv për vlerësimin dhe monitorimin e brendshëm të cilësisë. Ky mekanizëm përfshin mbledhjen periodike të të dhënave nga studentët, stafi akademik dhe njësitë përgjegjëse, si dhe analizimin e tyre përmes metodave të standardizuara dhe të dokumentuara. Përpjekjet e vlerësimit nuk kufizohen vetëm në evidentimin e problematikave, por përqendrohen edhe në matjen e impaktit të masave të ndërmarra pas secilit cikël vetëvlerësimi. Raportet e detajuara të përgatitura nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit dhe strukturat akademike përkatëse, të cilët vlerësojnë efektivitetin e ndërhyrjeve dhe përcaktojnë drejtimet për përmirësimet e ardhshme. Kjo krijon një cikël të vazhdueshëm të feedback-ut dhe zhvillimit, ku çdo veprim shoqërohet me reflektim dhe vlerësim të rezultateve. Falë kësaj qasjeje sistematike, TBU është në gjendje të monitorojë jo vetëm zbatimin e planeve, por edhe ndikimin real të tyre në avancimin e cilësisë së mësimdhënies, përvojës së studentëve dhe rezultateve akademike. Kjo praktikë e qëndrueshme forcon kulturën e përgjegjshmërisë brenda institucionit dhe siguron që programet e studimit zhvillohen në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë<sup>300</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin</p>	<p>Tirana Business University (TBU) tregon një përkushtim të vazhdueshëm ndaj sigurimit dhe avancimit afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit, përmes organizimit të aktiviteteve të rregullta informuese dhe ndërgjegjësuere që përfshijnë pjesëmarrjen aktive të stafit dhe studentëve. Këto aktivitete përfshijnë takime periodike, sesione trajnimi dhe forume diskutimi, të cilat trajtojnë çështjet kryesore të cilësisë në arsimin e lartë dhe synojnë të përforcojnë njohuritë mbi</p>

<sup>299</sup> 35.11. TBU - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu; 41. Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik; 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIE; 39. Format i relacionit për monitorimin e syllabuseve.

<sup>300</sup> 53.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 54.2. Raporti Vjetor TBU-2022-2023; 54.3. Raporti Vjetor institucional 23-24; 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIE; 39. Format i relacionit për monitorimin e syllabuseve; 41. Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.

afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	standartet moderne të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe menaxhimit akademik. Veprimtaritë zhvillohen në nivel institucional dhe departamental, duke siguruar përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve dhe promovimin e një kulture bashkëpunimi për cilësinë. Studentët marrin informacion të vazhdueshëm lidhur me të drejtat, përgjegjësitë dhe mënyrat e përfshirjes së tyre në proceset e vlerësimit të programeve, ndërsa stafi akademik angazhohet në analiza dhe diskutime mbi rezultatet e këtyre vlerësimeve, duke propozuar masa konkrete për përmirësim. Një pjesë thelbësore e këtij procesi është përfshirja e studentëve në strukturat vendimmarrëse si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), Komisioni i Cilësisë, Senati Akademik dhe Këshilli Studentor, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohej dhe të merret parasysh në çdo fazë të zhvillimit dhe zbatimit të politikave të cilësisë. Përmes kontributit të drejtpërdrejtë të studentëve, identifikohen sfidat ekzistuese dhe propozohen masa për avancimin e vazhdueshëm. Kjo qasje gjithëpërfshirëse e bëri procesin e sigurimit të cilësisë më të hapur, efikas dhe të qëndrueshëm, duke e shndërruar atë në një bashkëpunim të ngushtë mes të gjitha palëve të interesuara dhe duke forcuar zhvillimin afatgjatë të cilësisë në të gjitha dimensionet e jetës akademike. <sup>301</sup>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
---	----------------	-----------------------	----------------------	----------------------------

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Informatike Ekonomike” 120 ECTS**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit ofrohet në një fushë që konsiderohet thelbësore dhe me një kërkesë në rritje të vazhdueshme për profesionistë të specializuar në tregun e punës.
2. TBU disponon një portofol marrëveshjesh në zgjerim progresiv me institucione akademike dhe subjekte të sektorit ekonomik, duke forcuar rrjetin e tij të bashkëpunimeve strategjike.

<sup>301</sup> 14.5. Ditët informuese në TBU; 14.1.2. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP - 28.05.2024; 14.3. Raport-master FTI Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Master FTI; 14.4. Raport-master FTI2 Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI; 35.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25; 35.1. Rregullore NJSBC; 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS; 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS; 44.4. Trajnime mbi sistemin LMS; 59.1. Përfshirja e studenteve në qeverisjen e TBU; 59.3. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25; 59.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25.

3. TBU ofron një mbështetje të strukturuar dhe të qëndrueshme për zhvillimin profesional të studentëve, duke mundësuar eksperiencë praktike të shumta dhe krijimin e lidhjeve të drejtpërdrejta me sektorin e punësimit.
4. Bashkëpunimi ndërinstytucional në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar është një aset strategjik i TBU, duke kontribuar në rritjen e cilësisë akademike dhe përshtatjen me kërkesat e tregut global të punës.
5. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga specialistë të kualifikuar me ekspertizë të thelluar dhe një përvojë të konsoliduar në fushën e biznesit, duke ndërthurur qasjet teorike me praktikën bashkëkohore të sektorit.
6. TBU ka ndërtuar një kornizë të qëndrueshme mbështetjeje për kërkimin shkencor, duke ofruar financim, asistencë administrative dhe infrastrukturë të avancuar për projekte kërkimore.
7. TBU disponon një infrastrukturë të avancuar dhe të qëndrueshme, e cila mbështet zhvillimin institucional dhe siguron një mjedis optimal për mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.

#### **Pika të dobta**

1. Ulja e numrit të maturantëve si kandidatë potencialë për studime universitare, si pasojë e tendencës së tyre për t'u orientuar drejt institucioneve arsimore jashtë vendit.
2. Biblioteka ofron një mjedis të përshtatshëm për studim, por nevojitet zgjerim dhe përmirësim i kapaciteteve teknologjike për të rritur aksesin e studentëve në pajisje kompjuterike.
3. Mungesa e një sistemi të sofistikuar për menaxhimin e sekretimit të provimeve mund të ndikojë efikasitetin e procesit të vlerësimit akademik.
4. Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme të transportit mund të paraqesë sfida për aksesin e studentëve dhe stafit, veçanërisht atyre nga zonat periferike.

#### **Rekomandime**

1. Zhvillimi i programeve konkurruese për tërheqjen e studentëve, duke përfshirë kurrikula të përshtatura me standardet ndërkombëtare dhe programe të dyfishta diplomimi.
2. Investimi në pajisje teknologjike moderne si kompjuterë, softuer akademik dhe akses në burime online.
3. Zbatimi i një sistemi të digjitalizuar për administrimin e provimeve dhe ruajtjen e konfidencialitetit.
4. Krijimi i shërbimeve të transportit të dedikuar për studentët dhe stafin, veçanërisht në orare të përshtatura me programin akademik.

### **Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science in "Economic Informatics" (120 ECTS)**

#### **Strengths and affirmations**

1. The study program is offered in an essential field, and there is a continuously growing demand for specialized professionals in the labor market.

2. TBU maintains an expanding portfolio of agreements with academic institutions and economic sector entities, strengthening its network of strategic collaborations.
3. TBU provides a structured and sustainable framework for students' professional development, offering numerous practical experiences and direct connections with the labor market.
4. Interinstitutional cooperation at the regional, national, and international levels constitutes a strategic asset for TBU, contributing to academic quality enhancement and alignment with global labor market demands.
5. The academic staff in this study program consists of highly qualified specialists with extensive expertise and consolidated experience in the business sector, integrating theoretical approaches with contemporary industry practices.
6. TBU has established a robust support framework for scientific research, offering funding opportunities, administrative assistance, and advanced infrastructure for research projects.
7. TBU possesses an advanced and sustainable infrastructure that supports institutional development and ensures an optimal teaching and scientific research environment.

#### Weaknesses

1. The number of high school graduates as potential candidates for university studies is declining due to their increasing tendency to pursue education abroad.
2. While the library provides a suitable study environment, technological capacities need to be expanded and enhanced to improve student access to computer resources.
3. The absence of a sophisticated system for managing examination confidentiality may impact the efficiency of the academic assessment process.
4. Inadequate transport infrastructure may challenge student and staff accessibility, particularly for those from peripheral areas.

#### Recommendation

1. Development of competitive programs to attract students, including curricula aligned with international standards and dual-degree programs.
2. Investment in modern technological equipment such as computers, academic software, and access to online resources.
3. Implementation of a digitalized system for examination administration and confidentiality management.
4. Establishment of dedicated transport services for students and staff, particularly with schedules aligned with the academic program.

#### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht

<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>				<b>X</b>
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

## Lista e dokumenteve-bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit

### Dokumentacioni

- 0 Raporti i Vleresimit te Brendshem per MShIE (shqip)
- 01 Raporti i Vleresimit te Brendshem per MShIE (anglisht)
- 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB MShIE
- 1 Mendimi i Dekanit FTI
- 2 Statuti i TBU
- 2.1.1. Vendim Senati 9 dt. 28.09. 2022 per hapjen e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
- 2.1.2. Vendim Senati 9-1 dt.16.11.22 Per hapjen e programeve Informatike Ekonomike, Inxhinieri Kompjuterike dhe Inxhienieri Softwerike
- 2.1.3. Vendim SA Nr. 51 dt.11.09.23 mbi ristrukturimin ne zbatim te urdherave 195, 196 MAS.
- 2.2. Struktura Organizative TBU
- 3.1. Strategjia e Zhvillimit te TBU 24-29
- 3.1.1. Strategjia e Zhvillimit te TBU 18-23
- 3.2. Strategjia e Kerkimit Shkencor 24-29
- 3.2.1 Strategjia e Kerkimit Shkencor 18-23
4. Plani Strategjik për zhvillimin e programin e studimit MSh-IE
5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU
6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
- 7 Rregullore e Departamentit te Informatikes Ekonomike
- 7.1. Formulari i planifikimit të ngarkesës të stafit akademik në auditor nga departamenti
8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore
9. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip)
- 9.1. Rregullore e programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (anglisht)
- 11 Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
- 12.1. Kalendari akademik 2023-2024
- 12.2. Kalendari akademik 2024-2025
13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit
- 13.1. Shembull njoftim për vend vakant për staf akademik në website
- 13.2. Politika e BNJ ne TBU

- 13.3. Format Dosje-staf-akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE):
- 13.4. Praktika e rekrutimit te stafit
14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore
- 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FTI
- 14.1.1 Axhenda e Takimit me BTP 2023-2024
- 14.1.2. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP
- 14.2. Panairi i punës 2024 (ftese)
- 14.3. Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Master FTI
- 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI
- 14.5. Ditët informuese në TBU
- 14.6. Urdhër Rektori për planin e gjimnaz tour 24-25
- 14.7. Rregullore e Këshillimit Akademik
- 14.7.1 Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI
15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU
- 16.1. Kurrikula e programit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip)
- 16.2. Kurrikula e programit MSh “Informatike Ekonomike” (anglisht)
- 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip)
- 16.4. Plani mësimor i programit të studimit MSh “Informatike Ekonomike” (anglisht)
- 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh “Informatike Ekonomike”
- 17.1. Forma e re e propozuar e diplomës dhe suplementit për programin e studimit MSh “Informatike Ekonomike”
18. Kodi i Etikës
19. Studimi për tregun e punës
20. Rregullore për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale
21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh “Informatike Ekonomike” (shqip & anglisht)
22. Format i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018
23. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit
26. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB ) viti aktual

27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit MShAB për 2 vite 23-25 (Aneks Tabela 6,12,7,8 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB)
28. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit MSh – IE për 2 vite 23-25 (Aneks Tabela 4 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB )
29. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse (Aneks Tabela 3 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB)
30. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin (Aneks Tabela 21 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB)
31. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore e TBU)
32. Rregullore për Transferimin e studimeve
33. Projektet e fituara nga TBU/ Projekte ku janë përfshirë pedagogët e DIE/Projekte të fituara tek AKKSHI
34. Të dhëna për punësimin real të studentëve 22-24 (Aneks Tabela 23)
- 35.1. Rregullore e NJSBC
- 35.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25
- 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025
- 35.4. Plani pune i KC FTI 24-25
- 35.5. Raporti vjetor i NJSBC 23-24
- 35.6. Raporti vjetor i KC FTI 23-24
- 35.7. Shembull\_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetësorit nga studentet
- 35.8. Shembull\_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve
- 35.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët/marrëveshje bashkëpunimi
- 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
- 35.11. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu
- 35.12. Praktike e vlerësimit-total të performances të pedagogut
- 35.13. Politika për Sigurimin e Cilesise
- 35.14. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Cilesise
36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse
- 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5)
- 36.2. Memorandum TIP\_TBU\_Subjekt

- 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh-IE
- 36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
- 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI
- 37.1 Politika për zhvillimin profesional të stafit
  - 37.1.1 Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët
- 38. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit MShIE
- 39. Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve
- 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIE
- 41. Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik
- 42. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike - QKSEJ
  - 42.1. Indikatorët e vlerësimit të performancës kërkimore-shkencore për personelin akademik
    - 42.1.2. Formular i raportimit të punës kërkimore shkencore
  - 42.2. Politika e granteve
  - 42.3. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit të studimit MShIE (Aneks Tabela 19)
  - 42.4. Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit (Aneks Tabela 22; 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB)
- 43. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2022-2023)
  - 43.1 Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024)
  - 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive-Bazë (Aneks Tabela 16 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB)
- 44. Strategjia e Zhvillimit të IT
  - 44.1. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit
  - 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS
  - 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS
  - 44.4 Trajnime mbi sistemin LMS
- 45. Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB)
  - 46.1. Rregullore për shkëmbimin e stafit
  - 46.2. Rregullore për shkëmbimet studentore

- 46.3. Raporti ne lidhje me mobilitetet e stafit dhe studenteve
47. Rregullore e bibliotekës
- 47.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MShIE
- 47.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU
48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB)
49. Politika e Marketingut të TBU për programet e studimit
- 50.1. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB)
- 50.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB )
- 50.3. Pasqyrat Financiare 2021\_2022\_2023
- 50.4. Raport auditimi 2021\_2022\_2023
- 50.5. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27
51. Ndryshimet e kurrikulës MshIE(Aneks Tabela 11) NA
52. Shkresa për akreditimin e programeve MShIE në ASCAL
- 53.1. Plani vjetor i DIE 23-24
- 53.2. Raporti vjetor i DIE 23-24
- 54.1. Raporti vjetor TBU 2021-2022
- 54.2. Raporti vjetor TBU 2022-2023
- 54.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024
55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies
56. Rregullore e Arkivës
57. Mareveshja e MAS\_TBU\_dt.9.07.2024 \_Përcaktimi i Personeli Akademik
- 58.1. Brochure Scientific Conference TBU
- 58.2. Program of TBU Conference
59. Rregullore e Keshillit Studentor
- 59.1. Perfshirja e studenteve ne qeversijen e TBU
- 59.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25
- 59.3. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25
- 60.1. Vendim për tarifrat dhe bursat e studentëve për vitin 24-25

- 60.2. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025
- 60.3. Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite
- 60.4. Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23
- 60.5. Kontratë dhurimi Mane Foundation\_TBU studenti Klejvi Pero 24-25
- 60.6. Skema e bursave sociale në TBU
61. Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”
62. TBU\_Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 794, dt. 06.10. 2010 Licensimi i TBU
63. Urdhër-MAS Nr. 75, datë 16.02.2011
64. Urdhër MAS Nr. 326, dt. 15.08.2013 Akreditimi Institucional dhe i Programeve
65. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar
66. VKM Nr. 531, datë 11.06.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”
- 67.1 VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 Kodifikimi programeve qbz
- 67.2 Ministria e Arsimit “Për afatet e kodifikimit të programeve të Studimit ofruar nga institucionet e Arsimit të Lartë” nr.prot. 295, dt.16.01.2023
- 67.3. Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf
- 67.4. Korrespondenca me MAS mbi kodifikimin e programeve te studimit
- 67.5. Shkresa e MAS Nr. 7381/22, dt. 30.12.2024 për “Konfirmimin e kodeve te programeve të studimit në Kolegjin Universitar Tirana Business University.
68. Urdhër Rektori – ngritja e GVB për akreditimin e programit të studimit BaAB MSH IE
69. Tabela e kuotave sipas troje, transferime\_2024-2025
- 69.1 Procedura per rialokimin e kuotave të pranimit 24-25
70. Urdher Nr.195 date 20.4.2023 Mbi hapjen e FTI ne TBU
71. Urdher MAS nr. 458, dt.14.08.2023 per hapjen e MSH Informatike Ekonomike
72. TBU Academic Engagement and Learning Enhancement Policy
73. Urdher MAS nr. 417, dt. 20.09.2017 Miratimi i Statutit Kolegji\_Universitar